



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“MBI AUDITIM FINANCIAR DHE I
PËRPUTHSHMËRISË”
NË BASHKINË DROPULL

Tiranë, 2023

📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3 – 16
1.	<i>Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....</i>	3 – 3
2.	<i>Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</i>	3 – 13
3.	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit</i>	13 – 16
II	HYRJA	16 – 20
	a. <i>Titulli.....</i>	
	b. <i>Marrësi.....</i>	
	c. <i>Objektivat dhe qëllimi.....</i>	
	d. <i>Identifikimi i çështjes.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	f. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	g. <i>Kriteret e vlerësimit</i>	
	h. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	i. <i>Metodat e auditimi</i>	
	j. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	20 – 122
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	20 – 21
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	21 – 122
2.1.	<i>Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin brendshëm.....</i>	<i>21 – 32</i>
2.1.2	<i>Mbi auditimin e brendshëm.....</i>	<i>32 – 41</i>
2.2	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....</i>	<i>41 – 54</i>
2.2.6	<i>Menaxhimin e të ardhurave, mbi arkëtimin dhe përdorimin e tyre.....</i>	<i>54 – 75</i>
2.3	<i>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022.....</i>	<i>75 – 91</i>
2.4.	<i>Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit</i>	<i>91 – 108</i>
2.4.4	<i>Mbi zbatimin e kontratave.....</i>	<i>108 – 115</i>
2.5	<i>Mbi planifikim dhe zhvillim territorin.....</i>	<i>115 – 118</i>
2.6	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e IMT.....</i>	<i>118 – 119</i>
2.7.	<i>Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit.....</i>	<i>119 - 122</i>
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI.....	122 – 145
V.	ANEKSE.....	145 - 169

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 24.5.2023 deri në datë 28.6.2023, realizoi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkia Dropull, të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2022, zbatimin e procedurave për dhënien e lejeve të ndërtimit, veprimtarinë e IMTV, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë periudhës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, shpërblim të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike (3-E), i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Dropull për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, grupi i auditimit konkludon në një opinion të ***opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes*** për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2022), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, konkludon me opinion të ***kualifikuar***.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprind një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.1. Përshkrim i shkurtër i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1	Nga auditimi ka rezultuar se plani i shpenzimeve në fillim të vitit është miratua në vlerën 220,105 mijë lekë, gjatë vitit ka pësuar rritje kryesisht për	Mesëm	2.2 faqe 41-54	Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe sektorët e tjerë të bashkisë, të marrin

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>investime nga Ministria për ujësjellës, donacione nga projektet e BE si dhe ndihma ekonomike dhe paaftësi në vlerën 423,152 mijë lekë pra shpenzimet buxhetore gjithsej për vitin janë në vlerën 643,257 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 483,747 mijë lekë ose 75%.</p> <p>U konstatua se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit për disa zëra të shpenzimeve buxhetore, që mbulohen nga të ardhurat e veta, kështu shpenzime operative është planifikuar në vlerën 55,003 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 34,719 mijë lekë, ose në masën 63%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 54,328 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 12,301 mijë lekë, ose në masën 23 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dropull në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.</p> <p>Për periudhën e vitit 2022 janë parashikuar realizimi i procedurave të vlerë të lartë dhe të ulët në artikullin (602/231) në shumën 130,994,200 lekë, nga e cila: prokurime me vlerë të lartë 115,340,010 lekë për 13 procedura dhe prokurime me vlerë të vogël me vlerë 15,654,191 lekë kjo për 40 procedura.</p> <p>Në fakt nga të parashikuara janë realizuar vlera 109,954,949 lekë, nga e cila: procedura me vlerë të lartë 99,617,511 lekë dhe procedura me vlerë të vogël 10,337,438 lekë.</p> <p>Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2022, për artikullin (602/231) janë në vlerë 181,550,095 lekë, nga e cila: procedura me vlerë të lartë 180,191,049 lekë dhe procedura me vlerë të vogël janë 1,359,046 lekë.</p> <p>Situata financiare e Bashkisë Dropull, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 dhe gjendjes së faturave të palikuiduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 3.44 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare, veprime në mospërputhje me pikën (a) të nenit 5 dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të</p>			<p>masa për hartimin e një buxheti sa më real në raport me strukturën aktuale të bashkisë, të planifikimit të procedurave të prokurimit për investime/shërbime dhe blerje mallrash sipas nevojave që vetë bashkia ka dhe jo të planifikohen jashtë mundësive reale të cilat dështojnë në fazën e zbatimit të tij.</p> <p>Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektori i Menaxhimit të kontratave), të marrin masa për likuidimin e të gjitha faturave të depozituara me dokumentacion të rregullt ligjorë, si dhe të verifikojnë në cdo fazë afatet e përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të faturave brenda afatit ligjorë. Në rast të evidentimit të vonesave të llogaritit penalitetet për kamatëvonesë, si dhe t'i kërkohej Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë llogaritjen e penaliteteve për TVSH e shitjes për vonesa në deklarin jashtë afateve</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe vendimet përkatëse të këshillit bashkiak			
2	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2022, rezulton se në bashkinë Dropull nuk ekziston regjistri i aseteve për pronat si për kullotat, pyjet etje, si dhe nuk është kryer vlerësimi dhe inventarizimi i tyre. Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë i mundur për arsye se duhet aktivet që të vlerësohen duhet të kenë certifikatë pronësie. Nga bashkia Dropull nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie, jo vetëm për arsye financiare por dhe për shkak të kryerjes së aplikimeve pranë ASHK dhe mos pajisjes me certifikatë pronësie. Nga ish komunat janë bërë aplikime dhe janë kryer pagesat për 46 prona dhe kryer pagesa me vlerë 332,000 lekë, por që nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie.</p> <p>Për NJA Dropull i Sipërm janë 91 prona me vlerë 502,600 lekë, aplikime këto të bëra që në vitin 2014. Me shkresën nr. 180 <i>prot</i>, datë 25.5.2015 nga ish-komuna Dropull i Poshtëm është dërguar kërkesë Kryeregjistrusit të ish- ZVRPP Tiranë. Me datë 16.10.2019 me shkresën nr. 1815 <i>prot</i>, datë 16.10.2019 është ripërsëritur kërkesa për paisje me certifikatë pronësie sipas aplikimeve dhe pagesave të kryera. Nga ASHK nuk rezulton të jetë bërë shkresë për përgjigje. Nga 193 prona inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 toka troje terren, llog. Pyje plantacione, 212 ndërtesa e konstruksione, bashkia Dropull nuk posedon titull pronësie në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.8.2001 “për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, kreu VI ‘<i>Transferimi i pasurive</i>”, pika 1 dhe 2.</p> <p>Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale nuk është mbështetur në dokumentacion e duhur në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, kapitulli III pika 35</p>	Mesëm	<i>Pikën 2.3 faqe 75-91</i>	<p>Kryetari i Bashkise Dropull në bashkëpunim me Sektorin e Buxhetit dhe Menaxhimit të Asteve të marrë masa të menjëhershme për përmisimin e gjendjes me parashtrimin të problematikës në GSM.</p> <p>Të ndërmarrë dhe nisë të gjitha procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titull pronësie për pronat; “toka, troje, terrene, pyje, plantacione. Ndërtesa dhe konstruksione”, për vlerësim e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë me qëllim paraqitje e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiar të njësisë publike vendore.</p>
3	<p>Nga auditimi i procedurës së miratimit të “<i>Leje ndërtimi, me sipërfaqe 63.2 m²</i>”, për të cilën është marrë vendimi Nr.750, datë 28/4/2021, i Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin “Shtese Anësore Banese Adresa e realizimit të punimeve”, me zhvillues TH.N, u konstatua si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se planvendosjen e miratuar nuk është e saktë pasi nuk ka të detajuara të gjitha elementët e nevojshëm si, distancat e objektit që do ndërtohet nga objektet rreth tij, si dhe numrat e kateve në kundërshtim kjo me Kushtet Teknike të Projektimit KTP. - Preventivi i llogaritur nga projektuesi nuk është 	Mesëm	<i>Pikën 2.5 faqe 115-118</i>	<p>Drejtorja e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Dropull, të marrë masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të mos pranuar preventiv fiktiv nga ana e projektuesit duke kontrolluar zërat e punës dhe llogaritur preventivin jo më pak se kostoja e ndërtimit - Të respektohet distancat e lejuara nga kufiri i pronës. - Të miratuar leje ndërtimi me mendimet pozitive të aprovuara nga institucionet e nevojshme për të dhënë këtë mendim

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Ilogaritur bazuar në çmimet e referencës për koston e ndërtimit sipas zonave përkatëse. Për ndërtime të caktuara sipas kategorive të tyre preventivi nuk mund të jetë më i ulët se kostoja e ndërtimit çmimi i të cilës është caktuar nga Enti Kombëtar i Banesave EKB. Kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m².</p> <p>- Planvendosjen e miratuar nga ana e DPZHKT bashkia Dropull nuk është respektuar distanca e objektit që do ndërtohet me kufirin e pronës, në kundërshti me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 35 <i>Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës</i>. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. K +1m) ku: d – distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. K – numri i kateve.</p> <p>- Nuk është marrë mendim nga instuticionit (Agjensia e Zhvillimit të territorit ASHK, UK, ASHK) për lejet, në kundërshtim kjo me Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, Neni 15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit, veprime në kundërshtim me çmimet e Enti Kombëtar i Banesave (EKB), <i>kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m²; VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, respektivisht nenet 15 dhe 35.</i></p>			
4	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi veprimtarinë e Inspektoriati Mbrojtjes Territorit, rezulton se në bashkinë Dropull kjo strukturë nuk është e plotësuar pasi ka vetëm një person të punësuar në këtë inspektoriat. IMT nuk posedon blloqe të procesverbaleve të kundërvajtjes si dhe blloqe për daljen e vendimeve të gjobave apo prishjes së objekteve të cilat janë në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, si dhe ligjin 9780 “Për inspektimin e ndërtimit”.</p>	Mesëm	<i>Pika 2.5 faqe 115-118</i>	<p>Kryetari i bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit Mbrojtjes Territorit, si një strukturë e domosdoshme nga ndërtimet pa leje.</p> <p>Në rast mungesë specialisti të fushës sipas përcaktimeve të ligjore të bëhet marrëveshje me IKM të Qarkut Gjirokastrë për kontrollin e territorit.</p>
5	<p>Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës për punë publike, me objekt: <i>“Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat”</i> Bashkia Dropull, rezultoi se investimi, nuk është marrë në dorëzim për shkak të mos plotësimit të rekomandimeve të lëna nga grupi i marrjes në dorëzim, për arsyet:</p> <p>-Mos vendosje reduktor presioni, për: rezervuarin</p>	Mesëm	<i>Pikën 2.4.4, faqe 108-115</i>	<p>Bashkia Dropull në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e punimeve dhe Kolaudatorin e punimeve, të marrin masa për marrjen në dorëzim të parakohshëm të investimit me objekt: <i>“Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat”</i>, pasi të plotësohen nga sipërmarrësi i punimeve</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>200 m³ nr. 1 (Nga ana e Goraxisë) dhe rrjetin shpërndarës; për dhomën e komandimit rezervuari nr. 2 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rezervuarin 200 m³ nr. 3 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rrjetin shpërndarës fshati Sofratikë sipas projektit të zbatimit, si dhe për mos zbatimin e disa zërave të përcaktuar në proces verbalin e datës 29.03.2023 hartuar nga grupi i punës pranë Njësinë Administrative të Dropullit të Poshtëm në Bashkisë Dropull.</p>			<p>shoqëria “K...N” SHPK rekomandimet e lëna nga grupi i marrjes në dorëzim sipas proces verbalit të datës 29.03.2023.</p> <p>Gjithashtu të merren masa të menjëhershme për vendosjen e reduktorëve të presionit, për rezervuarin 200 m³ nr.1 (Nga ana e Goraxisë) dhe rrjetin shpërndarës; për dhomën e komandimit rezervuari nr. 2 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rezervuarin 200 m³ nr. 3 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës, për rrjetin shpërndarës fshati Sofratikë sipas projektit të zbatimit.</p>
6	<p>Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të lartë me fond limit 419,885 mijë lekë të vlerësuara për auditim për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në aplikimin e kriterëve të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara gjithsej 3 procedura me fond limit 402,919 mijë lekë, kriterë të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me kriteret specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit. Kërkesa për mjek të përgjithshme të pambështetur në ligj, etj.</p> <p>Vendosja si kriterë e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “Për prokurimin publik”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.</p> <p>Mos hartimi i oponenca teknike në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 120/2020, datë 7.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.</p> <p>Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 <i>Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve</i> dhe 78 <i>Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit</i>” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.</p>	Lartë	Pikën 2.4, faqe 91-108	<p>Drejtoria Juridike (Sektori i procedurave të Prokurimit) në Bashkinë Dropull, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.</p> <p>Për të gjithë procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera nuk duhet të hidhen në prokurim pa marrë më parë miratimin nga Instituti i Ndërtimit për oponencën teknike të investimit.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
7	<p>Bashkia Dropull nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk ka takime të dokumentuara të GMS, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, nuk ka hartuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, Rregullore të posaçme të konfliktit të interesit, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit; Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike; menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe programeve IT, nuk bëhet sipas kërkesave dhe standardeve ligjore në fuqi dhe paraqet risk në komprometimin e të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes vendore”, urdhrin e Kryeministrit nr. 164 datë 05.10.2017</p>	Mesëm	Pikën 2.1, faqe 21-32	<p>Kryetari i Bashkisë Dropull, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.</p> <p>GMS dhe Koordinatorin i menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorin të riskut, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikon e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.</p> <p>Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një rregulloreje për menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e akrtiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.</p> <p>Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.</p>
8	<p>Për sa më sipër në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara. Bashkia Dropull ka detyrimin për zbatimin e tyre si</p>	Mesëm	Pikën 2.7, faqe 119-122	<p>Kryetari i Bashkisë Dropull të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 518/18 prot., datë 08.09.2022 si dhe Akt Verifikimit nr.1 të datës 23.03.2023, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>më poshtë vijon:</p> <p>a. Masa Organizative janë lënë 10 Rekomandime që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat rikërkohet 3 masa të pazbatuara;</p> <p>b. Masa për Uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat e munguara) në bashkinë Dropull është lënë 1 rekomandim i cili rikërkohet si i zbatuar pjesërisht në vlerën e mbetur deri më 31.12.2022 prej 8,772,214 lekë për 1114 debitorë;</p> <p>c. Masa shpërblim dëmi është lënë 1 masë (e rikërkuar) në vlerën 3,419,505 lekë dhe rikërkohet në vlerën e saj të plotë si e zbatuar pjesërisht (në proces gjyqësor);</p> <p>Ligji nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 gërma j; Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”.</p>			duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.
9	<p>Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të lartë me fond limit 419,885 mijë lekë të vlerësuara për auditim për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 2 procedura me vlerë të fondit limit 269,281 mijë lekë ose 64% e vlerës së fondit limit të audituar, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimi të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.</p> <p>Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.</p>	Lartë	Pikën 2.4 faqe 91-108	Kryetari i bashkisë Dropull, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.
10	<p>Në territorin e Bashkisë Dropull ushtrojnë aktivitet të tregtimit të hidrokarbureve, gjithsej 7 subjekte. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit (autorizime) dhe pagesat e tyre në zbatim të VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të</p>	Lartë	Pikën 2.2.6 faqe 54-75	Drejtoria e të Ardhurave vendor të marrë masa për arkëtimin e vlerave të paarkëtuara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në shumën 788,000 lekë , respektivisht: subjekti “B...T” shpk në shumën 130,000 lekë , subjekti “B.....O’ shpk në shumën 384,000 lekë dhe subjekti A....U shpk në shumën 264,000 lekë .

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p><i>lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. PAGESA PËR DHËNIEN DHE PËRSËRITJEN E LIÇENCAVE PËR NJËSITË E SHITJES SË LËNDËVE DJEGËSE, QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË TYRE PËR PËRDORIM NGA KONSUMATORËT FUNDORË, ËSHTË 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.”, rezulton se autorizimet nuk lëshoheshin për periudhën 5 vjeçare, por për periudha më të shkurtër nga një deri në 5 vite.</i></p> <p><i>Për 7 subjekte që tregtojnë hidrokarbure, detyrimi sipas bashkisë është 4,800,000 lekë, nga e cila është likujduar vlera 4,022,000 lekë, duke mbetur pa likujdim vlera 778,000 lekë, si ardhur e munguar, konkretisht: subjekti “B...T” shpk në shumën 130,000 lekë, subjekti “B....O” shpk në shumën 384,000 lekë dhe subjekti A....U shpk në shumën 264,000 lekë.</i></p> <p><i>Në kundërshtim me VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “Pagesa për dhënie dhe përsëritje të licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. PAGESA PËR DHËNIEN DHE PËRSËRITJEN E LIÇENCAVE PËR NJËSITË E SHITJES SË LËNDËVE DJEGËSE, QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË TYRE PËR PËRDORIM NGA KONSUMATORËT FUNDORË, ËSHTË 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.</i></p>			
11	<p><i>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjetës të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”, me vlerë 247,136,960 lekë me TVSH, fituar nga JV “R.....A T.....U” & “SH....I” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²”, “Zëri 3(2.47/An) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën 185,561 lekë pa TVSH.</i></p> <p><i>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 760 prot., datë 06.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “R.....U” & “SH....I” SHPK.</i></p>	Lartë	<p><i>Pikën 2.4.4 faqe 115-118</i></p>	<p><i>Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 185,561 lekë pa TVSH nga JV “R.....U” SHPK & “SH....I” shpk, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjetës të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”.</i></p>
12	<p><i>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjetës</i></p>	Lartë	<p><i>Pikën 2.4.4 faqe 108-115</i></p>	<p><i>Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat</i></p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p><i>Derviçan, Sofratik dhe Terihat</i>” Bashkia Dropull, me vlerë 142,830,639 lekë me TVSH, fituar nga OE “K....N” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²”, “Zëri 3(2.47/An) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën 313,500 lekë pa TVSH.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 793 prot., datë 11.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe OE “K.N” SHPK.</p>			<p>administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 313,500 lekë pa TVSH nga shoqëria “K....N” shpk, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 793 prot., datë 11.05.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” Bashkia Dropull.</p>
13	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “<i>Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Derviçan,</i>” Bashkia Dropull, me vlerë 79,129,675 lekë me TVSH, fituar nga JV “E. I” SHPK & “B. S” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.87/a) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shk. në tokë” dhe, “Zëri 2(47/an) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën 260,786 lekë pa TVSH.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1502 prot., datë 19.08.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “E. I” SHPK & “B.S” SHPK</p>	Lartë	<p><i>Pikën 2.4.4 faqe 108-115</i></p>	<p>Drejtorja e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 260,786 lekë pa TVSH nga JV “E.I” SHPK & “B.S” shpk, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1502 prot., datë 19.08.2020, me objekt “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Derviçan, Bashkia Dropull”.</p>
14	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “<i>Ujësllësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II</i>” Bashkia Dropull, me vlerë 393,039,116 lekë me TVSH, fituar nga JV “E.I” SHPK & “B.S” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërin e punëve: “Zëri 1(3.124/1a) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zingjir” në vlerën 179,190 lekë pa TVSH.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 962 prot., datë 04.06.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “B..S” & “2-T” & “V.A” SHPK.</p>	Lartë	<p><i>Pikën 2.4.4 faqe 108-115</i></p>	<p>Drejtorja e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 179,190 lekë pa TVSH nga JV “B.S” & “2-T” & “V.A” shpk, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 962 prot., datë 04.06.2020, me objekt “Ujësllësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II”.</p>
15	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtorja e të Ardhurave, Bashkia Dropull dhe nga auditimi u konstatua se, totali i debitorëve me 31.12.2022 është në vlerën 10,126,180 lekë, nga të cilat: debitorë të abonentëve familjarë në shumën 7,871,121 lekë, debitorë subjekte juridik në shumën 855,888 lekë, debitorë subjekte fizik në shumën</p>	Lartë	<p><i>Pikën 2.2.6 faqe 54-75</i></p>	<p>Drejtorja e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake Bashkia Dropull, të marrin masa, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2022</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>45,183 lekë dhe kamatëvonesa nga moslikuidimin i detyrimeve në shumën 1,353,988 lekë.</p> <p>Vlera prej 10,126,180 lekë, përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Dropull.</p> <p>Në totalin e detyrimeve, konstatohet se peshën kryesore e zënë detyrimet nga abonentët familjarë, të cilat janë 75.8% e totalit të detyrimit.</p> <p>Për menaxhimin e taksave e tarifave vendore, Bashkia Dropull nuk kishte aktmarrëveshje me ND. Ujësjiellës Kanalizime por me Zyrën e Postës Shqiptare.</p> <p>Konstatohet se një pjesë e subjekteve të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet nga Drejtoria e të Ardhurave vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, duke u lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite. Gjithashtu dhe subjekte të cilët janë me status pasiv/ ose të mbyllur nuk kanë bërë të mundur likuidimin total të detyrimeve.</p> <p>Në lidhje me masat e marra, konstatohet se në raport me vlerën e detyrimeve, nga bashkia janë marrë masa vetëm 3.4% e totalit të detyrimeve. Në krahasim me nivelin e detyrimeve në fund të periudhës, konstatohet se procedura për zbatimin e masave shtrëngues nuk është e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, ku një pjesë e masave nuk është batuar. Mungon bashkëpunimi me DSHTRR, Drejtorinë ASHK Dega Gjirokastrë, bllokim aktivitet, sekuestrim etj.</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH:, i ndryshuar, respektivisht nenet:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nuk gjen zbatim neni 89-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve; -Nenet 90-Urdhër bllokimet dhe 92-Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë, duke lënë jashtë një pjesë të konsiderueshme të tyre, por dhe subjekte me detyrime nga viti në vit; -Neni 93-Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë dhe neni 94-Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër; -Për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, nuk është kërkuar nga DTTV që për të gjithë subjektet të cilat janë njoftuar për pagesën e detyrimeve dhe zbatuar një pjesë e procedurave të kërkohej <i>kallëzim penal</i>, bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime. 			në vlerën 10,126,180 lekë
16	Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Pyjeve dhe kullotave, rezulton se në Bashkinë Dropull operojnë me kontratë dy shoqëri	Lartë	<i>Pikën 2.2.6 faqe 54-75</i>	Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (Sektori i Pyjeve), të ndjekin të gjitha rrugët

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>të telefonisë celulare, konkretisht shoqëria “T....A” për periudhën 2.3.2019 – 2.3.2028 për vlerën 100,000 lekë/viti, e likujduar sipas mandate arkëtimeve dhe kontrata me shoqëria “V....A” për periudhën 5 vjeçare nga 21.11.2017 deri me 21.11.2012 për vlerën 450,000 lekë/viti.</p> <p>Nga të dhënat, për periudhën 22.11.2021 deri me 22.11.2022 nga shoqëria “V....A” është likujduar vlera 361,250 lekë, duke mbetur për diferencë vlera 88,750 lekë, si ardhur munguar në buxhet.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet se në kontrata e nënshkuara:</p> <p>-Nuk është përcaktuar nr. Parcelës, vendi ku ndodhet dhe kufizimet.</p> <p>-Nuk është llogaritur qira për përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim me rrjetin rrugor, për të cilën duhet të bëhet verifikimi i gjatësisë së rrugës, të llogaritet vlera e qirasë.</p> <p>Veprime në kundërshtim me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Per disa ndryshime ne Vendimin nr.391, datë 21.06.2006 te KM “Per përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave”, i ndryshuar, si dhe kushteve të zbatimit të kontratës.</p>			<p>administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 88,750 lekë ndajë subjektit “V....A”, si e ardhur e munguar.</p> <p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (Sektori i Pyjeve), për të gjitha rastet e mos likujdimet në afat të detyrimeve kontraktuale, në zbatim të nenit 5 të kontratës të llogariten kamatëvonesat në masën 0.01% për çdo ditë vonesë nga momenti i pagesës dhe në rast refuzimi të shlyerjes të kërkohet prishja e kontratës për mos zbatim të kushteve.</p> <p>Drejtoria e Bujqësisë (Sektori i Pyjeve), të marrë masa që në fazën e hartimit të kontratave të reja bashkëlidhur të jetë dhe nr. parcelës ku ndodhet dhe kufizimet.</p> <p>Gjithashtu për kontratat e vijim të evidentohet dhe llogaritet detyrimi i qirasë për rrugën në përdorim dhe arkëtimin e detyrimit.</p>

I.2. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (balance) të vitit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes**, për llogaritë vjetore të Bashkisë Dropull, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Dropull bazuar në analizën e riskut¹, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë jo të plotësuar, materiale dhe të përhapura që janë baza për dhënien e një opinioni të kualifikuar, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

Gjithashtu:

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, ku nga auditimi i 6 kontratave u konstatua dëm ekonomik në vlerën **939,037 lekë**.

- Në mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore në vlerën **10,126 mijë lekë**.

- Në mos zbatimin e akteve ligjore me taksim dhe arkëtimin e taksës së hidrokarbureve dhe tjera për vlerën **778 mijë lekë**.

¹ Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

- Në mangësitë e konstatuara në menaxhimin e kontratave të qirave për kullota, toka bujqësore, prona për vlerën **89 mijë lekë**.

- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të saje.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-paga; 202- Studime dhe kërkime; 401-408-Furnitorë e llogari të lidhura me to; 467-Kreditorë të ndryshëm; 602-shpenzime operative; 215-Mjete transporti; 218-Inventar ekonomik; 32-Objekte inventari dhe 230- 231-investime.

OPINIONI I AUDITIMIT

a. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit auditoi pasqyrat financiare të Bashkisë Dropull, për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar², me theksim çështjeje³.

“Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, pozitën financiare të Bashkisë Dropull në datën 31 Dhjetor 2020, referuar ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), si dhe Udhëzimit të MF nr. 8, datë 03.09.2018 i ndryshuar, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, pasi janë përgatitur në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit”.

Baza për opinionin e pamodifikuar, me theksim çështjeje:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, “Përgjegjësitë e Audituesve “. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Dropull, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 është 7,391,767 lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022, nuk u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe si shumë, janë nën nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2022 (materialiteti

² **Opinion i Pamodifikuar**, Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojmë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Një opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

³ Një opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

7,391767 lekë), dhe nuk ka gabime materiale të përhapura në llogaritë vjetore të subjektit, përveç një çështje specifike jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, fakt ky që përbën bazën e opinionit të pamodifikuar (ISA-705; ISSAI-1705). Në auditim ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar materialitetit sipas vlerës së popullatës 7,837 mijë lekë.

Për këto arsye kemi dhënë opinionin me theksim çështjeje, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Theksimi i çështjes:

Nga ana e Bashkisë nuk është e bërë pajisja me çertifikata pronësie jo vetëm për arsye financiare por edhe për shkak të kryerjes së aplikimeve pranë ASHK dhe mos pajisjes me çertifikatat e pronësisë.

Janë regjistruar në librat e kontabilitetit pa u mbështetur në dokumentacion justifikues si ai i titullit të pronësisë këto llogari:

-Llogaria 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 198,592 lekë e pandryshuar dhe në 2022 njëlloj si vitet e mëparshme.

-Llogaria 211 “*Pyje, Plantacione*” paraqitet e pandryshuar prej 0 lekë.

b- Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Dropull, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**”.*

Baza për opinionin:

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkinë DROPULL.

Bazuar në analizën e riskut nga 21 procedura prokurime me vlera të larta me fond limit 477,559 mijë lekë, janë audituar 5 procedura me fond limit 419,885 mijë lekë ose 87.9% e totalit të procedurave, ku në 3 procedura me fond limit 402,919 mijë lekë janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e zhvillimit të procedurës dhe 2 procedura me fond limit 269,281 mijë lekë, OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, *materiale të por jo të përhapura*, veprime në paligjshmëri të procedurave të zhvilluara.

Gjithashtu:

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, ku nga auditimi i 4 kontratave u konstatua dëm ekonomik në vlerën **939,037 lekë**.

- Në mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në vlerën **10,126 mijë lekë**.

- Në mos zbatimin e akteve ligjore me taksim dhe arkëtimin e taksës së hidrokarbureve dhe tjera për vlerën **1,537 mijë lekë**.

- Në mangësitë e konstatuara në menaxhimin e kontratave të qirave për kullota, toka bujqësore, prona për vlerën **89 mijë lekë**.

- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të sajë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Dropull:

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Dropull, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e

sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 424/1, datë 19.5.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 24.5.2023 deri në datë 28.6.2023, në subjektin Bashkia Dropull, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022, u krye auditimi “Financiar” dhe i “Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ**, *Përgjegjës Grupi*
2. **R.L**, *auditues*
3. **S.J**, *auditues*.
4. **E.Rr**, *auditues*
5. **S.M**, *inxhinier sipas nevojës (auditues)*.

a- Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Dropull.

b- Marrësi: Bashkia Dropull

c- Objekti i auditimit, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Në auditimin e përputhshmërisë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave në fushën e prokurimeve publike, në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, në dhënien e lejeve të ndërtimit, në menaxhimin e aseteve, etj.

d- Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që

auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)⁴.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të ISSAI 1700, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve operative dhe investimeve mbi bazën e procedurave të prokurimit të realizuara për to, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

e- Identifikimi i çështjes: Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Dropull, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

f- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Dropull, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

g- Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

h- Kriteret e vlerësimit.

- ✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit;
- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30/06/2015 e ndryshuar;
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manuali e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;
- ✓ Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;

⁴Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006”;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.2.2022 ” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme“;
- ✓ Ligji nr. 162/2000, datë 23.12.2000 “Për Prokurimin Publik”; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.
- ✓ VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “,
- ✓ Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

h- Standardet e auditimit:

- ✓ ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ✓ ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ✓ ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200;
- ✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- ✓ INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*”; etj.
- ✓ Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*”; etj.

i- Metodatat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi i MF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

j-Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), shpenzimet operative (602) dhe shpenzimet për investime (231), ku vlera e precizonit për vitin **2022** është në shumën **7,837 mijë lekë** (gabim lejuar), të dhëna të paraqitura në *Aneks 1 bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit*.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon⁵.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej **5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi*

⁵Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

k- Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Me datë 28.6.2023 nga grupi i auditimit të KLSH u dorëzuar në zyrën e protokollit Bashkia Dropull aktet e mbajtura. Me shkresën nr. 926/11prot, datë 3.7.2023 (prot KLSH nr. 424/2, datë 6.7.2023), nga subjekti Bashkia Dropull u paraqitën kundërshtitë e akteve, të cilat pasi u lexuan nga grupi, gjetjet mbi për të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjorë gjejnë pasqyrim në këtë Projektraport Auditimi, i cili i përcillet subjektit për njohje dhe paraqitje e opsioneve kundërshtuese.

Me shkresën nr. 1146prot, datë 9.8.2023, nga subjekti Bashkia Dropull janë paraqitur kundërshti e Projekt Raport Auditimit, të cilat pasi u lexuar nga grupi i auditimit, u përgatit Raporti Përfundimtar i auditimit i cili përcillet subjektit për njohje dh zbatim të rekomandimeve për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

2.1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në subjektin “Bashkia Dropull”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta.

Bashkia Dropull është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

Profili i Bashkisë Dropull



Bashkia Dropull ndodhet në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit, në një sipërfaqe prej 466.67 km² me një densitet prej 48.61 banorë/km². Ajo përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogon. Bashkia ka nën administrimin e saj 41 fshatra: Dropull i

Poshtëm me 16 fshatra, Dropull i Sipërm me 18 fshatra dhe Pogoni me 7 fshatra.

Nr.	NJA	Qytete dhe Fshatrat në përbërje
1	Dropull i Poshtëm	<i>Dervican, Goranxi, Vanistër, Haskovë, Dhuvjan, Sofratikë, Terihat, Goricë, Frashtan, Lugar, Grapsh, Peshkëpi e Sipërme, Peshkëpi e Poshtme, Glinë, Vrahogoranxi, Radat</i>
2	Dropull i Sipërm	<i>Jorgucat, Zervat, Bularat, Bodrishtë, Kërrë, Vodhinë, Pepel, Klishar, Selo, Likomil, Llovinë, Krioner, Sotirë, Llongo, Koshovicë, Dritë, Kakavie, Vrisera</i>
3	Pogon	<i>Poliçan, Skore, Sopik, Çatistër, Mavrojer, Hllomo, Selckë</i>

Sipas regjistrit të Gjendjes Civile, më 01.01.2019, Bashkia Dropull numëron 22,685 banorë, ndërsa sipas Census 2011 numërohen 3,503 banorë. Qendër bashkie, është fshati Jorgucat. Ai gjendet në qendër të Dropullit, në degëzimin e rrugës nacionale Gjirokastër – Kakavi dhe Gjirokastër – Sarandë. Popullsia në bashkinë e Dropullit i përket minoritetit etnik grek.

Vitet e fundit, me krizën ekonomike që ka përfshirë më gjerë rajonin ka një rritje të ndjeshme në kultivimin e tokave bujqësore. Bashkia e Dropullit ruan një pasuri të rrallë etno-kulturore. Zona ka ruajtur dhe transmetuar mikpritjen, gjuhën, letërsinë dhe qytetërimin helen, vallet e bukura, polifoninë, kostumet e pasura, motivet epirote të klarinetës, kishat dhe manastiret, sitet arkeologjike, punimet e gurit, artizanatin, zejet, përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, gastronominë e ndërlidhur me traditën etj.

Njësia administrative Dropull i Poshtëm ka fshatra me popullsi më të përqendruar krahasuar me dy njësitë e tjera. Popullsia e bashkisë dominohet më shumë nga grup moshë 15-64 vjeç, e cila përbën 58.5% të popullsisë totale. Moshë e tretë (65 vjeç) zë përqindje të konsiderueshme, 33.8% të popullsisë. Ndërsa grup moshë 0-14 vjeç përbën vetëm 7.7% të popullsisë së bashkisë. Pjesa më e madhe që emigron është ajo që i përket moshës 15-65 vjeç, pra forca aktive.

Në territorin e bashkisë ka katër kopshte fëmijësh dhe dy shkolla të mesme të bashkuara, respektivisht në Dervician, Goranxi, Jergucat, Dervician dhe Bularat, Dervician ku mësojnë rreth 200 nxënës dhe fëmijë.

Shkalla e papunësisë për Bashkinë Dropull mund të themi se paraqitet e ulët, 21.7%, kur mesatarja për vendin e këtij treguesi është 29.3%. Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë lokale, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, industri dhe shërbime. Ka rreth 143 biznese të vogla dhe 82 biznese të mëdha. Struktura e punësimit në këto sektorë paraqitet si më poshtë: në bujqësi janë të punësuar 10.2% e forcës aktive të punës, në industri rreth 32.4%, dhe në shërbime 57.3%. Vihet në dukje se në territorin e Bashkisë Dropull funksionon një numër i konsiderueshëm biznesesh, disa prej të cilave me rëndësi jo vetëm rajonale, por edhe kombëtare. Kjo ka sjellë që në këtë zonë të ketë një numër të konsiderueshëm fuqie punëtore të angazhuar prej bashkive fqinje. Pjesa dërmuse e banorë gjatë vitit janë të punësuar dhe në emigracion, kryesisht Greqi.

2.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 1 e programit: Mbi menaxhimin financiare dhe kontrollin e brendshëm.



1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësive publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave,

hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

a. Bashkia Dropull ushtron funksionet e veta me Rregulloren e Brendshme miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18 datë 31.03.2022 “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Dropull”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1/1 germa ‘b’, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak [VKB] të çdo viti respektiv “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe njësive administrative” si dhe Urdhrit të Kryetarit “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësisve Administrative Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit të MZHS-së”: Rregullore e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 14 datë 31.03.2021 dhe nr. 581/2 prot., datë 31.03.2021 dhe i përket Strukturës Organizative miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 02 datë 05.01.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësisve Administrative Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit të MZHS-s” me nr. 2 prot., datë 05.01.2021;

b. Mbi respektimin e etikës nga punonjësit e institucionit, Bashkia Dropull nuk ka hartuar dhe miratuar “Kodin e Etikës së Bashkisë Dropull” të veçantë, por në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë e ka pasqyruar të plotë me objekt “Për zbatimin e parimeve të etikës gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”; konform Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa “b”, VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil;

c. Bashkia Dropull nuk ka hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike” me nr. 1612 prot., datë 24.01.2022, në moszbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar; Kjo Rregullore përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisve të tij publike dhe ka si qëllim parandalimin e tyre.

- Politikat menaxheriale dhe stili i Punës

- Në Bashkinë Dropull struktura organizative ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit së Bashkisë, pasqyruar edhe në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të saj. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme si struktura përgjegjëse për personelin, harton çdo fillim viti Planin Vjetor të pranimit në shërbimin civil për Bashkinë Dropull, mbështetur në nevojat që pasqyrohen në Strukturat organizative të çdo viti, të miratuara nga Kryetari i Bashkisë me emërtimet e pozicioneve përkatëse. Vendimet janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Struktura organizative e Bashkisë Dropull për dy vitet 2021 dhe 2022 ka këtë kompozim:

Nr	Viti	Numri drejtorive	Numri sektorëve	Numri i punonjësve
1	2021	6	8	161
2	2022	6	9	158

Burimi: Bashkia Dropull

Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative për vitin 2022 sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës, pasqyrohet si më poshtë:

Niveli pozicionit	Status i Nëpunësit Civil		Vende vakante		Kodi i Punës 2021 / 2022
	2021	2022	2021	2022	
Kategori e lartë	0	0	0	0	0 0
E mesme drejtuese	6	6	1	0	3 4
E ulët drejtuese	7	5	1	0	6 6
Ekzekutive	26	26	4	3	21 21
Totali	39	37	4	3	122 121

Burimi: Bashkia Dropull

Nga informacioni shkresor i vënë në dispozicion, rezultoi se numri i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme në Bashkinë Dropull ka qenë i konsiderueshëm. Nga auditimi rezultoi se nuk ka procese gjyqësore për të larguarit nga puna.

Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, jepet në tabelën e mëposhtme:


Nr	Arsyeja e lirimit të vendeve	2021	Punësimi 2021	2022	Punësimi 2022
1	KMCAP	-	42	-	39
2	Pension	6		5	
3	Largim me dëshirë/dorëheqje	13		12	
4	Shkurtime/ristrukturime	23		-	
5	Zgjidhje Kontrate/përfundim	2		6	
6	Largim për mosparaqitje në punë/ shkelje të përsëritura	5		4	
7	Ndërruar jete	1		-	
8	Refuzim të vendit të punës	-		-	
TOTALI		50	42	27	39

Burimi: Bashkia Dropull

Numri i përgjithshëm i personelit në Bashkinë Dropull, referuar strukturave organizative në planifikim për vitin 2021 është 161 punonjës dhe për vitin 2022 është 158 punonjës.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Dropull funksionon me një Strukturë që bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”. Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative nuk shoqërohen edhe me Organigramën përkatëse për tu miratuar nga Këshilli Bashkiak, por janë miratuar pa to:



Skemë e thjeshtuar e strukturës së NJVQV

Gjatë periudhës 2021 - 2022 objekt auditimi, struktura organizative e Bashkisë Dropull ka pësuar ndryshime nga ajo e mëparshme, të cilat miratohen me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Një pasqyrim të kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Dropull paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	VKB / Urdhër Kryetari	Njësi Administrative	Drejtori	Sektor	Punonjës sipas strukturës
2021	Urdhër Kr Nr.2 dt.05.01.2021	3	6	9	145
2021	Urdhër Kr Nr.61 dt.01.06.2021	3	6	8	161
2022	Urdhër Kr nr.2/1 dt.05.01.2022	3	6	9	158

Burimi: Bashkia Dropull

Ndërsa shpërndarja e punonjësve në strukturën organizative sipas njësive përbërëse të saj, pasqyrohen si më poshtë:

STRUKTURA		viti	
		2021	2022
1	Administrata e bashkisë me Njësi varësie	126	119
2	NJA Dropull i Poshtëm	15	18
3	NJA Dropull i Sipërm	13	14
4	NJA Pogon	7	7
TOTALI		161	158

Burimi: Bashkia Dropull

Nga auditimi i strukturave organizative që ka kompozuar Bashkia Dropull, me të cilat ka ushtruar funksionet e veta konform kompetencave që i jep ligji, **u konstatua** se ka shërbime të cilat nuk mbulohen me njësi përkatëse në strukturë, duke rrisur mungesën e ofrimit të tyre për komunitetin: “shërbimi parësor shëndetësor” i funksionit “infrastruktura dhe shërbimet publike”, funksioni “Mjedisi”, shërbimi “mbrojtja civile”⁶ nuk kanë njësi në strukturën organizative.

- Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Bashkia Dropull aktivitetin e saj funksional e mbështet në Rregulloren e Brendshme, e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 14 datë 31.03.2021 dhe nr. 581/2 prot., datë 31.03.2021 dhe i përket Strukturës Organizative miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 02 datë 05.01.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësive Administrative Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit të MZHS-s” me nr. 2 prot., datë 05.01.2021;

Rregullore e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18 datë 31.03.2022 dhe i përket Strukturës Organizative miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 2/1 datë 05.01.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësive Administrative Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit të MZHS-s” me nr. 3/1 prot., datë 05.01.2021; Për periudhën nën auditim e në vijim, ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, si dhe këto janë pasqyruar në *Rregulloren e brendshme të njësisë*.

- Aftësitë profesionale të punonjësve.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e

⁶ Në zbatim të Ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” i shfuqizuar me Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre; • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

- a Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë Dropull.

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përfitim të statusit të nëpunësit civil dhe jo vetëm. Nga auditimi **u konstatua** se nga Bashkia Dropull, struktura përgjegjëse e saj [DBNJS HB] *nuk ka hartuar* Plane dhe Programe vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por trajnimet e punonjësve realizohen nga përzgjedhja fakultative që bëjnë nga programet që ofron ASPA, duke mos patur kështu një orientim mbi rëndësinë në përzgjedhjen e atyre temave që lidhen ngushtë me proceset e punës të përditshmërisë; saj nuk përfshinte të gjithë stafin dhe të gjitha njësitë e strukturës, me qëllim njohja nga ana e tyre me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin për MFK. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

2. Menaxhimi i Riskut

2.1 Regjistri i Riskut Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t’i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, ku jepet një pasqyrim i identifikimit të risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave Bashkia Dropull ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Riskut, ku është bërë i mundur identifikimi i risqeve që vijnë nga burime të brendshme dhe atyre që vijnë nga burime të jashtme, në zbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Bashkia Dropull ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik [GMS] për vitin 2021* me Vendimin e Kryetarit nr. 1 datë 15.01.2021 dhe me nr. 67 prot., datë 15.01.2021 “Për ngritjen e GMS dhe caktimin e EMP në Bashkinë Dropull, në kuadër të përgatitjes së PBA 2022-2024” ndryshuar me atë nr. 7 datë 05.04.2021 dhe me nr. 611 prot., datë 05.04.2021; *për vitin 2022* me Vendimin e Kryetarit nr. 1 datë 24.01.2022 me nr. 137 prot., datë 24.01.2022 “Për ngritjen e GMS dhe caktimin e EMP në Bashkinë Dropull, në kuadër të përgatitjes së PBA 2023-2025”. Nga auditimi rezultoi se GMS ka realizuar takime vetëm për përgatitjen e PBA -së dhe Projekt Planit vjetor të Buxhetit dhe nuk ka takime të tjera të dokumentuara të aktivitetit të tij, që tregon për mosfunksionim të tij në zbatim të përcaktimeve në Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” Kapitulli II pika 2.2.6.

Nr	Viti	Nr. Anëtarëve GMS	EMP	Nr. Anëtarëve EMP
1	2021	12	13	27
2	2022	12	13	28

Punoi: Grupi i auditimit

2.2 Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut.

Nga auditimi rezulton se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.*

2.3 Gjurmët e Auditimit janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre, disa struktura organizative, dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin – veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative.

Nga sa më sipër nga ana e Bashkisë Dropull, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion Gjurmët e Auditimit, kjo pasi Titullari i Bashkisë në cilësinë e NA, nuk ka miratuar gjurmët e auditimit.

-Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, **u konstatua:**

1. Dhoma e serverave nuk është sipas standardeve të përcaktuara në aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga AKSHI;

2. Nuk ka rregullore për përdoruesit e tjerë të këtyre sistemeve, ku të përcaktohet dhe ndarja e detyrave, siguria në komunikim;

3. dokumentacion mbi procedurat e backup (për ato programe e sisteme të hostuara fizikisht në ambientet e bashkisë/dhomës së serverave), mangësi të Marrëveshje Nivel Shërbimit (MNSH) dhe dokumentacioni mbi procedurat e veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave të tyre etj, ku mundësohet gjurma e auditimit të aktivitetit dhe efienca e tyre. Përdorimi i IT në këto kushte cenon (komprometon) aktivitetin ekonomik e financiar të bashkisë dhe paraqet risk në komprometimin e të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë. Të gjitha këto në moszbatim të VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”; “Rregullore për ndërtimin e dhomës së serverave” hartuar nga AKSHI/2008; Udhëzimit nr.115 dt.17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”.

B .Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës. Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit; shkresat/ formularët tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).

3. Veprimtaritë e Kontrollit

Veprimtaritë e Kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.

- Në Bashkinë Dropull për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Nr.	Sektorët	Manualet që përdoren
1	Sektori i Financës	» Manuali i Klasifikimit të llogarive » Manuali i pasqyrave financiare
2	Drejtoria e Shërbimit Urban dhe Shërbimeve Publike	» Manuali teknik i punimeve të ndërtimit në fuqi, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015” Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre.
3	Njësia e Prokurimit	» Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël » Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE)

Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

4. Informacioni dhe Komunikimi

Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe nuk kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“ të organizuar nga ASPA. Mungesa e realizimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka rrishtuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve/drejtorive me drejtorinë ligjore, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësive brenda strukturës së Bashkisë, Bashkisë me njësitë Administrative dhe Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm. Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal. Bashkia Dropull disponon një Rregullore të Brendshme hartuar dhe miratuar mbështetur strukturës organizative me të cilën funksionon bashkia sipas VKB-ve përkatëse.

a. Në Bashkinë Dropull është emëruar *Koordinatori për Informim* dhe *Koordinatori i Transparencës* konform Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 15, 16 dhe Ligjit nr. 119/2014 “Për Informimin Publik”. Koordinatorit për Informim ka përpiluar raporte periodike 6 mujore dhe i ka përcjellë te titullari. Pra një detyrim i vërtetë i Koordinatorit është se ai krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve sipas shkronja b, pika 2 e nenit 10. Çdo informacion dhe njoftim publikohen në WEB-in e Bashkisë Dropull.

Mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimit, mungesa e raportimeve me informacion të plotë e të detajuar, rrishtet e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

b. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë);

c. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë Dropull;

d. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, është përgjegjës për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit;


e. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA);

f. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë shkresore të protokolluar dhe elektronike.

5. Monitorimi

Mungesa e emërimit të një menaxheri në cilësinë e Koordinatorit të Riskut, mos hartimi i gjurmëve të auditimit, mungesa e rregullores së menaxhimit të aktiveve të njësive, ka sjellë mos efektivitet në procesin e monitorimit, pasqyruar kjo në mos hartimin e raporteve vjetore nga GMS, të raporteve periodike të menaxherëve të nivelit të ulët, të mesëm mbi ecurinë dhe

realizimin e produkteve të njësisë publike (bashkisë), si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet Ministrisë së Financave.



Ky Raportim bëhet në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 68 /2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenit 65 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MFE: për vitin 2021 mbi raportimin e zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e I (janar-prill) me shkresën nr. 914 prot., datë 02.06.2021; për 8 mujorin (janar-gusht) me shkresën nr. 1685 prot., datë 27.09.2021 dhe atë vjetor me shkresën nr. 388 prot., dt. 28.02.202; Për vitin 2022 mbi raportimin e zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e I (janar-prill) me shkresën nr. 973 prot., datë 02.06.2021; për 8 mujorin (janar-gusht) me shkresën nr. 1641 prot., datë 29.09.2021 dhe atë vjetor me shkresën nr. 371 prot., dt. 28.02.202; Raportet për në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të sistemeve të kontrollit të cilat përmbajnë: Pyetësozin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funkionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK; Gjithashtu nga ana e Bashkisë Dropull: “Drejtoria e Shërbimit Urban” dhe “Drejtoria e Administrimit të Ujrave, Pyjeve, Livadhe dhe Kullotave” raportojnë çdo vit te Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të Ligjit nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjit nr. 10463/2011 “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM nr. 687/2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”. Çdo akt administrativ i Bashkisë Dropull publikohet në faqen zyrtare të saj konform kjo Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Kreu VI, neni 15 dhe Programit të Transparencës konform ligjit nr. 119/2014 “Për informimin publik”. Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë, konstatoam se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinorit të MFK dhe të riskut, në zbatim të Ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”, me qëllim që të mund të kontrollojnë, të konstatojnë dhe të sistemojnë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.

Titulli i Gjetjes 1: Mbi implementimin dhe zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit të Brendshëm.

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimave të kryera në Bashkinë Dropull u konstatua si vijon:

Mjedisi i kontrollit:

1. Bashkia Dropull nuk ka hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike” me nr. 1612 prot., datë 24.01.2022, në moszbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.

2. Nga auditimi i strukturave organizative që ka kompozuar Bashkia Dropull, me të cilat ka ushtruar funksionet e veta konform kompetencave që i jep ligji, **u konstatua** se ka shërbime të cilat nuk mbulohen me njësi përkatëse në strukturën organizative, duke rrisur mundësinë e ofrimit të tyre për komunitetin: “shërbimi parësor shëndetësor” i funksionit “infrastruktura dhe shërbimet publike”, funksioni “Mjedisi”, shërbimi “mbrojtja civile”.

3. Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e bashkisë Dropull/Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve të Brendshme, nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore *efektive* për trajnimin e detyrueshëm të të gjithë punonjësve në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t’i kryer me efikasitet ato, dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e njësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 64 pika h, Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kapitulli III pika 3.1

Menaxhimi i riskut:

4 Bashkia Dropull deri më 31.12.2022 nuk ka realizuar takime të dokumentuara të GMS për rolin dhe aktivitetin e tij në shërbim të Njësisë publike, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 Kapitulli II pika 2.2.6.

5. Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Dropull, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e122.

6. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, **u konstatua:**

1. Dhoma e serverave nuk është sipas standardeve të përcaktuara në aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga AKSHI;

2. Nuk ka rregullore për përdoruesit e tjerë të këtyre sistemeve, ku të përcaktohet dhe ndarja e detyrave, siguria në komunikim;

3. dokumentacion mbi procedurat e backup (për ato programe e sisteme të hostuara fizikisht në ambientet e bashkisë/dhomës së serverave), mangësi të Marrëveshje Nivel Shërbimit (MNSH) dhe dokumentacioni mbi procedurat e veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave të tyre etj, ku mundësohet gjurma e auditimit të aktivitetit dhe efienca e tyre. Përdorimi i IT në këto kushte cenon aktivitetin ekonomik e financiar të bashkisë dhe paraqet risk në komprometimin e të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë. Të gjitha këto në moszbatim të VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”;

“Rregullore për ndërtimin e dhomës së serverave” hartuar nga AKSHI/2008; Udhëzimit nr.115 dt.17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”.

7. Bashkia Dropull nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III pika 3.3;

Veprimtaritë e kontrollit:

8. Nga Bashkia Dropull *nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm* periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kapitulli III pika 3.3. (sipas Aneksit nr. 11).

9. Mungesa e aktivitetit të GMS në Bashkinë Dropull ka bërë që njësi të ushtrorë funksionet e veta pa hartuar/pa miratuar një strategji dhe një rregullore për menaxhimin dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata materiale si dhe për minimizimin e risqeve ndaj tyre, në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2011 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 27, Manualit MFK pika 2.2.6; Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”;

Informimi dhe komunikimi:

11. Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit si dhe nuk kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA. Mungesa e realizimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka rrisur harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve/drejtorive me drejtorinë ligjore, me qëllim pasjen dhe ruajtjen e një komunikimi me efektivitet, ndërmjet njësive brenda strukturës së Bashkisë, Bashkisë me ndërmarrjet në varësi të saj dhe Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm.

Monitorimi:

12. Nga auditimi i procedurave që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë, u **konstatua** se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS që është rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinatorit të MFK dhe të riskut, në zbatim të Ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”;

Kriteri:

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Udhëzimin nr. 16, dt. 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për menaxherët e të gjitha niveleve”; Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 32 pika 2/a,b,c; Ligji nr. 152 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin civil në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 dt. 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 9 / 3,4 5; neni 11 pika 1/c, e, f; neni 12; neni 19/1,2,3; neni 20; Ligji nr. 10325/2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”; VKM nr. 117 dt. 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2014 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; VKM nr. 142

/2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; me VKM nr. 746/2018 VKM nr. 639 dt. 07.09.2016 ndryshuar me VKM nr. 596 dt. 04.09.2019 “Për përcaktimin e rregullave të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”; Ligji nr. 9887 dt. 10.03.2003 ose ligji nr. 138 dt. 17.12.2015; Ligji nr. 9049/2003 i ndryshuar, Ligji nr. 9367/2005 dhe Udhëzimi nr. 1 dt. 7.06.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm të “Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”; Ligji nr. 119/2014 “Për informimin publik” dhe Udhëzimi i viti 2016 “Mbi detyrat e Koordinatorit të Informimit dhe transparencës”.

Ndikimi/Efekti:

Nga Bashkia Dropull nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përbëhen 5 (pesë) Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. duke rrisur kështu sigurinë e arritjes së objektivave të Bashkisë nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.

Shkaku:

Gjatë periudhës nën auditim Bashkia Dropull nuk ka treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur për plotësimin e aktiviteteve të kontrollit me dokumentacionin përkatës (manuali i procedurave, gjurmët e auditimit, plan vjetor kontrolli të brendshëm, si dhe hartimin e planeve vjetore për rritjen profesionale të stafit dhe njohjen nga ana e tij dhe e menaxherëve të njësisë me ligjin për MFK, miratimin e tyre nga NA – Kryetar i Bashkisë, të cilat orientojnë në zbatueshmërinë e procedurave të saj konform dispozitave ligjore në fuqi.

Rëndësia: E mesme

Për këtë rekomandojmë:

1.1. Kryetari i Bashkisë Dropull, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinorit të MFK dhe koordinorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë Rregulloren e Posaçme të konfliktit të interesit, gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit informimit dhe monitorimit në bashki.

1.2. GMS dhe Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinorit të riskut, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

1.3. Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një rregulloreje me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi;

1.4. Drejtorja Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative/organigramën e saj sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

Nënpika 2.1.2 e programit: Organizimi i Njësisë së AB dhe vlerësimi i veprimtarisë.

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, ka filluar funksionimin e saj nga muaji Prill 2016, me emërtimin “Njësia e Auditimit të Brendshëm”, e cila për vitin 2022 funksionon në nivel drejtorie me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 62, datë 24.11.2021, vendim i konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1075/1 datë 09.12.2021.

Kjo strukturë ushtron veprimtarinë e saj në tre Bashki; Dropull, Finiq dhe Libohovë, nëpërmjet akt marrëveshjeve të lidhura midis titullarëve të tre bashkive; Bashkia Dropull dhe Libohovë, me nr. 328/1 prot, të ofertuesit dhe nr. 319 prot, të përfituesit, datë 15.03.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 4152/1 prot, datë 01.04.2016, rikonfirmuar me shkresën e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8447 prot, datë 12.05.2021, si dhe Bashkia Dropull dhe Finiq, me nr. 1333 prot, të ofertuesit dhe nr. 2465 prot, të përfituesit, datë 04.10.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 13475/1 prot, datë 31.10.2016, rikonfirmuar me shkresën e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.17390/1 prot, datë 05.11.2021, kjo në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”, si dhe nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, te VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja “a”, “Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Kuadri rregullator mbi të cilën mbështetet aktiviteti i NJAB Bashkia Dropull, në zbatim të akteve ligjore/nënligjore në fuqi është si mëposhtë:

a. Plani strategjik 2021-2023 dhe ai vjetor 2021 i veprimtarisë së NJAB janë miratuar me shkresën nr.1915 prot., datë 13.10.2020, janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr.1916 prot., datë 13.10.2020, rishikuar dhe miratuar me shkresën nr. 1867 prot., datë 19.10.2021, dhe janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF, me shkresën nr. 1868 prot., datë 19.10.2021;

Plani strategjik 2022-2024 dhe ai vjetor 2022 i veprimtarisë së NJAB janë miratuar me shkresën nr.1869 prot., datë 19.10.2021, dhe janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF, me shkresën nr.1870 prot., datë 19.10.2021.

Planet strategjike dhe vjetore të NJAB të Bashkisë Dropull, janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në “Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

b. Plani strategjik i auditimit në njësitë e sektorit publik/ NJVQV, mbështetet në programet dhe objektivat e NJQV-së (bashkisë dhe ndërmarrjeve të varësisë) ku ushtron veprimtarinë audituese, si dhe në *identifikimin dhe vlerësimin e risqeve* që ndikojnë në (mos)realizimin e objektivave të këtyre njësisë. NJAB mbi bazën e njohjes dhe të studimit të objektivave strategjike dhe të risqeve të njësisë publike, evidenton jo vetëm subjektet dhe fushat e auditimit që do të realizohen në programin strategjik afatmesëm (PSA), por edhe frekuencën e realizimit të këtyre auditimeve. Planifikimi i auditimit bëhet duke patur parasysh anën funksionale e organizative të subjekteve që janë objekt auditimi, raportet vjetore të institucionit, raportet e mëparshme të auditimit të brendshëm, rekomandimet e auditimit të jashtëm (KLSH), regjistrat e riskut dhe këshillat/opinionet e drejtuesve të njësisë respektive në strukturë. Nga NJAB janë hartuar raportet vjetore të aktivitetit të saj ose dokumentet e sigurimit të cilësisë dhe regjistri i riskut: *për vitin 2021* miratuar nga kryetari i bashkisë me shkresën nr. 5311, datë 11.02.2022; *për vitin 2022* miratuar nga kryetari i bashkisë me shkresën nr. 2324, datë 06.02.2023, të cilat janë dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm *brenda afatit* të përcaktuar në “Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik” miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100/2016, datë 25.10.2016 .

c. Karta e Auditimit të Brendshëm luan rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të veprimtarisë audituese të NJAB Bashkia Dropull, është miratuar me Vendimin nr. 4 datë 18.10.2017, me nr. 1356 prot., datë 18.10.2017, dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të

Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1367 prot., datë 20.10.2017, e përditësuar me Vendimin nr.1 datë 13.10.2020, me nr. 1916 prot., datë 13.10.2020, dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1916/1 prot., datë 13.10.2020.

d. Kodi Etik i Auditimit të Brendshëm ka për qëllim të promovojë një kulturë etike nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Kodi Etik i NJAB e Bashkisë Dropull është miratuar me Vendimin nr. 2 datë 13.10.2020, me nr. 1915/1 prot., datë 13.10.2020, dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, me shkresën nr.1915/2 prot., datë 13.10.2020.

e. Njësia e auditimit të brendshëm - [NJAB] në Bashkinë Dropull, është e organizuar në nivel Drejtorie që prej gjysmës së dytë të vitit 2021⁷ me pesë pozicione në strukturë, por funksionon me 3 auditues të brendshëm. Mos pasja e një Njësie të plotë të Auditimit të Brendshëm në strukturën e Bashkisë Dropull, është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, rëndësia e të cilës konsiston në faktin se “Njësia e Auditimit të Brendshëm” ka funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë Dropull, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

2. Struktura e NJAB në Bashkinë Dropull nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NJAB	Drejtor	Përgjegjës	Specialist Auditues	Kualifikimi profesional	Statusi	Numri i punonjësve Plan / Fakt
Viti 2020	0	1	2	Ekonomist	Me çertifikatë	3 3
Viti 2021	1	1	1	Ekonomist	Me çertifikatë	5 3
Viti 2022	1	1	1	Ekonomist	Me çertifikatë	5 3

Punoi: Grupi i Auditimit

Referuar ligjit nr.114/2015 “Për Auditin e Brendshëm“ në çdo institucion bazuar në disa kriterë të përcaktuara në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Mbi Miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 62 dhe nr. 911 prot., datë 01.06.2021 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësive Administrative Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm, Pogon dhe Sektorit të MZSH-së”; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 2/1 dhe me nr. 3/1 prot., datë 05.01.2022 “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Dropull dhe të Njësive Administrative Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm, Pogon dhe Sektorit të MZSH-së”;

Nr	Struktura e NJAB	2020 plan fakt		2021 plan fakt		2022 plan fakt	
1	Drejtor	0	0	x	x	x	x
2	Përgjegjës	x	x	x	x	x	x
3	Auditues	x	x	x	x	x	x
Totali i audituesve në NJAB		3	3	5	3	5	3

Punoi: Grupi i auditimit

Nga verifikimi i Strukturave organizative, NJAB e Bashkisë Dropull deri në 31.05.2021 ka qenë e organizuar në nivel sektori me 3 auditues (1+2) dhe me VKM nr. 62 datë 01.06.2021 u organizua në nivel drejtorie (1+4) dhe vazhdon të funksionojë me këtë strukturë. Vendimet e Kryetarit nr. 62 datë 01.06.2021 dhe nr. 3/1 datë 05.01.2022 kanë miratuar strukturën e NJAB konform Ligjit nr.114/2015 “Për Auditin e Brendshëm“ dhe VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Mbi

⁷ Para Vendimit të KB nr.62 datë 24.11.2021 NJAB ka qenë e organizuar në nivel sektori

Miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Ndonëse janë shpallur vendet vakante në portalin për punësim të AKPA, ende dy vendet vazhdojnë të jenë të paplotësuara. Edhe pse audituesit e NJAB janë me përvojë, informatizimi i shumë proceseve operacionale në bashki dhe shumëllojshmëria e tyre, lind si domosdoshmëri plotësimin e tyre në pamundësi me personel të përhershëm, edhe me personel të jashtëm si ekspertë të fushës inxhinierike apo ligjore sipas rastit. Kjo për të rritur efektivitetin e aktivitetit të NJAB. Të tre audituesit janë të pajisur me çertifikatën e “Audituesit të brendshëm” në zbatim të ligjit nr.114/2015, “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave nr.100/ 2016 dhe VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kriteve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Gjatë periudhës në auditim NJAB ka funksionuar dhe vazhdon të funksionojë me këtë personel:

Nr	Periudha	Pozicioni	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim	Çertifikimi
	2021-2022				Viti
1.	S.K	Drejtori i njësise	37	31	2005
2.	M.M	Përgjegjës sektori	31	26	2005
3.	A.P	Auditues	13	4	2019

Burimi: NJAB/Bashkia Dropull

3. Trajnimet e [NJAB] dhe certifikimet

Referuar ligjit nr.10296/2010, Manualit të MFK miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 8980, dt. 15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e Ministrit të FE nr.108/2016 të MFK, Ligjit nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, nga bashkia Dropull është hartuar një plan vjetor trajnimesh për audituesit NJAB referuar planit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe për periudhën 2021- 2022 NJAB ka kryer trajnimet si më poshtë vijon:

Nr	Tema e Trajnimit	Viti
1	Planifikimi i Auditimit	2021
2	Strategjia për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe monitorimi i tyre	
3	Kuadri Programit Buxhetor Afatmesëm	
4	Menaxhimi i projekteve të donatorëve	
5	Risku i mashtrimit dhe flamuajt e kuq	
6	Inspektimi financiar	
7	Raportimi i auditimit	
8	Ndjekja e raportimit të auditimit	
9	Auditimi buxhetit të shtetit dhe auditimi i detyrimeve të prapambetura	
Totali		40 orë

Nr	Tema e Trajnimit	Viti
1	Qasja audituese bazuar në risk	2022
2	Prokurimi publik dhe Auditimi i Partneritetit Publik	
3	Auditimi i Asistencës së para anëtarësimit në BE (IPA)	
4	Auditimi i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	
5	Auditimi i Brendshëm në sistemin e shëndetit publik	
6	Auditimi me bazë sistemi (ABS/Sistem Based Audit)	
7	Auditimi i Brendshëm në qeverisje	
8	Auditimi i Shoqërive Aksionere Publike	
Totali		40 orë

Burimi: NJAB/Bashkia Dropull

Trajnimi i audituesve të NJAB duhet të përmbushi planin vjetor prej 40 orëve në vit për çdo auditues, përcaktuar dhe programuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Kjo për mirëfunksionimin e auditit të brendshëm në njësinë publike, për të cilën gjatë procedurës audituese, duhet të mbështetet në zbatimin me korrektësi të 7 (shtatë) parimeve të përgjithshme, të cilat janë:

a) ligjshmëria, b) paanësia, c) integriteti, ç) pavarësia dhe objektiviteti, d) profesionalizmi & zhvillimi i vazhdueshëm profesional dh) kompetenca e) konfidencialiteti

Nga sa më lart përshkruam, audituesit e [NJAB] të bashkisë Dropull për periudhën 2021-2022 rezultojnë të kenë zhvilluar orët e plota të trajnimit të detyrueshme të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, vërtetuar kjo nga Vërtetimet e lëshuara nga DPHKBF/DHAB si dhe certifikatat me të cilat janë pajisur për temat jashtë planifikimit vjetor, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore në fuqi.

II. Planifikimi dhe realizimi i auditimeve

2.1 [NJAB] e Bashkisë Dropull ka hartuar dhe miratuar nga Kryetar i Bashkisë Planet Strategjike dhe ato Vjetore respektive, konform përcaktimeve ligjore, i ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, brenda afatit kohor (20 Tetor). Plani Strategjik (2021-2023 dhe 2022-2024), përmban këto 5 (pesë) pasqyra :

Pasqyra Nr.1 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2021-2023 dhe 2022-2024. Plotësuar

Pasqyra Nr.2 - Plani i Angazhimeve të NJAB për vitet 2021 dhe 2022. Plotësuar

Pasqyra Nr.3 - Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitet 2021 dhe 2022. Plotësuar

Pasqyra Nr.4 - Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitet 2021 dhe 2022. Plotësuar

Pasqyra Nr.5 - Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që auditohen për vitet 2021 dhe 2022. Plotësuar

Nga auditimi rezulton se për dy vitet 2021 e 2022 janë vlerësuar me koeficientin e riskut “i lartë” e “i mesëm” njësitë e strukturës organizative/fushat/sistemet e bashkisë Dropull, plotësia dhe saktësia e të cilave orienton [NJAB] për të hartuar një plan strategjik dhe plan vjetor sa më real dhe në shërbim të institucionit, për përmbushjen e detyrave funksionale që i atribuon ligji.

- Planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese është bërë mbi bazë risku dhe paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	2021			2022		
	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët
Numri i auditimeve plan	3			5		
Numri i auditimeve fakt	3			5		
Numri për cdo nivel fakt	2	1	0	2	3	0
Shprehur në % (ndaj planit)	66	33		40	60	

Punoi: Grupi i Auditimit

Referuar të dhënave në tabelë rezulton se për vitin 2021 është realizuar numri i auditimeve të planifikuara në Planet Strategjike dhe ata Vjetorë për të dy vitet 2021 e 2022; është pasqyruar e argumentuar arsyeja e ndryshimit të një misioni auditues (në rastet kur ka ndodhur) në relacionin dhe planin e ndryshuar; Gjithashtu rezultoi se në planifikimin e misioneve audituese strategjike dhe vjetorë është respektuar raporti [60% me 40%] mes sistemeve/fushave me risk të lartë dhe sistemeve/fushave me risk të mesëm/ulët, në zbatim kjo të ligjit nr. 114/2015 “Për

Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli III paragrafi 3 pika 1.6 e 1.7; 3.2; 3.4; 3.5.

Nr	Subjektet e audituara	Lloji i auditimit	Nr. Prot i Programeve
1	Ujësjetllës kanalizime -Sha	Kombinuar	Nr. 1869 datë 19.10.2021 Nr. 03/2 datë 08.04.2022
2	Zbatim Rekomandimesh e lëna nga NJAB		Është përfshirë në programet respektive
3	Bashkia Dropull/Detyrimet e Prapambetura	Përputhshmëri & Rregullshmëri	Nr. 1869 datë 19.10.2021 Nr. 1428/2 datë 30.08.2022 Nr. 1429/4 datë 30.08.2022

Burimi: NJAB/Bashkia Dropull

2.2 Auditimet e planifikuara dhe realizuar nga [NJAB] e Bashkisë Dropull, të klasifikuara sipas llojit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2020	3	3	2	-	1	-	-
2	Viti 2021	3	3	3	-	-	-	-
3	Viti 2022	5	5	4	-	1	-	-

Burimi: NJAB/Bashkia Dropull

Nga auditimi i raportimeve vjetore hartuar nga [NJAB] mbi aktivitetin e saj për çdo vit ushtrimor, të dhënat mbi gjetjet/rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2020	39	17	12	10	2	-	2	-
2	Viti 2021	-							
3	Viti 2022	12	-	12	-	-	-	-	-
TOTALI		51	17	24	10	2	-	2	-

Burimi: NJAB/Bashkia Dropull

2.3 Nga auditimi i dosjeve të Subjekteve të audituara për periudhën 2021-2022, rezultoi se dosjet përmbanin gjithë dokumentacionin konform akteve ligjore/nënligjore në fuqi.

- Nga auditimi i dosjeve të auditimit rezultoi se nga ana e subjekteve të audituara, janë hartuar planet e veprimtimit brenda afatit 30 ditor, me anë të të cilit vihet në dijeni [NJAB] mbi pranimin ose jo të rekomandimeve të lëna dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre; rezultoi se nuk është raportuar nga subjektet e audituara brenda afatit 6 mujor, gjë që ka sjellë mungesën e monitorimit të [NJAB] për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në zbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4. Kjo si pasojë e mungesës së raportimit nga ana e subjekteve të audituara, në moszbatim këto të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësive për të zbatuar rekomandimet e AB”. Nga ana e NJAB janë realizuar misione audituese “Mbi Zbatimin e rekomandimeve të lëna” ku dhe është vlerësuar statusi i zbatimit të tyre, kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 42 datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

- Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna.

Në njësinë e auditimit të brendshëm, Sigurimi i Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të

Brendshëm të kryera gjatë periudhës objekt auditimi është kryer nga grupi i punës që ka realizuar angazhimin e auditimit, pra nga [NJAB] të bashkisë Dropull. Sigurimi i cilësisë është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”.

Për periudhën 2020-2021-2022 nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë së Dropull janë lënë 51 rekomandime, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 17 rekomandime, në proces zbatimi 24 rekomandime dhe 10 pa zbatuar; Ndërsa vetëm në vitin 2022 janë lënë 12 rekomandime të cilat rezultojnë të gjitha në proces zbatimi.

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2021 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm/MFE, shkresa me nr. 347 prot., datë 21.02.2022 me objekt “Dërgohet Programi për Sigurimin e Cilësisë së punës së AB për vitin 2022, si dhe vlerësimi i performancës së veprimtarisë së AB për vitin 2021”;

Për vitin 2022 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm/MFE, shkresa me nr. 407/1 prot., datë 03.03.2023 me objekt “Dërgohet Programi për Sigurimin e Cilësisë së punës së AB për vitin 2023, si dhe Vlerësimi i Performancës së veprimtarisë së AB për vitin 2022”;

Titulli i gjetjes 1: Mbi vlerësimin e aktivitetit të Njesisë së auditimit të brendshëm

Situata:

Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë së Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Dropull, për periudhën e audituar 2021 dhe 2022 u konstatua se:

1. Referuar Planeve Strategjike [2021-2023 dhe 2022-2024] dhe atyre Vjetorë [2021 dhe 2022], planifikimit dhe grafikut të shpërndarjes së misioneve audituese për tu realizuar nga NJAB, regjistrin dhe vlerësimin të riskut, rezultoi se ndihet e nevojshme realizimi i Auditimit IT, pasi konstatimet dhe rekomandimet e të cilit përpos të tjerave, do të mundësonin lehtësi edhe në procesin auditues të fushave/sistemeve të tjera vlerësuar me risk të lartë. Kjo sipas komunikimit me NJAB vjen si rezultat i mungesës së kapaciteteve, për të cilat nga ana e NJAB *duhej të parashtrohej te Titullari me rëndësinë e duhur.*

2. Nga auditimi i planeve strategjike dhe vjetorë të miratuar si edhe realizimit të tyre për vitet 2021 e 2022, rezultoi se NJAB nuk ka planifikuar mision auditues për fushën e “menaxhimit të burimeve njerëzore”, duke rezultuar e klasifikuar me risk të ulët. Vlerësimi jo real me koeficienti risku të kësaj fushe, ka sjellë mungesën e misionit auditues të paktën këto 3 vitet e fundit në strukturën përgjegjëse të menaxhimit të burimeve njerëzore – Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme. Kjo ka sjellë mospërfshirjen në planet strategjike dhe ato vjetorë të të gjitha njësive të strukturës organizative me referim koeficientin e riskut, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, të gjitha këto në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, pika 3.1.2; 3.

3. Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 3 vitet e fundit, rezultoi se numri i rekomandimeve të lëna dhe numri i atyre të zbatuara vijnë në rënie; ndërsa rekomandimet e shprehura në vlerë mbeten në statusin “në proces”.

4. Nga auditimi mbi raportimin në NJAB/ Bashkia Dropull të subjekteve të audituara mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe përcjellë në Raportin Përfundimtar të Auditimit, rezultoi se nuk janë ndjekur hapat e monitorimit të tyre. Ndonëse, NJAB ka ushtruar dy misione audituese “për zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara”, nuk justifikon mospërmbyllje e detyrimit ligjor nga ana e subjekteve të audituara, në mos zbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”

paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4, të “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Përgjegjësi për mos raportim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga misioni auditues i NJAB, kanë edhe subjektet e audituara, në moszbatim të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm”.

Kriteri:

Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manuali i auditimit të brendshëm në sektorin publik” miratuar me Urdhrin e ministrit të financave nr. 100/2016 datë 25.10.2016; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar me Urdhrin e ministrit të financave nr. 8980, dt. 15.07.2010, përditësuar me atë të Urdhrit të ministrit të financave nr. 108/2016.

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e një njësie të plotë të auditimit të brendshëm në strukturën e Bashkisë Dropull, përbën pengesë për mirëfunksionimin dhe performancën e Njësisë së auditimit të brendshëm të bashkisë, si dhe në dhënien e sigurisë titullarit të saj për përmbushjen e objektivave të bashkisë.

Shkaku:

Moszbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon aktivitetin e Njësisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Dropull.

Rëndësia: E mesme.

Për këtë rekomandojmë:

1. Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për plotësimin e Njësisë së auditimit të brendshëm me auditues në përmbushje të kërkesave për hartimin e planeve strategjike e vjetore nga NJAB, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave;
2. Njësia e auditimit të brendshëm të bëjë një vlerësim real të koeficientit të riskut për fushat/sistemet objekt i misioneve audituese; të përfshijë në planet strategjike dhe vjetore sektorët e fushave me risk, siç janë: zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, menaxhimi i burimeve njerëzore, sistemet e teknologjisë së informacionit të implementuar etj., duke respektuar raportin 60/40 mes sistemeve/fushave me koeficient të lartë risku ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët risku në hartimin e planeve strategjike e vjetore të njësisë;
3. Njësia e auditimit të brendshëm, të ndjekë me korrektësi fazën e misionit auditues, pas dërgimit të raportit përfundimtar në subjektin e audituar; t’i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht Njësinë e auditimit të brendshëm sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit;
- Drejtuesi i Njësisë së auditimit brendshëm duhet të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t’ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas Manualit të auditimit të brendshëm, i cili do të ndihmojë në hartimin e një plani strategjik e vjetor sa më efektiv për NJAB.

<u>Titulli i gjetjes 2:</u> <i>Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022</i>

Situata:

1. Nga auditimi rezultoi se VKB nr. 62 datë 24.11.2020 dhe VKB nr. 2 datë 28.01.2021 nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9154 datë 6.11.2003 “Për Arkivat” nenet 23, 24; “Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 13 dhe neni 19 dhe Vendim nr. 4, datë

- 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë”;
- 2.** Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e Bashkisë Dropull, rezulton se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, kryefamiljare, të komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptiane etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “ Për Nxitjen e Punësimit”;
- 3.** Në Bashkinë Dropull për periudhën 2021-2022 informacioni i vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore për punonjësit veçanërisht ata me kontratë të përkohshme (bashkë me njësitë administrative) rezultoi se në aktin e hartuar “për numrin e punonjësve të Bashkisë Dropull dhe nivelit të pagave të tyre” për tu miratuar në Këshillin Bashkiak, nuk është pasqyruar edhe numri i punonjësve me kontratë (me/pa afat apo të përkohshme) të planifikuar si dhe sektorët/drejtoritë që u nevojitet ky kontingjent, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika c, neni 54 pika dh, neni 64 pika j.
- 4.1.** Nga ana e Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk janë bërë pjesë e Rregullores së Brendshme tek “Përshkrimet e Punës” kriteret e veçanta që duhet të plotësohen për çdo pozicion i strukturës organizative;
- 4.2.** Nuk ka pasqyruar numrin e të punësuarve që i nënshtrohen procedurave të Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, në aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak për numrin e punonjësve dhe nivelin e pagave për vitin në vijim;
- 4.3.** Njoftimet për punësim me procedurën sipas Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, janë bërë vetëm në stendat e bashkisë, dhe nuk janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Dropull, nuk janë shpallur në portalin për punësim të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, nuk janë publikuar as në rrjetet sociale të Bashkisë Dropull, kjo në moszbatim të Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, neni 19;
- 5.** Referuar Ligjit 152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, neni 7, pika 5 “Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin **1** zjarrfikës profesionist për **1500-2000** banorë”; pika 6 “Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se **14** zjarrfikës, personel profesionist”, nga auditimi u konstatua se njësia e MZSH-së në Bashkinë Dropull, *nuk janë respektuar kriteret* përsa i përket numrit të personelit zjarrfikës profesionist, duke e tejkaluar me të punësuar me kontratë të përkohshme, paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak pa dhënë një relacion argumentues, pasi është një numër i konsiderueshëm të punësuarish sezonal për këtë sektor; nisur nga numri i banorëve, Bashkia Dropull hyn në kategorinë nga [20000-50000] banorë, duhet që njësia e MZSH-së në këtë bashki të ketë 15 zjarrfikës personel profesionist;
- 6.** Nga auditimi i dosjeve të personelit në pozicionin “shofer”, rezultoi se për automjete me destinacion të veçantë, që duhet të përdoren nga drejtues që janë të pajisur me “leje drejtimi” dhe me “dëshmi aftësie profesionale” (sipas llojit të mjetit që ka në përdorim), punonjësit e punësuar si drejtues mjeti (shoferë), u konstatua se *nuk janë të gjithë të pajisur* me dokumentacionet justifikuese profesionale, në moszbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 200 datë 16.05.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”;
- 7.** Nga të dhënat e pasqyrës së pagave, rezulton se fondi i pagave në Bashkinë Dropull për vitin 2021 zë 17.2% të buxhetit faktik dhe për vitin 2022 zë 20.5% të tij. Nga auditimi mbi

planifikimin e fondit të pagave, **konstatohet** se: nuk ka fond për shpërblime mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve me “Status të Nëpunësit civil”; gjithashtu për punonjësit me “kod pune” nuk zbatohet VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”;

8. Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2021-2022 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan:

- Në *dosjet e personelit* mungonin: praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; për pozicionet “shoferë” dhe punonjës A.K dokumenti mbi formimin arsimor të tyre; formulari i vetdeklarimit; Kontratat e punës të paregjistruara në Protokollin e Bashkisë; Urdhri për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së punonjësit K.G duhet të përpilohej veçmas nga Urdhri për emërimin në punë të punonjësit J. Xha, ndonëse zëvendësuan njëri tjetrin;

- *Dosjet e punonjësve të larguar* nuk kishin praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV.

Kriteri: Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr.152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”; Ligjin nr. 8224, datë 15. 5. 1997 “Për policinë Bashkiake”; VKM nr.313/2002 “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së Bashkisë dhe Komunës” i ndryshuar; VKM nr.165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr. 177, datë 08.03.2017; VKM nr.895/2016 “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të Gradave, njësimit e funksioneve koresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018 ; VKM nr. Nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”; Ligjin nr.183/2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”; VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, Ligjin nr. 9154 datë 6.11.2003 “Për Arkivat”; “Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”; Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë”.

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e politikave efektive të burimeve njerëzore ka cenuar garantimin e kriterëve dhe kërkesave të përshtatshme mbi bazën e kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit; mos zbatimi i kërkesave ligjore për shpalljen e vendeve vakante ka cenuar parimin e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Shkaku:

Mungesa e vëmendjes për një vlerësim real të rëndësisë së përcaktimit të kriterëve profesionale në rekrutimin dhe emërimin e stafit nga ana e NA, Drejtorisë së burimeve njerëzore dhe

shërbimeve mbështetëse dhe Komisionit të punësimit në Bashkinë Dropull si dhe e publikimit të vendeve vakante konform kërkesave ligjore në fuqi.

Rëndësia: E mesme

Për këtë rekomandojmë:

1.1: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, të kompozojnë dhe miratojnë një strukturë organizative, konform funksioneve që i atribuon ligji, të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, me qëllim motivimin e punonjësve në rritjen e efektivitetit të shërbimeve që bashkia i ofron komunitetit.

1.2 Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme të marrë masa të regjistrojë çdo akt administrativ të miratuar konform akteve ligjore të arkivave, për hartimin e kriterëve specifike për pozicionet e veçanta në strukturë, të cilat kërkojnë arsimin profesional përkatës apo certifikatë profesionale.

Të shpallë në portalin e punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Dropull, vendet vakante dhe për pozicionet me Kod pune, të caktojë në strukturën organizative pozicione për kategorinë “grup i veçantë”, plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin përkatës, për të rritur performancën e shërbimeve dhe arritjen e objektivave institucionale në dobi të komunitetit.

(Nga subjekti audituar në fazën e Projekt Raportit nuk janë paraqitur kundërshti).

Pika 2.2 e programit: Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2022

- *Programimi i PBA 2022-2024 dhe programimi i buxhetit vjetor 2022, 2023 dhe 2024.*

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhër të Titullarit të Institucionit nr .01, datë 15.01.2021, të cilat kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB nr. 36, datë 30.7.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresë nr. 720/1, datë 10.8.2021. Projekt buxheti për vitin 2022-2024 është hartuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresë nr. 1650, datë 15.09.2021 me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2022-2024. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2022-2024, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 12 - programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2022-2024 janë përcaktuar “Përshkrimi” i çdo program, “Politika e programit”, “Qëllimi i Politikës së programit”, “Objektivat e politikës së programit”. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij, shpërndarja e fondeve sipas programeve paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

- Programimi i shpenzimeve për vitin 2022-2024 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Plani Menaxh Administrativ	70,047	16	71,450	22	73,200	29
2	Pastrim Gjelbërim	21,697	5	23,800	7	25,150	10
3	Arsimi Parashkollor	3,411	1	3,000	1	3,000	1
4	Arsimi i mesëm	4,550	1	4,945	2	5,500	2
5	Sherbime kulturore	3,335	1	2,940	1	3,020	1
6	Shërbimi Zjarrfikës	16,150	4	17,000	5	17,305	7
7	Ujitja Kullimi	10,365	2	8,970	3	9,500	4
8	Rrugët Rurale	59,127	14	37,872	11	39,923	16
9	Administrim Pyjor	14,880	3	10,000	3	10,000	4
10	Fond rezerve, kontigjencës	5,000	1	5,000	2	4,990	2
11	Ujësjetësi, Investime	176,000	40	91,815	28	10,000	4
12	Ndriçimi rrugor	8,743	2	10,000	3	10,000	4
	Shuma	393,305		286,792		211,588	
	Ndihma ekonomike paaft	40,300	9	42,000	13	2,270	16
	Gjendja Civile	2,270	1	2,270	1	2,270	9
	TOTALI	435,875	100	331,062	100	216,128	100

Ndërsa ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2022-2024, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Pag, sig., Bashkia, Gj. Civ e QKB	103,694	23.8	96,590	29.2	98,560	38.5
2	Shpenz (602, 603, 604 dhe 606)	101,853	23.4	99,640	30	100,800	39.4
3	Investime	230,328	52.8	134,832	40.8	56,498	22.1
	Total	435,875	100	331,062	100	255,858	100

Sipas PBA 2022-2024 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:
Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2022-2024.

A	Të ardhurat	2022	2023	2024
1	Nga taksat	31,243	31,543	32,246
2	Jo tatimore	39,924	34,924	34,944
I	Totali	71,167	66,467	67,190
1	Transferta e pakushtëzuar	83,191	86,681	92,525
2	Transfertës specifike	35,027	34,810	34,810
II	Shuma e transfertave	118,218	121,491	127,335
III	Totali i burimeve të veta (I +II)	189,385	187,958	194,525
IV	Te trashëguara	30,718	0	0
V	Transferta e kushtëzuar	215,786	144,101	62,270
	TOTALI III+IV+V	435,889	332,059	256,795

Për vitin 2022 buxheti është miratuar me VKB nr. 72, datë 22.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. Prot. 1198/1 datë 07.01.2022.
Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Dropull për vitin 2022 paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhurat e vitit	71,168	
2	Te trashëguara	30,718	
3	Transfertës e pakushtëzuar (grandi)	83,191	

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
4	Transfertsë specifike	35,028	
	Shpenzimet		220,105
6	Paga dhe sigurime shoqërore (600+601)		101,424
7	Shpenzime materiale (602)		55,003
8	Transferta të brendshme (604)		1,550
9	Fond rezerve, fond i kontigjencës (609)		5,000
10	Transferta për individë (606)		2,800
11	Investime kapitale (231)		54,328
Totali i buxhetit		220,105	220,105

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2022** shpenzimet buxhetore janë planifikuar për vlerën 220,105 mijë lekë, këto do përballohen nga të ardhurat e vitit dhe të trashëguara në vlerën 101,886 mijë lekë ose 46 %, grandit në vlerën 83,191 mijë lekë ose 38 % dhe në transfertat specifike sektoriale në vlerën 35,028 mijë lekë ose 16 % e totalit të tyre.

Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2022 shpenzimet për paga e sigurime zënë 46 % ose në vlerën 101,424 mijë lekë, shpenzime korrente zënë 25 % ose për vlerën 55,003 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 25 % ose në vlerën 54,328 mijë lekë.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të miratuar në fillim të vitit 2022.

Nr	Shpenzimet sipas artikujve	Viti 2022		
		Plani fillim viti	Fakti, sipas thesarit	% e realizimit
1	Paga dhe sigurime shoqërore (600+601)	101,424	99,155	97.8
<i>a</i>	<i>Të ardhura +grandi</i>	68,672	68,588	99.9
<i>b</i>	<i>Transfertsë specifike</i>	32,752	30,567	93.3
	Shpenzime materiale (602)	55,003	37,762	68.7
<i>a</i>	<i>Të ardhura +grandi</i>	52,727	34,719	65.8
<i>b</i>	<i>Transfertsë specifike</i>	2,276	3,043	133.7
	Transferta të brendshme (604)	1,550	4,551	293.6
<i>a</i>	<i>Të ardhura +grandi</i>	1,550	4,551	293.6
<i>b</i>	<i>Transfertsë specifike</i>	0	0	0.0
	Fond rezerve, fond i kontigjencës (609)	5,000	0	0.0
<i>a</i>	<i>Të ardhura +grandi</i>	5,000	0	0.0
<i>b</i>	<i>Transfertsë specifike</i>	0	0	0.0
	Transferta për individë (606)	2,800	43,117	1539.9
<i>a</i>	<i>Të ardhura +grandi</i>	2,800	43,117	1539.9
<i>b</i>	<i>Transfertsë specifike</i>	0	0	0.0
	Investime kapitale (231)	54,328	299,161	550.7
<i>a</i>	<i>Të ardhura +grandi</i>	54,328	297,680	547.9
<i>b</i>	<i>Transfertsë specifike</i>	0	1,481	0.0
	Totali	220,105	483,746	219.8

- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Gjyrokastër dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare dhe ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit, për vitin 2022 buxheti shtesë gjithsej është në **vlerën 423,152 mijë lekë** e analizuar si më poshtë:

Nr	Burimi i financimit	Vlera 000/lekë
1	Fond për investime ardhur nga Agjensia UK me shkresë nr...., datë....	177,328
2	Fond për investim për objekti shkolla Bularat, me shkresë nr...datë....	30,000
3	Fonde te celura gjatë 2022, per projektet ndërkufitare dhe te delegac. B.E, si Polyphonia 4,681 mijë lekë Extroverd roads 69,464 mijë lekë, CLLD-CULTOUR 14,374 mijë lekë dhe SOCIALE-E 31,888 mijë lekë, me shkresë nr..., datë....	120,408
4	Ndihma ekonomike paaftësi, me shkresë nr..., datë....	39,023
5	Fond për Gj. Civile, me shkresë nr..., datë....	2,630
6	Transfertes e kushtëzuar për mbrojtjen civile, me shkresë nr..., datë....	2,779
7	Transfertes për shpenzime ndërkufitare bashkëfinancim ardhur nga MFE, me shkresë nr..., datë....	40,550
8	Të ardhura të trashëguara	9,024
		421,742

- Shkalla e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet periodike të monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2022 referuar akt akordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2022			
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja në Thesarit sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakordimet	% realizimit
	Paga (600)	86,911	86,178	84,858	98.4
	Sigurime shoqërore (601)	14,513	15,292	14,297	93.5
	Shpenzime operative (602)	55,003	51,987	37,762	72.6
	Transferta (604)	1,550	4,779	4,551	95.2
	Inv (230 +231)	54,328	315,997	299,161	94.7
	Transferta 606 ndihma paaftësi	2,800	44,719	43,117	96.4
	609	5,000	3,897	0	0
	Projekte B.E		120,408	0	0
	Totali	220,105	643,257	483,747	75

Për periudhën objekt auditimi realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimet me thesarin për vitin 2022 nga 643,257 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 483,747 mijë lekë ose në masën 75 %.

- *Struktura e shpenzimeve sipas burimeve të financimit paraqiten në tabelën si më poshtë:*

Nr	Emertimi	Viti 2022							
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja në Thesarit sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakordi met	Te ardh Veta+tra sheguara	Grand 2022+ trasheg	Trans. Kushtez Spec.	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Per Inv.
1	Paga (600)	86,911	86,178	84,858	23,980	32,687	25,978	2,213	0
2	Sigurime (601)	14,513	15,292	14,297	4,852	4,510	4,589	346	0
3	Shpenzime (602)	55,003	51,987	37,763	29,123	5,596	3,043	0	0
4	(604)	1,550	4,779	4,551	400	1,550	0	2,601	0
5	F. Rezerv 609	5,000	3,897	0	0	0	0	0	0
6	Inv(230 +231)	54,328	315,997	299,161	12,301	83,827	1,481	0	201,552
7	Transferta 606	2,800	44,719	43,117	2,152	3,312	0	37,653	0
	Totali	220,105	643,257	483,748	72,808	131,483	35,091	42,813	201,552

Pagat (600) nga 86,178 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 84,858 mijë lekë ose 98 %, sigurime shoq. (601) nga 15,292 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 14,297 mijë lekë ose 93%, shpenzime operative (602), nga 51,987 mijë lekë janë realizuar 37,763 mijë lekë ose 73 % dhe shpenzime për investime (230-231) nga 315,997 mijë lekën të planifikuara janë realizuar 299,161 mijë lekë ose 94%.

Sa më sipër për shpenzimet operative (602), nga 51,987 mijë lekë janë realizuar 37,762 mijë lekë të dhënat në tabelën si më poshtë:

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative, në mënyrë analitike për vitin 2022.

Nr	Emertimi	Viti 2022		
		Plani	Fakti	% e realizimit
	602 Shpenzime operative			
1	Materiale zyre e te përgjithshme	4,622	4,150	89.8
2	Materiale dhe sherbime speciale	1,086	614	56.5
3	Sherbime nga te trete	14,518	13,066	90.0
4	Shpenzime transporti	10,750	8,114	75.5
5	Shpenzime udhëtimi	675	610	90.4
6	Shpenzime per mirëmbajtje te zakonshme	10,788	2,535	23.5
7	Shpenzime te tjera operative	9,593	8,674	90.4
	SHUMA	52,032	37,763	72.6

Investime (230-231) nga 315,997 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 299,161 mijë lekë analizon arsyet e mosrealizimeve me tabelë.

Planifikimi dhe realizimi i investimeve, në mënyrë analitike për vitin 2022.

Nr	Emertimi 230-231 Shpenzime për Investime Objekte	Vlera sipas Burimi financimit		Viti 2022		
		Bashki	Ministri	Plani	Fakti	% e realizimit
				315,997	299,161	
1	Pagese per Extrovert Road	58,418		58,418	57,390	98%
2	Pagese per projektin cclid coutour	5,541		5,541	5,541	100%
3	Pagese per projektin Polifonin	4,197		4,197	4,180	99%
4	Pagese per projektin Sociale	2,100		2,100	1,606	77%
5	Mbrojtja e rrugës me gabion dhe muri mbajtës Koshovice	4,400		4,400	4,400	100%
6	Supervizimi "Mbrojtja malore dhe muri mbajtës koshovice"	171		171	118	69%
7	Kolaudim "Mbrojtja malore dhe muri mbajtës Koshovice"	26		26		0%
8	Rikonstrukcion rrugët e brendshme ,hyrja Vrisera	12,239		12,239	12,106	98%
9	Supervizimi/kolaudim rikonstrukcion rrugët e brendshme dhe hyrja Vrisera	240		240	159	67%
10	Inventar ekonomik	1,100		1,100	221	20%

Nr	Emertimi 230-231 Shpenzime për Investime Objekte	Vlera sipas Burimi financimit		Viti 2022		
		Bashki	Ministri	Plani	Fakti	% e realizimit
11	Blerje mjet vetëshkarkues	3,000		3,000	2,400	80%
12	Pajisje zjarrfikëse	120		120		0%
13	Motor pompe zhytëse	603		603	600	99%
14	Ndërhyrje e kabine e pompave	500		500	480	96%
15	Furnizim vendosje kondicioner	1,200		1,200	1,192	99%
16	Kolaudim furnizim me ujë nga pus shpimet	991		991	275	28%
17	Rikonstrukson i rrjetit te vjetër rruga Pogon	7,200		7.200	6.833	94%
18	Supervizimi rikonstrukson i rrjetit te vjetër rruga Pogon	108		108	108	100%
19	Ujesjelles i manxifes		60,000	60,000	60,000	100%
20	Kolaudim ujësjellës i manxifes		692	692	594	86%
21	Supervizimi ujësjellës i manxifes		850	850	850	100%
22	Furnizim me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal		23,423	23,423	23,124	98%
23	Supervizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit Rajonal		1,287	1,287	1,287	100%
24	Rikonstrukson i rrjeteve te ujësjellësve zërat Vanister Haskove		35,543	35,543	35,478	99%
25	Supervizimi rikonstrukson i rrjeteve te ujësjellësve zërat vanister haskove		500	500	500	100%
26	Rikonstrukson i rrjetit te brendshëm Dervician Sofratik Terihat		54,777	54,777	54,434	99%
27	Supervizimi i rrjetit te brendshme Dervician Sofratik Terihat		256	256	256	100%
28	Rikonstrukson Shkolla Bularat dhe kopshti		30,000	30,000	25,029	83%

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “Detyrimet e prapambetura” sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)			
a	Hua sftatgjatë			
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër			
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)			3.44%
a	Shpenzime korrente			

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të
a,1	Mallra dhe shërbime	8,960,119		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shpenzime kapitale			
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore			
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	8,960,119	260,655,000	3.44%

- Mbi detyrimet e prapambetura të raportuara Janar-Dhjetor 2022 sipas raportimit në MFE.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2021	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2022-31.12.2022	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022
Investime	2,998,286	238,566,494	241,564,780	61,373,731	180,191,049
Investime nga FZSHS	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	0	8,960,119	8,960,119	0	8,960,119
Vendime gjyqësore	0	0	0	0	0
Të tjera	0	0	0	0	0
Totali	2,998,286	247,526,613	250,524,899	61,373,731	189,151,168

Në totalin e faturave të palikujduara në fund të vitit 2022, konstatohet se vlera 180,191,049 lekë detyrimet e investimeve me fondet e Ministrisë së linjës (ujësjells), të cilat nuk dërgohen në raportimet me Ministrinë e Financave. Ndërsa vlera 8,960,119 lekë janë detyrimet e energjisë elektrike në vite sipas aktmarrëveshjes me Ndërmarrjen e Ujësjiellës kanalizime.

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikujduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të vitit ushtrimor rezultoi se:

Për vitin 2022 detyrimet e raportuara janë vlerën 0 lekë, në PF të vitit 2022 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë për llogarinë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 1,359,046 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 189,151,168 lekë gjithsej në vlerën **190,510,214 lekë**, e cila është e analizuar, si më poshtë:

Nr	Emëri i furnitorit	Fatura		Vlera lekë
		Nr.	Datë	
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”				
1	Energji elektrike			656,690
2	Këshilltarët kryetaret e fshatrave			455,430
3	Këshilltarët kryetaret e fshatrave			7,225
4	% posta shqiptare			5,475

Nr	Emëri i furnitorit	Fatura		Vlera lekë
		Nr.	Datë	
5	Ndihma ekonomike			234,226
Llogaria 467“Kreditorë të ndryshëm”				189,151,168
1	GB CIVIL Interering	37/2021	20.10.2021	16,859
2	R.....U	1/2022	28.7.2022	7,285,993
3	R.....U	2/2022	23.8.2022	56,206,215
4	B.....S	33/2022	29.12.2021	44,172,136
5	B.....S	39/2022	13.7.2022	64,434,255
6	K....N	130/2022	29.4.2022	9,075,591
7	Energji elektrike (FSHU)	Akt- Marrëveshje	25.8.2022	8,960,119
Totali				190,510,214

Mos kuadrimi midis debitorëve të përcjellë në Ministrinë e Financave dhe ato të bilancit, kryesisht për llog. 401-408 është se vlera 1,359,046 lekë përfaqësojnë detyrimet e muajt dhjetorë 2022 të cilat nuk raportohen.

- Fondi rezervë/dhe kontigjencës

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2022, është miratuar në vlerën 5,000 mijë lekë, si dhe shtesa prej 0 mijë lekë. Mbetet e pa përdorur paraqitet vlera prej 3,897 mijë lekë.

- Raportet e Monitorimit

Për vitin 2022, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

Me shkresën nr. 973, datë 01.6.2022 është miratuar dhe dërguar raporti 4 mujorë dhe me shkresën nr. 1641, datë 29.9.2022 është dërguar raporti 8 mujori.

Raporti vjetor është dërguar me shkresën nr. 371, datë 28.2.2023, miratuar me vendim të KB nr. 6, datë 28.2.2023.

- Mos respektimi i afatit 30 ditëve të likuidimit të faturave,

Nr	Fatura (nr/datë)	Data e regjistrimit ne SIFQ	Vlera /602	Vlera /231
1	37/2021 dt 20.10.2021	22.07.2022		255,587
2	11/2021 dt 29.12.2021	22.07.2022		9,641,918
3	7/2021 dt 29.12.2021	22.07.2022		418,000
4	33/2022 dt 20.06.2022	22.07.2022		57,000,000
5	40/2021 dt 16.10.2021	22.07.2022		2,589,548
6	130/2022 dt 29.04.2022	05.08.2022		13,712,645
7	388/2022 dt 11.04.2022	31.05.2022		1,196,553
8	61492/2022 dt 28.04.2022	31.05.2022	64,530	
9	130/2022 dt 29.04.2022	27.12.2022		38,000,000
10	15/2022 dt 25.02.2022	27.12.2022		7,433,671
11	20/2022 dt 31.03.2022	31.03.2022		2,439,242
Totali			64,530	132,687,164

Nga të dhënat konstatohet se për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 janë likujduar jashtë afatit ligjorë 11 fatura me vlerë 132,751,694 lekë, nga e cila në artikullin (602) është një faturë në vlerën 64,530 lekë dhe në artikullin (231) janë 10 fatura me vlerë 132,687,164 lekë.

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZHSH dhe Ministrisë së linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nr	Objekti i kontratës	Fond Planifikuar	Burimi i Financimit	Kontrata me subjektin		Vlera me TVSH	Subjekti i kontraktuar	Pagesa sipas periudhave		Mbetet
				Nr. Datë	Afati			2021	2022	

Nr	Objekti i	Fond	Burimi i	Kontrata me subjektin		Vlera me	Subjekti i	Pagesa sipas periudhave		Mbetet
I.Me fonde nga Ministrinë e Linjës dhe donacione										
1	Rikonstruksion ujësjellësi Dervician Sofratik Terihat	120,286,360	Ministria e infrastrukturës dhe e energjisë	793/11.05.2021	14.12.2022	142,830,639	K....N	48,868,726	52,434,363	41,527,550
2	rikonstruksion i rrjeteve te ujësjellësve zërat vanister gorice	210,633,067	Ministria e infrastrukturës dhe energjisë	760/06.05.2021	04.01.2023	247,136,960	R.....U	80,464,172	35,000,000	131,672,788
3	supervizimi rikonstruksion ujësjellësi e Dervician Sofratik Terihat	2,129,890	Ministria e infrastrukturës dhe energjisë	853/07.06.2021	Sipas veprës	2,290,317	G....G	510,845	655,587	1,123,885
4	supervizimi rikonstruksion i rrjetit te ujësjellësve te fshatrave zërat vanister ,etj	3,019,592	Ministria e infrastrukturës dhe energjisë	920/03.06.2021	Sipas veprës	3,186,545	Z....T	1,024,702	500	2,161,343
Totali		336,068,909	-	-	-	395,444,461		130,868,445	88,090,450	176,485,566

NR	Situacionet e objektit	Plani I Detajimi te buxhetit sipas viteve	VLERA	FATURA	Urdhër shpenzimi
1	Furnizim me ujë nga pus shpimet I ujësjellësit rajonal Dropull i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës te fshatrave goranxi dhe dervician				
	Situacioni nr 1	Shkresa nr.1018 prot dt. 27,04,2020	19,659,585	19,659,585	599/20.11.2020
	Situacion nr 2	Per vitin 2020 vlere 19,999,800	52,725,840	50,000,000	674/15.11.2021
				2,725,840	279/21.07.2022
	Situacion përfundimtar	Per vitin 2021 vlere 19,999,800	20,398,174	12,573,257	287/26.07.2022
Situacion përfundimtar	Per vitin 2022 vlere 59,999,400	7,824,917		520/23.12.2022	
SHUMA		Gjithsej 99,999,999	92,783,599	92,783,599	(0)
2	Ujësjetesi nga burimi I Manxifes & rikonstruksion I ujësjellësit te fshatrave Selo,Llovine,Krioner Sotire faza II				
	Situacioni nr 1		24,925,807	24,925,807	424/01.09.2020
	Situacioni nr 2	Per vitin 2020 vlere 79,335,820	38,960,045	38,960,045	598/20.11.2020
	Situacioni nr 3		15,449,074	15,449,074	672/ 23.12.2020
	Situacioni nr 4	Per vitin 2021 vlere 100,000,000	20,211,627	20,000,000	460/19.07.2021
				211,627	645/08.11.2021
Situacioni nr 5	Per vitin 2022 vlere 217,343,278	52,837,146	39,788,373	746/22.12.2021	

NR	Situacionet e objektit	Plani I Detajimi te buxhetit sipas viteve	VLERA	FATURA	Urdhër shpenzimi
				13,048,773	755/2912.2021
	Situacioni nr 6	Gjithsej 396,679,098	21,387,932	16,951,227	765/30.12.2021
				4,436,705	769/31.12.2021
	Situacioni nr 7		104,172,136	60,000,000	278/21.07.2022
				44,172,136	88/10.03.2023
	Situacioni nr 8		63,434,255	13,827,864	88/10.03.2023
	Situacion përfundimtar		51,660,989		
	SHUMA		393,039,011	291,771,631	(101,267,380)
Rikonstrukcion i rrjeteve te brendshme te ujesjellesit te fshatrave Zervat Vanister Haskove Dhuvjan etj					
	Situacionet e objektit	Shkresa 215 prot dt.28.01.2021	VLERA	FATURA	URDHER SHPENZIMI
	Situacioni nr 1		28,040,225	28,040,225	474 dt 23.07.2021
	Situacioni nr 2	Per vitin 2021 vlere 50,464,172	22,423,947	22,423,947	565 dt 16.09.2021
	Situacion nr 3		40,149,387	30,000,000	758 dt 29.12.2021
		Per vitin 2022 vlere 20,000,000		10,149,387	282 dt 21.07.2022
	Situacion nr 4		32,136,606	24,850,613	288 dt 29.07.2022
		Per vitin 2023 vlere 20,000,000		7,285,993	89 dt 10.03.2023.
	Situacion nr 5		56,206,215	12,713,935	89 dt 10.03.2023.
	situacion nr 6	Gjithsej 90,464,172	26,400,000		
	Situacion përfundimtar		41,780,581		
	SHUMA		247,136,961	135,464,100	(111,672,861)
Rikonstrukcion I rrjetit te brendshem te ujesjellesit te fshatrave Dervician ,Sofratik Terihat					
	Situacionet e objektit		VLERA	FATURA	URDHER SHPENZIMI
	Situacion nr 1	Shkresa nr.213 prot dt.28.01.2021	28,868,726	28,868,726	458 dt 16.07.2021
	Situacion nr 2		20,000,000	20,000,000	618 dt 08.11.2021
	Situacion nr 3	Per vitin 2021 vlere 28,868,726	63,509,954	14,434,363	321 dt 04.08.2022
		Per vitin 2022 vlere 14,434,363		40,000,000	521 dt 23.12.2022
				9,075,591	87 dt 10.03.2023
	Situacion përfundimtar		30,451,024	580,861	90 dt 10.03.2023
		Per vitin 2023 vlere 14,434,363			
	SHUMA	Gjithsej 57,737,452	142,829,704	112,959,541	(29,870,163)

Nga të dhënat konstatohet se në fund të vitit 2022 gjendja e vlerës së kontratave të lidhura dhe paguara është në shumën 250,026,804 lekë, kjo pasi fondet janë të planifikuara me Ministrinë e linjës dhe se planifikimi i likuidimit të kontratave është në disa periudha ushtrimore, planifikim i cili nuk është respektuar nga Ministrinë e linjës duke krijuar një detyrim të faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore megjithëse objektet i kanë mbyllur punimet. Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Bashkinë Dropull jepet nga pasqyrat në vijim:

Në mijë lekë

Emertimi		Plan	Fakt
Kap.1 (Granti)	600	59,769	58,665
	601	10,005	9,099
Kap.5(Te ardhurat)	600	24,179	2,398
	601	4,917	4,852

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81 dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr.37, datë

06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe pikën 15 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.5.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

- Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për investime/blerje malli etj.

Për periudhën e vitit 2022 janë parashikuar realizimi i procedurave të vlerë të lartë dhe të ulët në artikullin (602/231) në shumën 130,994,200 lekë, nga e cila:

- a- Prokurime me vlerë të lartë 115,340,010 lekë për 13 procedura.
- b- Prokurime me vlerë të vogël me vlerë 15,654,191 lekë kjo për 40 procedura.

Në fakt nga të parashikuara janë realizuar vlera 109,954,949 lekë, nga e cila:

- a- Procedura me vlerë të lartë 99,617,511 lekë.
- b- Procedura me vlerë të vogël 10,337,438 lekë.

Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2022, për artikullin (602/231) janë në vlerë 181,550,095 lekë, nga e cila:

- a- Procedura me vlerë të lartë 180,191,049 lekë.
- b- Procedura me vlerë të vogël janë 1,359,046 lekë.

Në lidhje me procedurat e mosrealizuara dhe të planifikuara për periudhën 2021-2022, kemi këtë situatë:

Për vitin 2021

Nuk janë realizuar 4 procedura, si vijon:

- 1) Rikonstruksioni ne ujësjellësit ishte planifikuar në vlerën 6,750,833 lekë dhe nuk u realizua per arsye se qeveria Shqiptare ka miratuar 2 (dy) projekte te mëdha ujësjellësit per Bashkinë tone te cilat përfshinin edhe këtë procedure ndaj dhe Bashkia e pa te pa arsyeshme te zhvillonte nje procedure te tille.
- 2) Rikonstruksioni I sistemit te ngrohjes në vlerën 2,533,333 lekë, nuk u realizua per arsye se nuk kishim nje projekt te realizueshëm konkret.
- 3) Per blerjen mjet vetëshkarkues me vlerë 2,500,000 lekë, procedura u krye por nuk arriti te lidhte nje kontrate per arsye se operatori ekonomik nuk përmbushte kriteret e vendosura ne DST.
- 4) Blerje mjet me vlerë 2,083,333 lekë, nuk u realizua per arsye se nuk u realizua plani I te ardhurave te parashikuara.

Për vitin 2022:

- 1) Blerje automjeti me vlerë 2,500,000 lekë, nuk u zhvillua per arsye se nuk u be tenderimi i procedurës.
- 2) Hartimi i planit te mbarështimit me vlerë 8,250,000 lekë, nuk u realizua per arsye se u be procedura e prokurimit shërbim konsulence me dy faza, faza e dyte u be shkresore e cila ishte e gabuar dhe nuk u arit te ritenderohet.
- 3) Blerje beton me fond 2,500,000 lekë, ishte planifikuar per mirëmbajtjen e rrugëve ne Pogon, pas nje marrëveshje me shoqërinë “T.“ dhe dhurimin e çimentos u planifiku procedure “Rikonstruksion i pjesshme i rrjetit të vjetër rrugor të njësisë administrative Pogon me shtresë betoni” per Bashkinë Dropull.
- 4) Blerje mjet gjurmimi me vlerë 3,139,166 lekë, nuk u realizua per arsye se qeveria Shqiptare vendosi t’i dhuronte Bashkise tone nje mjet te tille.

Përsa i përket procedurave me vlere te vogel te perealizuara per vitet respektivisht 2021-2022 arsyeja ka qene mos planifikimi i sakte nga ana e drejtuesve te programeve dhe ndjekja e buxhetit te planifikuar nga ana e drejtorive respektive.

- Mbi zhvillimin e aktiviteteve kulturore.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë, konstatohet se aktivitet kulturore me vlerë 791,899 lekë, janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Nr	Emertimi	Urdhër prokurimi	Nr urdhër shpenzimi	Vlera Plan	Vlera Fakt
1	Aktivitet i Hënës se Bardhe dhe karnavalet	nr 4 dt 24,02,2022	83 dt 10,03,2023	133,404	128,400
2	Aktivitet kulturor pe 25 Marsin	nr 5 dt 06,03,2022	90 dt 01,04,2022	18,000	12,000
3	Aktivitet kulturor çelja e sezonit turistik	nr 15 dt 12,05,2022	182 dt 25,05,2022	112,800	90,000
4	Organizim aktiviteti per batalionin	nr 28 dt 23,08,2022	354 dt 08,09,2022	84,000	63,999
5	Materiale per aktivitetin Dropull Internacional Film Festival 2	nr 26 dt 05,08,2022	367dt 21,09,2022	624,960	497,500
	TOTALI			973,164	791,899

- Mbi përdorimin e karburantit.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi mënyrën e përdorimit të karburantit për vitin 2021 dhe 2022, rezulton se:

Vlera e karburantit e përlllogaritur dhe programuar për tu prokuruar është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë , gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogjenerator, kaldaja, etj.*) në qarkullim e gjendje pune inventar i Bashkisë Dropull, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit.

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se nuk ka diferenca midis sasisë së bërë hyrje/dalje/ dhe gjendje ne fund te periudhave ushtrimore, kjo sipas mjeteve. Karburanti menaxhohej nëpërmjet kartave elektronike për cdo mjet, i cili furnizohej sipas urdhrave të punës të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe argumentuar nëpërmjet fletudhëtimeve për çdo mjet. Disponoheshin procesverbalet e konsumit të karburantit për cdo mjet.

Kështu kemi këtë rezultat:

Tabela për vitin 2021

Përshkrimi i veprimit	Sasi Litra
Gjendje nga viti 2020 magazina	6704
Hyrje viti 2021	30224
Dalje (përdorimi) viti 2021	33225
Gjendje sipas me 31.12.2021	3703

Tabela për vitin 2022

Përshkrimi i veprimit	Sasi Litra
Gjendje nga viti 2021 magazina	3703
Hyrje viti 2022	30479
Dalje (përdorimi) viti 2022	34182
Gjendje sipas me 31.12.2022	0

Të dhënat për cdo mjet mbi sasinë e furnizuara dhe shpërndara janë në Aneksin 2.1 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi:

Znj. TH.P me detyrë Drejtoresh e Buxhetit dhe Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Titulli gjetjes 1: Mbi zbatimin e buxhetit viti 2022

Situata:

Nga auditimi ka rezultuar se plani i shpenzimeve në fillim të vitit është miratua në vlerën 220,105 mijë lekë, gjatë vitit ka pësuar rritje kryesisht për investime nga financime të Ministrisë për ujësjellës, donacione nga projektet e BE si dhe ndihma ekonomike dhe paaftësi në vlerën 423,152 mijë lekë pra shpenzimet buxhetore gjithsej për vitin janë në vlerën 643,257 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 483,747 mijë lekë ose 75%.

U konstatua se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit për disa zëra të shpenzimeve buxhetore, që mbulohen nga të ardhurat e veta, kështu shpenzime operative është planifikuar në vlerën 55,003 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 34,719 mijë lekë, ose në masën 63%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 54,328 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 12,301 mijë lekë, ose në masën 23 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dropull në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Për periudhën e vitit 2022 janë parashikuar realizimi i procedurave të vlerë të lartë dhe të ulët në artikullin (602/231) në shumën 130,994,200 lekë, nga e cila: prokurime me vlerë të lartë 115,340,010 lekë për 13 procedura dhe prokurime me vlerë të vogël me vlerë 15,654,191 lekë kjo për 40 procedura.

Në fakt nga të parashikuara janë realizuar vlera 109,954,949 lekë, nga e cila: procedura me vlerë të lartë 99,617,511 lekë dhe procedura me vlerë të vogël 10,337,438 lekë.

Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2022, për artikullin (602/231) janë në vlerë 181,550,095 lekë, nga e cila: procedura me vlerë të lartë 180,191,049 lekë dhe procedura me vlerë të vogël janë 1,359,046 lekë.

Situata financiare e Bashkisë Dropull, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 dhe gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 3.44 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare.

Kriteri:

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në mospërputhje me pikën (a) të nenit 5 dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe vendimet përkatëse të këshillit bashkiak.

Ndikimi/Efekti:

Mos planifikimi i saktë i buxhetit sipas nevojave të bashkisë, çon në mos realizim buxheti dhe mos planifikim të fondeve të sektorë të domosdoshëm për interesat e bashkisë.

Shkaku:

Mungesa e bashkëpunimit midis sektorëve të planifikimin e buxhetit në fillim të periudhave ushtrimore

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe sektorët e tjerë të bashkisë, të marrin masa për hartimin e një buxheti sa më real në raport me strukturën aktuale të bashkisë, të planifikimit të procedurave të prokurimit për investime/shërbime dhe blerje mallrash sipas nevojave që vetë bashkia ka dhe jo të planifikohen jashtë mundësive reale të cilat dështojnë në fazën e zbatimit të tij.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektori i Menaxhimit të kontratave), të marrin masa për likuidimin e të gjitha faturave të depozituara me dokumentacion të rregullt ligjorë, si dhe të verifikojnë në cdo fazë afatet e përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të faturave brenda afatit ligjorë. Në rast të evidentimit të vonesave të llogaritjet penalitet për kamatëvonesë, si dhe t'i kërkohej Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë llogaritjen e penaliteteve për TVSH e shitjes për vonesa në deklaram jashtë afateve.

(Nga subjekti audituar Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projekt Raport Auditimit)

Nënpika 2.2.6 e programit: Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

- Mbi realizimin dhe përdorimin e të ardhurave viti 2022

Përshkrimi	Në mijë lekë	
	Plan 2022	Fakt 2022
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2021	15,614	15,614
Të trashëguara nga transf.specifike 2021	-	-
Të trashëguara nga transf.pakushtëzuara 2021	23,480	23,480
Të ardhurat e veta të vitit 2022	73,164	59,697
Grante të pakushtëzuara viti 2022	159,978	159,798
Grante kushtëzuara të vitit 2022, të detajuara:		
-Nga FZSH		
-Nga Ministrinë e Linjës	207,329	201,552
-Donatorë të ndryshëm (Projekte B.E)	120,408	
-Transf buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	44,432	42,813
-Nga huatë		
Totali	644,405	502,954

Përdorimi i të ardhurave viti 2022

Emërtimi	Fakt 2022				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
	Gjithsej	Tr. Pakushtëzuar	Të ardhurat e veta	Transf.e kushtëzuar dhe specifike	
230-Projekte	0	0	0	0	

231-Investime	299,161	85,308	12,301	201,552	4.1
600-Paga	84,858	58,664	23,980	2,213	28.3
601-Sigurime shoqërore	14,297	9,099	4,852	346	33.9
602-Shpenzime operative	37,762	8,639	29,123	0	77.1
604-Transf.Institucioneve	4,551	1,550	400	2,601	8.8
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	43,117	3,312	2,152	37,653	5.0
	483,746	166,572	72,808	244,365	15.1

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se me të ardhurat e veta bashkia mbulon 15.1% të totalit, ku përqindjen më të lartë e ka zëri 602- shpenzimet operative me 77%, më pas vijnë zëri paga (28.3%) dhe sigurime shoqërore (33.9%). Ndërsa investimet zënë 4% të totali. Pjesën dërrmuese të investimeve bashkia e ka me fonde të deleguara nga ministritë e linjës e cila 67.2% të totalit të investimeve.

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 62, datë 25.11.2021, është miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore. Në këtë strukturë përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Ardhurave, Lejeve dhe Licensave. Aktualisht, kjo drejtori ka në përbërje 5 punonjës, të ndarë konkretisht: 1 (një) drejtor, 1 (një) përgjegjës i zyrës së taksave dhe 3 specialist, sipas tabelës nr. 1, si vijon:

Tabela 1.

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr/ datë	Pozicioni i punës
1	L.XH	Drejtor	Master Shkencor	I Lartë	2354/ 27.12.2018	Drejtor
2	A.F	Përgjegjës	Master Shkencor	I Lartë	2356/ 27.12.2018	Përgjegjës
3	J.M	Specialist	Master Shkencor	I Lartë	2313/31.12.2019	Specialist
4	N.T	Specialist	Master Shkencor	I Lartë	253/03.02.2020	Specialist
5	L.Q	Specialist	Master Profesional	I Lartë	718/ 04.05.2021	Specialist

Realizimi i detyrës funksionale i kësaj drejtorie ne planifikim e te ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, ka si baze veprimi paketën fiskale te miratuar nga Këshilli i Bashkisë dhe te konfirmuar nga Institucioni i Prefektit te Qarkut Gjirokastrë, e konkretisht:

- Paketa fiskale për **vitin 2022**, është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 63, datë 25.11.2021 “*Per miratimin e taksave dhe tarifave vendore te bashkisë per vitin 2022*”, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit Gjirokastrë me shkresën nr. 1075/1, datë 9.12.2021.

Evidentimi i te dhënave per detyrimet qe kane taksapaguesit, kjo sipas objektit te veprimtarisë dhe taksave apo tarifave te miratuar me VKB, jane pasqyruar ne regjistrin e detyrimeve qe ekziston pranë kësaj drejtorie, ku administrohet ne mënyrë elektronike si dhe ne forme manuale. Ne regjistër jane pasqyruar detyrimet per çdo subjekt (*biznesi apo dhe familje*), kjo per lloj takse apo tarife vendore, te ndare sipas njësive administrative dhe per çdo fshat, si per detyrimet e prapambetura po kështu dhe detyrimet e vitit ushtrimor.

- *Administrimi i taksave dhe tarifave vendore*

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Dropull kryhet në programin Excel dhe jo me program të veçantë. Drejtorisë së Ardhurave gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizikë) të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

- *Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.*

Nga ana e grupit te auditimit, ne lidhje me veprimtarinë e Drejtorisë së të Ardhurave ne Bashkinë Dropull, per periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022, jane kryer intervista me stafin

e institucionit dhe jemi njohur me dokumentacionin e përdorur, si regjistrin elektronik dhe manual të taksa paguesve, faturat për arkëtim, urdhër bllokimet dhe gjithë dokumentacioni mbi bazën e se cilës kryhet programimi dhe realizimi i taksave dhe i tarifave vendore.

Nga grupi i auditimit është bërë auditimi si për detyrimet e bizneseve apo dhe të familjareve, në lidhje me saktësinë në planifikimin e kryer të detyrimeve të vitit ushtrimor, ku u audituan të dhënat e trajtuara nga Drejtoria e të Ardhurave në regjistrin e biznesit duke i vlerësuar me dokumentacionin që dispononte kjo drejtori si për burimin e marrjes së të dhënave për çdo lloj takse dhe tarifave të aplikuar (duke ju referuar kërkesave të VKB për miratimin e paketës fiskale) dhe detyrimeve që vijnë të mbartura. Ndërsa përse u përket pjesës së arkëtimeve grupi i auditimit u është referuar akt rakordimeve me posten shqiptare, arkëtime të realizuara në rrugë bankare si dhe akt rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit Gjirokastër.

- Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave, sipas Aneks 2.6.1 bashkëlidhur Raportit.

Të ardhurat totale të Bashkisë Dropull janë realizuar në **masën 84%**, ku nga vlera e planifikuar prej **71,168 mijë lekë** është arkëtuar vlera **59,699 mijë lekë** me një mosrealizim në vlerën **11,469 mijë lekë**.

Në totalin e të ardhura rezulton se **11 zëra** paraqiten me realizim mbi 100%, ndërsa **13 zëra** paraqiten me mos realizim nga 2 deri në 90%, nga e cila:

- **Taksat vendore** nga 31,343 mijë lekë të planifikuara është realizuar në masën 31,359 mijë lekë ose mbi 100%. Megjithëse si total është realizuar në zëra të veçantë paraqitet me mos realizim të theksuar, konkretisht: *Të ardhura nga renta minerale, nga 120 mijë lekë është arkëtuar 2 mijë lekës ose 2%. Për të këtë lloj takse të cilat menaxhohen me agjent tatimor (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve/ Doganave), nga Bashkia Dropull nuk është mbajtur aktrakordimet mbi nivelin e arkëtimeve dhe xhirimeve të bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve/ Doganave në adresë të Bashkisë Dropull.*

Me mos realizim paraqitet dhe **taksa e ndikimit në infrastrukturë** nga ndërtimet informale ku nga vlera e planifikuar prej 5,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 3,613 mijë lekë ose 72.5%.

Në këtë taksë kemi arkëtime nga taksa e ndikimit në infrastrukturë vlera 3,261 mijë lekë kjo për 9 leje ndërtimi dhe arkëtuar vlera 352 mijë lekë nga 12 ndërtimet informale (ALUIZNI). **Mos realizimi vjen për faktin se janë planifikuar mbi nevojat reale të bashkisë, kjo për të rritur burimin e të ardhurave për efekt të planifikimit të shpenzimeve.**

- **Tarifat vendore** nga 30,935 mijë lekë është realizuar në masën 19,191 mijë lekë ose 62%. *Peshën kryesore në mos realizim është nga tarifa e fondit pyjorë (dru zjarri + kullota), ku nga 11,800 mijë lekë të planifikuar është realizuar 462 mijë lekë ose 4%, të ardhura nga shfrytëzimi karriere nga 150 mijë lekë është realizuar 27 mijë lekë ose 18% dhe të ardhura nga shërbimi MNZH ku nga 200 mijë lekë është realizuar në masën 58 mijë lekë ose 29%. Planifikimi i këtyre të ardhurave nuk është mirëargumentuara me nevojat e vetë bashkisë dhe numrin e subjekteve që operojnë në këto fusha, ku qëllimi kryesor është rritje të tyre për shkak planifikimit të fondeve buxhetore për planifikim shpenzimesh.*

- Të ardhurat nga **qiratë e pronave të bashkisë (në pronësi/përdorim)**, ku nga vlera e planifikuar prej 4,660 mijë lekë është arkëtuar vlera 3,267 mijë lekë ose 70%. Me mos realizim paraqitet të ardhurat nga kullotat ku nga vlera e planifikuar prej 4,550 mijë lekë është arkëtuar vlera 3,105 mijë lekë ose 68%. **Mos realizimi i kësaj tarife është i paargumentuar, pasi kontratë likuqdohen në momentin e lidhjes së tyre dhe nuk duhet të lejoheshin të ushtronin aktivitet nëse nga subjektet private nuk bëhej likuidimi i tarifës së qirasë.**

- Të ardhura të tjera nga 4,230 mijë lekë është realizuar në masën 5,882 mijë lekë ose mbi 100%. Në këtë zë me mos realizim është tarifa e vaditjes ku nga 1,500 mijë lekë është arkëtuar

1,040 mijë lekë ose 69%. Gjithashtu në këtë zë janë dhe të ardhur nga shitja trualli ku nga 1,500 mijë lekë është realizuar 642 mijë lekë ose 43%.

Nga krahasimi i dy viteve (2021/2022), konstatohet se niveli i të ardhurave si në planifikim dhe në arkëtim është në ulje, kështu:

Për vitin 2022 janë parashikuar 71,168 mijë lekë të ardhura nga 73,489 mijë lekë të parashikuara në vitin 2021 **ose më pak për vlerën 2.321 mijë lekë.**

Ndërsa në arkëtim nga 59,699 mijë lekë janë arkëtuara në vitin 2022 nga 68,755 mijë lekë të arkëtuara në vitin 2021 **ose më pak për shumën 9,056 mijë lekë.**

Titulli gjetje 1: Mbi realizimin e të ardhurave për vitin 2022

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave vendore dhe akt akordimeve me Degën e Thesarit Gjirokastër, rezulton se:

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave, sipas Aneks 2.6.1 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

Të ardhurat totale të Bashkisë Dropull janë realizuar në masën 84%, ku nga vlera e planifikuar prej 71,168 mijë lekë është arkëtuar vlera 59,699 mijë lekë me një mosrealizim në vlerën 11,469 mijë lekë. Në totalin e të ardhura rezulton se 11 zëra paraqiten me realizim mbi 100%, ndërsa 13 zëra paraqiten me mos realizim nga 2 deri në 90%.

Për vitin 2022 janë parashikuar 71,168 mijë lekë të ardhura nga 73,489 mijë lekë të parashikuara në vitin 2021 **ose më pak për vlerën 2.321 mijë lekë.** Ndërsa në arkëtim nga 59,699 mijë lekë janë arkëtuara në vitin 2022 nga 68,755 mijë lekë të arkëtuara në vitin 2021 **ose më pak për shumën 9,056 mijë lekë.** Ky mosrealizim ose planifikim dhe arkëtim i taksave e tarifave vendore me ulje nga njëra periudhë në tjetër tregon punën e pamjaftueshme të Drejtorisë së të Ardhurave vendore në menaxhimin më të mirë të të ardhurave, pasi faktorët që mund të argumentonin këtë mos realizim dhe ulje të detyrimeve, si numëri i subjekteve dhe niveli i tyre sipas VKB, nuk janë faktorë të cilët mund të kenë ndikuar në këtë gjendje.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e Taksave vendore” i ndryshuar dhe VKB nr. 63, datë 25/11/2021 “Për miratimin e paketës fiskale viti 2022”.

Ndikimi/Efekti:

Mos menaxhimi më i mirë të taksave e tarifave vendore, çojnë në mosrealizimin e të ardhurave dhe mungesë të të ardhurave në buxhetin e bashkisë, të ardhura të cilat do ndikojnë në realizimin e buxhetit të vitit respektiv të bashkisë.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi për menaxhimin e të ardhurave nga peronat përgjegjës

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave duhet te behet analize e plote dhe analitike e shkaqeve të mos realizimeve të të ardhurave sipas zërave, duke vlerësuar bazën e llogaritjes së detyrimeve apo dhe arsytet e tjera qe kane krijuar këtë lloj suate, si dhe të marrin masa për një planifikim të saktë të detyrimeve nga takat e tarifave vendore dhe rritjen e përgjegjësisë për arkëtimin e tyre.

Nga subjekti bashkia Dropull me shkresën datë 26.7.2023 (dërguar me elektronik), janë paraqitur kundërshti mbi Projektraport Auditimit për mos taksim të subjektit “GJ....A” shpk, duke kundërshtuar se:

Pretendim i subjektit

Sipas çertifikatës së pronësisë, kartela e pasurisë së paluajtshme pika B -seksioni I përshkrimin te pasurisë, jep qarte të dhënat: ku sipërfaqja totale e pasurisë është 15.358 m² nga sip totale sipërfaqja e truallit është 5.963 m² dhe nga sipërfaqja truall sa ndërtesë 2.463 m² dhe mbetet sipërfaqja 9395 m² që taksohet si toke are (bashkëngjitur çertifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë së paluajtshme).

Qëndrim i grupit të KLSH:

Referuar dokumentacionit që ju paraqisni (certifikatë pronësia), sqarojmë se argumenti juaj qëndron.

- Analiza e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga abonentët familjarë.

Ne planifikimin e detyrimeve familjare për çdo lloj takse apo tarife vendore, janë aplikuar tarifatat e miratuara me vendim të KB nr. 63, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2022”.

Nga auditimi mbi burimin e thithjes të të dhënave për çdo lloj detyrimi, që janë kryer llogaritjet nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave të bashkisë Dropull dhe kërkesave të VKB, u konstatua se pranë kësaj drejtorie disponohej dokumentacioni përkatës mbi bazën referuese në llogaritjen e çdo detyrimi sipas llojit të taksës apo tarifës vendore, si dhe për çdo subjekt fizik, juridik apo dhe familjar.

Nga auditimi me zgjedhje të kryera nga grupi i auditimit mbi saktësinë e llogaritjes të detyrimeve për taksat apo tarifa vendore të planifikuara për subjektet, duke ju referuar tarifave të përcaktuara me VKB, rezultoi se kishte aplikim të sakte në tarifatat e aplikuar, apo dhe në përfshirjen në detyrimin vjetor të debisë së mbartur nga vitet e kaluara.

Pranë kësaj zyre, për të ardhurat disponohet regjistër ku janë planifikuar të ardhurat, për vitin 2022, e përkatësisht:

Per familjaret.

1. Detyrimet e prapambetura deri në fund të vitit 2021, janë në vlerën **9,343,612 lekë për 1406** familje, e përkatësisht:

- Nga toka bujqësore është detyrim nga 1206 familje për vlerën 4,244,061 lekë.
- Nga taksa e ndërtesës është detyrim nga 1153 familje për vlerën 2371963 lekë.
- Nga taksa e truallit është detyrim nga 1114 familje për vlerën 82,588 lekë.
- Nga tarifa e ndriçimit është detyrim nga 1095 familje për vlerën 568,200 lekë.
- Nga tarifa e pastrimit është detyrim nga 705 familje për vlerën 1,792,200 lekë.
- Tarife shërbimi varrezash është detyrim nga 1097 familje për vlerën 284,600 lekë.

2. Detyrimet e vitit ushtrimor 2022, janë në vlerën **16,755,446 lekë për 4257** familje, e përkatësisht:

- Nga toka bujqësore është detyrim nga 4257 familje për vlerën 7,263,484 lekë.
- Nga taksa e ndërtesës është detyrim nga 4017 familje për vlerën 3,575,832 lekë.
- Nga taksa e truallit është detyrim nga 3962 familje për vlerën 122,930 lekë.
- Nga tarifa e ndriçimit është detyrim nga 3912 familje për vlerën 782,400 lekë.
- Nga tarifa e pastrimit është detyrim nga 3849 familje për vlerën 4,618,800 lekë.
- Tarife shërbimi varrezash është detyrim nga 3920 familje për vlerën 392,000 lekë.

Arkëtimet e realizuara gjatë vitit ushtrimor 2022, ku përfshihen arkëtime të detyrimeve të mbartura nga vitet e kaluara dhe detyrimet e vitit ushtrimor, janë në vlerën 18,227,937 lekë, e përkatësisht:

Arkëtimet e realizuara gjatë vitit 2022	Arkëtuar	Nga e cila		
		Debia	Detyrim viti	Nr.
Nga toka bujqësore	7,888,337	1,889,593	5,998,744	3,418
Taksa Ndërtesës	4,105,014	1,234,982	2,870,032	3,302

Arkëtimet e realizuara gjate vitit 2022	Arkëtuar	Nga e cila		
Taksa trualli	141,336	42,408	98,928	3,275
Tarife ndriçimi	925,900	294,200	631,700	3,245
Tarife pastrimi	4,703,400	951,600	3,751,800	3,192
Tarife shërbim varreza	463,950	147,500	316,450	3,252
Shuma	18,227,937	4,560,283	13,667,654	19,684

Nga auditimi i te dhënave te Drejtorisë së të Ardhurave, pjesa e vlerës se pa arkëtuar ne fund te vitit 2022, si per detyrimet e prapambetura apo dhe detyrimet e vitit, paraqitet sa me poshtë:

Detyrimet e pa arkëtuara deri ne 31.12.2022, jane per vlerën 7,871,121 lekë, përkatësisht:

- Nga toka bujqësore është detyrim nga 945 familje per vlerën 3,619,208lekë.
- Nga taksa e ndërtesës është detyrim nga 822 familje per vlerën 1,842,781 lekë.
- Nga taksa e truallit është detyrim nga 791 familje per vlerën 64,182 lekë.
- Nga tarifa e ndriçimit është detyrim nga 770 familje per vlerën 424,700 lekë.
- Nga tarifa e pastrimit është detyrim nga 739 familje per vlerën 1,707,600 lekë.
- Tarife shërbimi varrezash është detyrim nga 773 familje per vlerën 212,650 lekë.

Gjendja e lartë e detyrimeve sipas deklarimit verbal nga specialist përgjegjës është se një pjesë e familjeve janë të larguar në emigracion dhe nuk janë prezent. Nga bashkia (specialist përkatës), konstatohet se nuk janë zbatuar sanksionet ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e debitorëve.

- Analiza e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave qe u përket taksave nga bizneset fizik apo dhe juridik, kjo per vitin 2022.

Ne planifikimin e detyrimeve per çdo lloj takse apo tarife vendore per bizneset qe ushtrojnë aktivitet ne territorin e bashkisë, jane aplikuar tarifate e miratuara me VKB , kjo per te gjithë periudhën e audituar.

Per periudhën 2021- 2022, gjendja e biznesit fizik dhe juridik ne Bashkinë Dropull paraqitet si me poshtë:

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendje ne fillim	Regjistrime te reja	Mbyllur aktivitet	Gjendja ne fund
1	Biznesi Vogël	2021	131	14	3	142
		2022	142	8	7	143
2	Biznesi Madh	2021	79	2	1	80
		2022	80	2	0	82
(1+2)	Gjithsej	2021	210	16	4	222
		2022	222	10	7	225

Per periudhën e mësipërme vërehet se kemi **hapje aktiviteti (biznese te reja)** nga 10 biznese. Gjithashtu kemi **mbyllje te aktivitetit** nga 7 biznese.

Ne fund te vitit 2022, ushtronin aktivitet ne territorin e Bashkise Dropull dhe qe duhet te paguanin taksa vendore gjithësej 225 subjekte, nga këto 143 subjekte biznesi i vogel dhe 82 subjekte biznesi i madh, **por ne fakt u nënshtrohen detyrimeve** vetëm 191 subjekte, pasi kemi subjekte të pezulluara me vendim te QKB per 27 subjekte dhe subjekte me çregjistrim për 7 juridike.

Nga ana e grupit te auditimit u audituan te dhënat e subjekteve fizike dhe juridike, duke analizuar me zgjedhje dosjet e subjekteve qe administrohej pranë kësaj drejtorie te taksave dhe tarifave vendore, ku u konstatua se:

- Jane hapur dosjet personale per çdo biznes ku ne to nuk administroheshin te gjitha te dhënat sipas kërkesave te Udhëzimit te përbashkët te MB me nr. 655/1 datë 06.02.2007 dhe MF me nr 125/4 datë 31.01.2007 “Per përcaktimin e uniformitetit te standardeve procedurale dhe te raportimit te sistemit te taksave vendore”, ku krahas mungesës ne disa raste të bazës se llogaritjes se detyrimit, është konstatuar se per subjektet te cilat trajtohen si **subjekte të pezulluara**, nuk disponohej ne dosjen e subjektit kërkesa qe tatim paguesi kërkon pezullim

aktiviteti, proces verbali qe tregon datën e ndërprerjes se veprimtarisë dhe likuidimin e plotë të detyrimeve nga ky subjekt. Po kështu nuk disponohej proces verbali mbi verifikimin në terren nëse këto subjekte ushtrojnë aktivitet apo jo, duke mos lenë **gjurmë auditimit në verifikimin e tyre**, veprime këto në mos zbatim të nenit 44 dhe 45 të ligjit nr. 9920, datë 18.53.2008 “për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar.

- Në dosjet nuk disponohen certifikata e pasurisë të objektit, nuk disponohen asnjë genplani të hartuar nga Drejtoria e PZHT në bashkëpunim me specialistin e sektorit të taksave për evidentimin e sipërfaqes së objektit, truallit apo hapësirës publike, si dokument për të vërtetuar vetëdeklarim e subjektit, duke mos lenë **gjurmë auditimit në verifikimin e tyre**.

- Në dosje nuk ishin të depozituara aktet e ndryshme që sektori i kontrollit në terren mund të ketë realizuar për cdo subjekt me programe të veçanta të miratuara nga drejtori i të ardhurave.

- Nga analiza e planifikimit të kryer nga Drejtoria e të Ardhurave, për taksat dhe tarifën vendore që duhet të paguajnë bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë, konstatohet se:

Per vitin 2022, nga auditimi i kryer nga grupi i auditimit mbi detyrimet që u lind çdo subjekti për të paguar taksa dhe tarifa vendore, duke ju referuar detyrimeve të përcaktuara në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 63 datë 25.11.2021, si dhe regjistrin të llogaritjes së detyrimeve për çdo subjekt dhe çdo lloj detyrimi (*që na është vënë në dispozicion nga kjo zyre*).

Në planifikimin vjetor për biznesin e vogël dhe biznesin e madh, duke ju referuar regjistrin të vënë në dispozicion nga drejtoria e taksave, figuron vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021, për të gjitha bizneset, **por jo i pasqyruar sipas llojit të detyrimit por është i evidentuar në total**.

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2021, u përkasin **19** subjekteve për vlerën **1,305,627 lekë**, përkatësisht 11 subjekteve fizike në vlerën **164,311 lekë** si dhe 8 bizneseve juridike që u përket vlerës prej **1,141,316 lekë**.

Detyrimet e vitit ushtrimor 2022 (*Sipas regjistrin të paraqitur nga zyra e taksave të bashkisë*) ku është regjistruar detyrimi i mbartur deri në fund të vitit 2021 dhe detyrimi i vitit ushtrimor 2022, si për biznesin e vogël po kështu dhe për biznesin e madh, e përkatësisht:

- **Per biznesin e vogël**, është pasqyruar në regjistër, vlera e detyrimit të mbartur në fund të vitit 2021, për 11 subjekteve fizike në vlerën **164,311 lekë**, si dhe detyrimi i vitit ushtrimor 2022, për 145 biznese në vlerën 1,998,982 lekë.

- **Per biznesin e madh**, është pasqyruar në regjistër, vlera e detyrimit të mbartur në fund të vitit 2021, për 8 biznese në vlerën 1,141,316 lekë, si dhe detyrimi i vitit ushtrimor 2022, për 81 biznese në vlerën 13,319,582 lekë.

- Sipas të dhënave në fund të vitit 2022, rezultojnë vlera e arketuar paraqitet në shumën 16,258,649 lekë nga 16,624,191 lekë që është pasqyruar si detyrim në regjistrin e bizneseve.

Nga auditimi i mbikëqyrjes së arkëtimit të detyrimeve që u lind çdo taksa paguesi, rezultojnë se realizohet, nëpërmjet Postes Shqiptare në zbatim të Akt Marrëveshjes së lidhur midis palëve me nr 520/1 prot datë 20.3.2019, marrëveshje e rinovuar me nr 387 prot datë 28.02.2020 të Bashkisë Dropull dhe nr 92 prot datë 03.03.2020 të Postes Shqiptare.

Arkëtimi nëpërmjet Postes Shqiptare realizohet për çdo lloj detyrimi që delegohet nga Drejtoria e të Ardhurave. Nga ana e Bashkisë i vëhet në dispozicion Postes në çdo fillim viti plani vjetor i detyrimeve për çdo taksapagues, të detajuar sipas llojit të detyrimit jo vetëm në total, por dhe i detajuar në planifikim mujor.

Nëpërmjet Postes Shqiptare dhe Drejtorisë së të Ardhurave, kryhet akt rakordimi mujor dhe progresiv për çdo zyre postare dhe bashkisë, duke e shoqëruar me listat analitike për çdo taksa pagues.

- Në rrugë bankare, realizohet kryesisht nga ana e subjekteve juridike dhe fizike.

- Nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor, ku merren të ardhurat nga taksa e regjistrimit të mjeteve të transportit, që pronaret e tyre janë me banim në territorin e kësaj bashkie.

Me D.SH.T.R Gjirokastër, kryhet akt rakordimi mujor dhe progresiv, mbi vjeljen e taksës vjetore të mjeteve, ku përcaktohen mjetet dhe vlera e arketuar, mbi bazën e se cilës kryhet dhe xhirimi i detyrimit për llogari të bashkisë, kjo sipas akt rakordimit të realizuar midis Institucioneve.

- Nepermjet Drejtorisë Rajonale të Taksa Tatimeve Gjirokastër, ku merren të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat dhe pjesa e mbetur e tatimit të thjeshtuar i fitimit.

Me D.R.T.T Gjirokastër, kryhet akt rakordimi mbi deklaratimet nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë, të cilët e deklarojnë pranë D.R.T. Gjirokastër dhe pas kësaj kryhet xhirimi i detyrimit për llogari të bashkisë, kjo sipas akt rakordimit të realizuar midis Institucioneve.

- Në çdo fund muaji janë realizuar akt rakordimet midis Drejtorisë së Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike të Bashkisë si dhe punonjësve të Degës së Thesarit Gjirokastër, mbi të ardhurat e realizuara duke i specifikuar sipas llojit të të ardhurës së realizuar.

-Nuk del e evidentuar rakordimet me Drejtorinë ASHK Gjirokastër mbi transaksionet e ndryshme të shitblerjes së pronës për detyrimin që ato kanë ndaj njësisë për tarifën e shërbimit të shitjes së pronës.

Titulli gjetjes 3 : Mbi taksën e Hidrokarbureve:

Situata:

Në territorin e Bashkisë Dropull ushtrojnë aktivitet të tregtimit të hidrokarbureve, gjithsej 7 subjekte.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit (autorizime) dhe pagesat e tyre në zbatim të VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”...* *“10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.”*, rezulton se:

- 1- Autorizimet nuk lëshoheshin për periudhën 5 vjeçare, por për periudha më të shkurtër nga një deri në 5 vite.
- 2- Nuk aplikohen tarifa 100,000 lekë, tarifa për përdorim nga konsumatorët fundorë, **me një mungesë të ardhur prej 700,000 lekë (7 x 100,000).**
- 3- Për 7 subjekte që tregtojnë hidrokarbure, detyrimi sipas bashkisë është 4,800,000 lekë, nga e cila është likuajduar vlera 4,022,000 lekë, **duke mbetur pa likujdim vlera 778,000 lekë, si ardhur e munguar.**

Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësisë të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifatat vendore janë paraqitur në **Tabelën**.

Nr.	SUBJEKTI	Adresa	AUTORIZIMI	Detyrimi	Pagesat me marrëveshje	Data
1	B...M	Kakavi	27.10.2020 - 27.10.2023	600,000	200,000	11.6.2021
					50,000	11.4.2022
					50,000	14.4.2022
					50,000	13.9.2022
					50,000	5.10.202
					70,000	10.3.2023
	Diferenca +/-			600,000	470,000	(130,000)

Nr.	SUBJEKTI	Adresa	AUTORIZIMI	Detyrimi	Pagesat me marrëveshje	Data
2	B....O	Sofratik	27.4.2020-27.4.2023	600,000	120,000	12.01.2022
					32,000	22.2.2022
					32,000	31.3.2022
					32,000	5.12.2022
	Diferenca +/-			600,000	216,000	(384,000)
3	A....U	Sofratik	7.9.2020-7.7.2023	600,000	120,000	11.01.2022
					24,000	18.2.2022
					24,000	19.4.2022
					24,000	20.6.2022
					48,000	19.9.2022
					48,000	15.11.2022
	Diferenca +/-			600,000	336,000	(264,000)
4	A....L		11.12.2019-11.12.2024	1,000,000	100,000	10.12.2019
					300,000	6.10.2020
					200,000	29.01.2021
					200,000	20.10.2021
					200,000	15.6.2022
	Diferenca +/-			1,000,000	1,000,000	-
5	A....P	Haskove	5.6.2020 – 6.5.2022	600,000	216,666	26.5.2021
					77,998	19.5.2021
					36,259	29.6.2022
					36,259	9.8.2022
					36,259	26.8.2022
					36,259	28.9.2022
					36,259	28.10.2022
					36,259	15.11.2022
					36,259	29.12.2022
					14,545	16.01.2023
					14,545	2.2.2023
					14,545	23.3.2023
					14,545	2.5.2023
	Diferenca +/-			600,000	600,000	-
6	K....G	GORICE	2.9.2020-2.9.2025	1,000,000	1,000,000	17.11.2020
	Diferenca +/-			1,000,000	1,000,000	-
7	K....I	VRISERA	17.10.2020-31.12.2022	400,000	200,000	11.11.2020
			01.01.2021-31.12.2022		200,000	20.01.2022
	Diferenca +/-			400,000	400,000	-
	TOTALI			4,800,000	4,022,000	(778,000)

Kriteri:

Në kundërshtim me VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10.

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatimi i kuadrit ligjore, çojnë në mungesë të ardhurash për bashkinë në shumën 788,000 lekë.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor nga strukturat përgjegjësi.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave vendor të marrë masa për arkëtimin e vlerave të paarkëtuara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në shumën **788,000 lekë, respektivisht:** subjekti “B....T” shpk në shumën **130,000 lekë**, subjekti “B....O” shpk në shumën **384,000 lekë** dhe subjekti A....U shpk në shumën **264,000 lekë**.

Nga subjekti bashkia Dropull me shkresën datë 26.7.2023 (dërguar me elektronik), janë paraqitur kundërshti mbi Projektraport Auditmit për **taksën e hidrokarbureve**, duke kundërshtuar se:

Pretendim i subjektit

Nuk aplikohen tarifa 100,000 lekë per përdorim nga konsumatorët fundore, me nje mungese te ardhur prej 700,000lekë (7x100,000), pasi referuar ligjit nr.8450 datë 24.2.1999 “Per përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, te gazit dhe nënprodukteve te tyre” i ndryshuar, neni 1/1 Përkufizime.

15. “Konsumator fundor“ është personi fizik apo juridik qe blen produktet e gatshme per nevojat e veta Kreu II, neni 11, Pika (ç) stacionet e shitjes se karburanteve, qe ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit te karburanteve ,gazit te lëngshëm dhe vajrave lubrifikante per automjete, Pika (d) njësitë e shitjes se lendeve djegëse, qe ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit te tyre per përdorim nga konsumatorët fundore, Neni 16, Njësitë e lendeve djegëse, Pika 1 “Veprimtaria e tregtimit me pakice te lendeve djegëse per ngrohje dhe gatim per konsumatorët kryhet nga stacionet dhe njësitë e lendeve djegëse.

Nuk kemi aplikim te tarifës 100.000 lekë per përdorim nga konsumatorët fundore sepse subjektet tona jane te pajisura me licensë sipas pikës c te nenit 11 te ligjit Nr.8450 datë 24.2.1999 i ndryshuar.

Oëndrim i grupit të KLSH:

Referuar dokumentacionit qe ju paraqisni (certifikatë pronësia), sqarojmë se argumenti juaj qëndron.

Titulli i gjetjes 4: Probleme me vjeljen e të ardhurave të cilat realizohen nëpërmjet agjentëve tatimorë.

Situata:

Në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj dhe janë regjistruar në evidencat përkatëse, si dhe protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga DSHTRR derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Dropull brenda datës 5 të çdo muaji. Këto derdhje bëhen rregullisht dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Gjirokastrë.

Nuk ka aktrakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, mbi nivelin e taksës së rentës minerale dhe tatimit mbi të ardhurat, sa është dhe sa duhet paguar në buxhetin e bashkisë Dropull.

Nuk ka bashkëpunim me Drejtorinë ASHK Dega Gjirokastrë, mbi numrin e transaksioneve të kryera, nivelin e tarifës së arkëtuar dhe xhiruar për llogari të bashkisë Dropull.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Dropull janë paraqitur në Tabelë.

Tabela . Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Dropull viti 2022, në 000/lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Plani	Fakti
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim mbi të ardhurat personale	1,700	2,486
D.R.SH.T rrugor	Taksa vjetore e mjeteve	3,400	4,188
Z.V.R.P.P (AKSH)	Taksa e kalimit të pronësisë	100	0
DPT & DPD	Renta Minerare	120	2
TOTALI		5,320	6,676

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel mesatar të realizimi. Bashkia Dropull nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë

akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plotë dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Dropull nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me detyrimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Dropull, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjatitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura”.

Kriteri:

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, datë 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e një informacioni të saktë dhe të plotë për gjendjen financiare, për pritshmërinë nga të ardhurat që duhet të sigurohen nga agjentët tatimorë.

Shkaku:

Mos krijimi i bazave të të dhënave, mosfunksionimi i strukturave të bashkisë dhe paqartësia e personelit në lidhje me bazën ligjore të posaçme për këto kategori të ardhurash.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Dropull, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifatat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjatitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- *Taksa e tokës bujqësore.*

Nga të dhënat e pasqyrës, kjo taksë është realizuar në masën 101% ose nga vlera e planifikuar prej 7,800 mijë lekë është arkëtuar vlera 7,889 mijë lekë.

Sipas të dhënave të marrë nga Drejtoria e Bujqësisë, Bashkia Dropull, rezulton se sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore është prej 6978 ha, nga e cila ndarë me ligjin nr. 7501 një sipërfaqe prej 6635 ha dhe tokë bujqësore e pandarë 343 ha. Familje që kanë përfutuar tokë bujqësore janë 4258 familje.

Sipas të dhënave të paraqitura për vitin 2022, rezulton se janë debitorë për taksën e tokës bujqësore gjithsej 945 familje për vlerën 3,619,233 lekë, sipas tabelës si vijon:

EMETIMI	Plani	Fakti
Dropull i Poshtëm	1,857	4,200,425
Dropull i Sipërm	1,906	2,527,799
Pogon	509	528,414
Debitor 31.12.2021	1,206	4,245,558
Shuma	5,478	11,502,196
Debitor	4,533	7,882,963
Mbetja 31.12.2022	945	3,619,233

Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka bashkëpunuar me DPZHT Bashkia Dropull, për të marrë informacion lidhur me sipërfaqet që kanë kaluar për ndërtim objektësh, si dhe nga ASHK për ato sipërfaqe me transaksion për shitje tokash apo për regjistrim të lejeve të ndërtimit.

Titulli gjetjes 5: *Mos ndjekjen e plotë e procedurave ligjore për mbledhjen e detyrimeve debitorë.*

Situata:

Në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Dropull dhe nga auditimi u konstatua se, totali i debitorëve me 31.12.2022 është në vlerën **10,126,180 lekë**, konkretisht tabela.

Tabela. Debitorë.

Nr.	debitor me 31.12.2021	Lëvizja viti 2022		
		Shtuar	Pakësuar	Gjendje 31.12.2022
Familjare	9,343,612	3,087,792	4,560,283	7,871,121
Sub. Juridike	1,141,316	327,039	612,467	855,888
Sub. Fizike	164,311	38,503	157,631	45,183
Kamatëvonesa	1,608,111	220,457	474,580	1,353,988
SHUMA	12,257,350	3,673,791	5,804,961	10,126,180

Vlera prej **10,126,180 lekë**, përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Dropull.

Në totalin e detyrimeve, konstatohet se peshën kryesore e zënë detyrimet nga abonentët familjarë, të cilat janë 75.8% e totalit të detyrimit.

Për menaxhimin e taksave e tarifave vendore, Bashkia Dropull nuk kishte aktmarrëveshje me ND. Ujësjetllës Kanalizime por kishte me Zyrën e Postës Shqiptare.

Konstatohet se një pjesë e subjekteve të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet nga Drejtoria e të Ardhurave vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite. Gjithashtu dhe subjekte të cilët janë me status pasiv/ ose të mbyllur nuk kanë bërë të mundur likuidimin total të detyrimeve.

Në lidhje me masat e marra, konstatohet se:

Urdhër nr 1 datë 24.1.2022 vënie dijani per bllokim llog bankare.

Urdhër nr2 datë 15.2.2022 shpërndarje nj. Detyrim subjekteve fizik/juridik.

Urdhër nr 3 datë 13.5.2022 rishpërndarje nj. Detyrim subjekteve fizik/juridik.

Urdhër nr 4 datë 16.5.2022 rishpërndarje nj. Detyrim subjekte familjare.

Nr 828Prot datë16.5.2022 rinjoftim subjekteve familjare debitore.

Nr827 Prot, datë 16.5.2022 letër kujtese subjekteve fizik/juridik.

Nr 1190 Prot, datë 12.7.2022 rinjoftim letër kujtese subjekteve fizik/juridik.

Nr 1686 Prot, datë 6.10.2022 ridërgim letër kujtese subjekteve fizik/juridik.

Shkresa nr. 167/3, datë 31.01.2022 për bllokim llogari bankare në shumën 305,380 lekë dhe me shkresën nr. 1338, datë 10.8.2022 në shumën 54,172 lekë. Gjithësej bllokuar shuma 362,552 lekë nga e cila zbatuar vlera 54,172 lekë.

Në raport me vlerën e detyrimeve, nga bashkia janë marrë masa vetëm 3.4% e totalit të detyrimeve. Në krahasim me nivelin e detyrimeve në fund të periudhës, konstatohet se procedura për zbatimin e masave shtrëngues nuk është e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, ku një pjesë e masave nuk është batur. Mungon bashkëpunimi me DSHTRR, Drejtorinë ASHK Dega Gjirokastër, bllokim aktivitet, sekuestrim etj.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, respektivisht nenet:

-Nuk gjen zbatim neni 89-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve;

-Nenet 90-Urdhër bllokimet dhe 92-Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë, duke lënë jashtë një pjesë të konsiderueshme të tyre, por dhe subjekte me detyrime nga viti në vit;

-Neni 93-Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë dhe neni 94-Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër;

-Për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, nuk është kërkuar nga DTTV që për të gjithë subjektet të cilat janë njoftuar për pagesën e detyrimeve dhe zbatuar një pjesë e procedurave të kërkohej *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Ndikimi/Impakti:

Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin të buxhetit të vitit 2022 të parashikuar në fillim të periudhës ushtrimore, për shërbime, investime, etj.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që dispijlojnë taksat dhe tarifatat vendore nga strukturat përkatëse në një sinë e vetëqeverisjes vendore.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake Bashkia Dropull, të marrin masa, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **10,126,180 lekë**.

III. Auditim mbi dhënien me qira te pyjeve dhe kullotave.

Auditimi u krye ne mbështetje te VKM nr.632, datë 11.06.2009 “Per përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave” i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 "Per disa ndryshime ne VKM Nr.391, datë 21.06.2006 te KM "Per përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar .

- *Auditim mbi kontratat e lidhura me kompanitë celulare per dhënien me qira te pyje kullotave per Antenat celulare.*

<u>Titulli i gjetjes 6: Menaxhimi i kontratave të qirave të telefonive celulare.</u>

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Pyjeve dhe kullotave, rezulton se në Bashkinë Dropull operojnë me kontratë dy shoqëri të telefonisë celulare, konkretisht me shoqërinë “T...A” për periudhën 2.3.2019 – 2.3.2028 për vlerën 100,000 lekë/viti, e likujduar sipas mandatë arkëtimeve dhe kontrata me shoqërinë “V...A” për periudhën 5 vjeçare nga 21.11.2017 deri me 21.11.2022 për vlerën 450,000 lekë/viti.

Nga të dhënat, për periudhën 22.11.2021 deri me 22.11.2022 nga shoqëria është likujduar vlera 361,250 lekë, **duke mbetur për diferencë vlera 88,750 lekë, si ardhur munguar në buxhet.**

Gjithashtu, konstatohet se në kontrata e nënshkuara:

-Nuk është përcaktuar nr. Parcelës, vendi ku ndodhet dhe kufizimet.

-Nuk është llogaritur qira per përdorim rruge per lidhjen e sipërfaqes se dhënë ne përdorim me rrjetin rrugor, për të cilën duhet të bëhet verifikimi i gjatësisë se rrugës, te llogaritet vlera e qirasë.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Per disa ndryshime ne Vendimin nr.391, datë 21.06.2006 te KM “Per përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave”, i ndryshuar, si dhe kushteve të zbatimit të kontratës.

Ndikimi/Efekti:

Mos njohje e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e bashkisë.

Shkaku: Mungesë në realizimin e të ardhurave.

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (Sektori i Pyjeve), të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **88,750 lekë ndajë subjektit “V....A”**, si e ardhur e munguar.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (Sektori i Pyjeve), për të gjitha rastet e mos likuidimet në afat ë detyrimeve kontraktuale, në zbatim të nenit 5 të kontratës të llogariten kamatëvonesat në masën 0.01% për çdo ditë vonesë nga momenti i pagesës dhe në rast refuzimi të shlyerjes të kërkohet prishja e kontratës për mos zbatim të kushteve.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Bujqësisë (Sektori i Pyjeve), të marrë masa që në fazën e hartimit të kontratave të reja bashkëlidhur të jetë dhe nr. parcelës ku ndodhet dhe kufizimet. Gjithashtu për kontratat e vijim të evidentohet dhe llogaritet detyrimi i qirasë për rrugën në përdorim dhe arkëtimin e detyrimit.

Titulli i gjetjes 7: Menaxhimi i kontratave të qirave të kullotave dhe objekteve.

Situata.

Auditimi u krye ne mbështetje te Udhëzimit te Ministrit te Mjedisit Nr.2, datë 20.07.2016 “Per kriteret teknike te klasifikimit te kullotave e livadheve dhe procedurat per dhënien e tyre per kullotje e kositje bari” dhe VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Per disa ndryshime ne Vendimin nr.391, datë 21.06.2006 te KM “Per përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave” si dhe VKM nr.632, datë 11.06.2009 "Per miratimin e tarifave te përdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje", per gjithë periudhën e auditimit.

Nga auditimi rezultoi si me poshtë:

Me VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Per transferimin ne pronësi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrisë se Mjedisit e te ish komunave/bashkive”, ndryshuar me VKM nr.398, datë 13.05.2020 është miratuar lista e inventarit te pyjeve dhe kullotave qe transferohen ne pronësi te Bashkise Dropull”, sipas te cilit jane transferuar **24.841,6704 ha** gjithsej, nga e cila, **13.091,0369 ha** kullota, **11.558,1446 ha pyje**, **88,63 ha toke shkëmbore**, **88,63 ha** siperfaqe rezervuari dhe **47,68 ha** siperfaqe ranishte.

Per periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, jane miratuar tarifate per dhënie me qira te siperfaqeve kullimore e pyjore per kullota dimërore, ne mbështetje te VKM nr.632, datë 11.06.2009 "Per miratimin e tarifave te përdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje" me VKB nr. 69, datë 25.11.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1075/1, datë 9.12.2021.

Nga kjo Bashki per periudhën e mësipërme, jane lidhur 43 kontrata qiraje per kullota dimërore me nje siperfaqe prej 4239.88 ha.

Per periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, jane miratuar tarifate per dhënie me qira te siperfaqeve kullimore e pyjore per kullota verore ne mbështetje te VKM nr.632, datë 11.06.2009 "Per

miratimin e tarifave te përdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje" me VKB nr. 69, datë 25.11.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1075/1, datë 9.12.2021.

Nga kjo Bashki per periudhën e mësipërme, jane lidhur 35 kontrata qiraje per kullota verore me nje siperfaqe kullimore prej 6467.59 ha, ne nje kohe, qe sipas VKB nr. 2, datë 27.01.2022 "Per miratimin e listës se kullotave te gatshme per kullotje per sezonin veror -dimërore" është miratuar per dhënie me qira sipërfaqja kullimore prej 6819.68 ha.

Per këtë sezon nuk është shfrytëzuar e gjithë sipërfaqja kullimore e miratuar me VKM, duke mos miratuar dhe shpallur per dhënie me qira e gjithë sipërfaqja kullimore qe ka ne pronësi Bashkie, e cila, çon ne mungese te ardhurash per Bashkinë.

Gjithashtu, nga ana e Drejtorisë se Administrimit te Ujrave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave, nuk është hartuar regjistri i kapacitete kullimore per sipërfaqet kullimore dhe pyjore qe ka ne pronësi Bashkia, por, per sipërfaqet e dhëna me qira jane aplikuar kapacitetet e përcaktuara ne Planin e mbarështimit per periudhën 2009 / 2019 te hartuar nga ish Drejtoria e Pyjeve e cila është hartuar per nje siperfaqe pjesore prej 5.175 ha dhe jo per gjithë sipërfaqen kullimore qe ka ne pronësi Bashkia Dropull.

Nga auditimi i dosjeve te kontratave verore dhe dimërore te lidhura, rezultoi se, është zbatuar procedura e përcaktuar ne Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit Nr.4, datë 10.04.2008 "Per kriteret teknike te klasifikimit te kullotave e livadheve dhe procedurat per dhënien e tyre per kullotje e kositje bari", pasi te gjitha dosjet e subjekteve qiramarrës te kullotave jane plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar ne Udhëzimin e sipërpërmendur, qe nga kërkesa deri te proces verbalin i dorëzimit te parcelave te marra me qira, me përjashtim te pikave te mëposhtme:

- Nga ana e Zyrës se Pyje kullotave nuk është shpallur lista e kullotave te gatshme per kullotje dhe sipërfaqet qe përjashtohen nga kullotja, ne muajin Shkurt te cdo viti, ne zbatim te kreut II "Procedurat e dhënies per kullote dhe kositje bari", pika 2 te Udhëzimit te mësipërm.

- Nga ana e qiradhënësit, Bashkise, nuk jane bërë sondazhe gjate kullotjes per te mos lejuar futjen e bagëtive ne kullote jashtë kapacitetit kullitor te kontraktuar, ne kundërshtim me kreun III "Kërkesat teknike te përdorimit te fondit kullitor per kullotje", pika 7 te Udhëzimit te mësipërm.

- Nga ana e strukturës përgjegjëse nuk është bërë verifikimi ne terren nëse është zbatuar kontrata dhe nëse ne parcele jane futur po aq kërër sa është lidhur kontrata, per te cilën, rekomandohet te behet verifikimi me nje komision te miratuar nga titullari.

- Nuk ka bashkëpunim me AZHBR Qarku Gjirokastër në lidhje me numrin e bagëtive të regjistruara për bashkinë Dropull.

- Kontratat në çdo rast nuk kanë bërë përcaktimin se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave (*sipas vendimit të Komisionit të Ndarjes së Kullotave apo vendimit të këshillit të komunës*).

- Nuk administrohej hartë për sipërfaqen e shfrytëzueshme.

- Për të gjitha kontratat, konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfituar kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinare për numrin e regjistrit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar numri real i secilit blegtor.

- Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

- Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.

- Nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullitor.

- Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 "pyjet, kullotat dhe plantacione", pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie, si dhe nuk është vijuar me regjistrimin e pronave të paregjistruara, pasi këto

prona nuk janë të regjistruara në emër të NJQV, duke sjellë për pasojë të qenurit pronar me të drejta jo të plota por të kufizuara.

-Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.

- Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.

- Nuk janë përcaktuar kriteret për dhënien me qira të tyre, nga ku kriteret prioritare si p.sh. fermerët me banim brenda territorit të njësisë, me vendndodhje afër kullotës, që mbarështojnë një numër të madh bagëtish, të atyre që shtegtojnë tufat në ekonomi të tjera kullimore e që kanë qenë të kontraktuar sezonin e kaluar.

- Nuk ka hartuar planet e mbarështimit të kullotave.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për Fondin Kullor”, i ndryshuar me Ligjin nr. 49/2016, neni 26, “*Bashkitë janë pronarë të kullotave që gjenden brenda territorit administrativ të tyre dhe kanë për detyrë të a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij; b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet*”; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në NJQV”; Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; Udhëzimi nr. 4, datë 10.04.2008, “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, të livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”; VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”; Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe VKM nr.22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 3 e vijim; pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006,; me nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10210, datë 25.3.2010, në referim të ligjit 5 “Planet e Mbarështimit”, neni 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, neni 15/2 “Pronësia e Fondit Pyjor” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:

Mos njohje e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e bashkisë.

Shkak: Mungesë në realizimin e të ardhurave.

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Dropull të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës, si dhe të marrin të gjitha masa për inventarizimi Kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës); mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall; mbajtjen, evidentimin, administrimin e balancimit të fondit kullor; pasqyrimin në kontabilitet, në llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”; aplikimit për regjistrim të parcelave në ASHK Drejtoria Gjirokastër; hartimin e plan mbarështimit për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme; krijimin të ardhura nga lëndët drusore, përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, dhe hartimin e plan mbarështimit menaxhimit të pyjeve dhe kullotave; përcaktimin e kriterëve për dhënien me qira të tyre.

Situata.

Auditimi per administrimin dhe dhënien me qira te tokave bujqësore te pandara, u krye ne zbatim te kërkesave te ligjit nr. 8312 datë 26.03.1998 “Per tokat bujqësore te pa ndara”, VKM nr. 531 datë 21.08.1998 “Per tokat bujqësore te pandara”, Udhëzimit KM nr. 1 datë 18.07.2012 “Per procedurat e dhënies te tokave bujqësore te pandara” Udhërit të MBU nr 10 datë 13.09.2012 “Per mënyrën e përllogaritjes se kritereve te vlerësimit te ofertave per marrjen me qira te tokës bujqësore, te pandare” dhe Udhërit te Ministrit te M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Per miratimin e përmbajtjes dhe formës se kontratës tip per dhënien me qira te tokave bujqësore, te pandara”, ku u konstatua se:

Per periudhën e audituar 01.01.2022 – 31.12.2022, nga kjo bashki nuk është lidhur asnjë kontrate per dhënie me qira te tokës bujqësore te pandare, por ka ne vazhdim 5 kontrata me nje siperfaqe totale prej 91.761 m2, te lidhura nga ish Njësitë e Qeverisjes vendore (Komunat), e përkatësisht:

- Kontrata e lidhur me **z. F.L** me nr rep. 1222 dhe koleksioni nr 758 datë 08.07.2011, per parcelën me nr kadastral 95/37 ne fshatin Bodrishte me siperfaqe 18.748 m2, per kultivim peme frutore, me çmim 6.000 lekë/ha/vit, me afat dhënie me qira per 99 vjet.

- Kontrata e lidhur me **z. J.LL** me nr rep. 1221 dhe koleksioni nr 757 datë 08.07.2011, per parcelën me nr kadastra l 94/1 ne fshatin Bodrishte me siperfaqe 34.976 m2, per kultivim peme frutore, me çmim 6.000 lekë/ha/vit, me afat dhënie me qira per 99 vjet.

- Kontrata e lidhur me subjektin **2B....K** me nr rep. 666 dhe koleksioni nr 303 datë 27.03.2013, per parcelën me nr kadastral 138/2 e pjesshme ne fshatin Bularat, sipërfaqen prej 7.300 m2, per nje afat 35 vjet, me tarife 6.100 lek/ha/vit kalendarik, per përdorim sipas planit te biznesit te datës 15.11.2012, ku përcakton mbjelljen e 460 rrënjëve dardhe.

- Kontrata e lidhur me **z.S.Ç**, me nr rep. 665 dhe koleksioni nr 302 datë 27.03.2013, per parcelat 301/9 deri 301/19 tek zona kadastrale 2278, ne fshatin Krioner, per sipërfaqen prej 14.914 m2, me afat per 35 vjet, me tarife 6.200 lek/ha/vit kalendarik, per mbjellje dru frutore sipas planit te biznesit, ku përcakton mbjelljen e 315 rrënjëve ara.

- Kontrata e lidhur me **z.TH.Q**, datë 30.03.2017, per parcelat me nr. pasurie 236/23, tek zona kadastrale 3018, ne fshatin Poliçan, per sipërfaqen prej 16.547 m2, me afat per 99 vjet, me tarife 9.000 lek/ha/vit kalendarik, per mbjellje te kulturës ara.

- Kontrata nr. 545/169 e lidhur me **z. DH.GJ**, datë 20.5.2022, per parcelat me nr. pasurie 456, tek zona kadastrale 2233, ne fshatin Koshivic, per sipërfaqen prej 0.1769 ha, me afat per 10 vjet, me tarife 6,500 lek/ha/vit kalendarik, per mbjellje te kulturës patate.

- Kontrata nr. 1346/447 e lidhur me **z. DH.GJ**, datë 24.11.2022, per parcelat me nr. pasurie 442, tek zona kadastrale 2483, ne fshatin LLongo, per sipërfaqen prej 5.9229 ha, me afat per 99 vjet, me tarife 7,200 lek/ha/vit kalendarik, per mbjellje te kulturës gështenjë.

Nga auditimi është konstatuar se:

- Bashkia Dropull në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, ka iniciuar procesin për dhënien me qira të tokave bujqësore **por pa miratim në Këshillin Bashkiak** për dhënien me qira të tokave bujqësore të lira me qëllim sigurimin e të ardhurave.

- Mungon proces verbali mbi tërheqjen e dokumentacionit te plotë të dhënies me qira te këtyre sipërfaqeve.

- Nuk disponohet regjistri i plotësuar me te gjitha te dhënat per te ndjekur kërkesat e kontratave te lidhura si dhe arkëtimet ne vazhdimësi.

- Ne kundërshtim me kërkesat e kontratës tip, kontrate e miratuar me Urdhrit të Ministrit te M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Per miratimin e përmbajtjes dhe formës se kontratës tip per dhënien me qira te tokave bujqësore, te pandara”, neni 2 “Detyrimet e qiramarrësit” pika “ dh”,

ku jo te gjitha rastet është paraqitur ne Bashki, kontrata e depozituar pranë ASHK Gjirokastrë, kjo per te lenë gjurme auditimit ne verifikimin e tyre.

- Ne kundërshtim me kërkesat e kontratës tip neni 3, pika “c”, kontrate e miratuar me Urdhrin e Ministrin te M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Per miratimin e përmbajtjes dhe formës se kontratës tip per dhënien me qira te tokave bujqësore, te pandara”, nga ana e qiradhënësit nuk është kryer asnjë kontroll periodik, per te verifikuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet dhe kushtet ligjore te legjislacionit mbi token bujqësore, ato te kësaj kontrate, kriteret dhe elementet e përcaktuar ne kërkesën e paraqitur prej tij pranë autoritetit qiradhënës per marrjen me qira te pasurisë.

-Nga Bashkia Dropull, nuk është dërguar informacion me shkrim, për zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Gjirokastrës, në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në dhjetor të çdo viti, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 4.

Kriteri:

- Nuk është respektuar Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu II, pika 1 subjektet e interesuara duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

“Çdo subjekt, i përcaktuar në pikën 6, të kreu I, të këtij udhëzimi, i cili kërkon të marrë me qira një tokë bujqësore të pandarë, paraqet pranë komunës ose bashkisë, e cila ka në përdorim tokën bujqësore, një kërkesë me shkrim drejtuar kryetarit të komunës ose bashkisë, ku të përfshihen edhe:

- të dhënat e kërkuarit;

- sipërfaqja dhe vendndodhja e tokës bujqësore, e cila kërkohet të merret me qira, e identifikuar me numrat kadastrale përkatës të reflektuar në dokumentacionin e DAMT-së së qarkut ose me numrin e pasurisë të reflektuar në dokumentacionin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë.

së Paluajtshme (ZVRPP);

- afati i qirasë;

- veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira duke përcaktuar kulturat bujqësore ose speciet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari;

- aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve si dhe përpunimin e produkteve;

- investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujë, sistemimin etj), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj;

- burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare;

- ndikimin e investimit ne rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;

- propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit)”.

kjo sipas kërkesave te VKM nr. 510 datë 10.06.2015 “Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupëzuara dhe te pa trupëzuara, te arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar ne njësitë e qeverisjes vendore, te prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

Shkaku: Mos njohje e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e bashkisë.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë bashkia Dropull të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për verifikimin e zbatimit të kontratave të qirasë së tokave bujqësore të lidhura nga ish- komunat, nëse ato shfrytëzohen për llojin e kontratës për të cilën është lidhur dhe nëse respektojnë detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi token bujqësore.

Për sipërfaqet e reja që do të lëshohen me qira, fillimit duhet të miratohen në Këshillin Bashkiak përpara shpalljen në ankand.

Për të gjitha kontratat e lidhura, të informohet zyrtarisht Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se në Bashkinë Dropull ushtrojnë aktivitetet 6 subjekte me objekt “Shfrytëzim karriere”, kjo sipas lejeve të miratuara nga AKBN me periudhë zbatimi nga 5 deri në 10 vite, konkretisht:

Nr	SUBJEKTI	Vendodhje	Kontrata (nr/datë)	Sipërfaqja ha	Tarifa (lek/ha/vit)	Vlera	paguar
1	J...R	Jurgucat	1543/1, dt. 27.8.2021	0.05	540,000	27,000	6.01.2022
2	N...10	Goranxi	1579/1, dt. 01.9.2021	0.025	540,000	13,500	01.9.2021
3	TH.N	Dervicjan	1676/1, dt. 24.9.2021	0.04	540,000	21,600	24.9.2021
4	TH,P	Frashtan	1508/1, dt. 23.8.2021	0.06	540,000	32,400	14.8.2021
5	J.LL	Jurgucat	1692, dt. 24.8.2021	0.03	540,000	16,200	21.9.2021
6	A...L	Jurgucat	1536/1, dt. 27.8.2021	0.05	540,000	27,000	2.9.2021
SHUMA				0.255	540,000	137,700	

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se detyrimi për periudhën 01.01.2021-31.12.2022 është në shumën 137,700 lekë, vlerë e cila është likuajduar sipas të dhënave të Drejtorisë së Ardhurave dhe verifikimit të bërë nga ana jonë.

Ndërsa për vitin 2022 e vijim nuk janë aplikuar tarifa, pasi VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar me VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe prodhim i lëndës drusore dhe jo drusore pyjore”, ku nuk ka të përcaktuar tarifë për subjektet të cilët shfrytëzojnë karrierë.

Nga bashkia Dropull (Sektori i Pyjeve), nuk është bërë kërkesë në adresë të AKBN për heqje nga fondi pyjore i sipërfaqeve në shfrytëzim sipas lejes minerale lidhje me subjektet që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore (karriera), kjo në zbatim të nenet 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin Kullosor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016.

e. Auditimi mbi administrimin e ujitjes dhe kullimit.

Auditimi mbi administrimin e ujitjes dhe te kullimit, është realizuar ne zbatim te kërkesave te ligjit nr 24/2017, datë 09.03.2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe te kullimit”, VKM nr 1108, datë 30.12.2015 “Per transferimin nga M.B.ZH.R dhe Administratës se Ujrave te asetete te luajtshme dhe te paluajtshme”, Nenit 74 te Rregullores se brendshme ku përcaktohen “Struktura dhe detyrat funksionale, per Drejtorinë e administrimit te ujrave, te pyjeve, të livadheve dhe te kullotave”, si dhe paketës fiskale te miratuar me vendim te Këshillit te Bashkise, ku nga auditimi u konstatua se:

- Nga ana e M.B.ZH.R, me shkresën nr 39 prot, datë 16.01.2017, është bërë “Transferimi nga Bordi Rajonal i kullimit Fier ne Bashkinë Dropull, te skemave ujitëse, kulluese, makineri, paisje, stacioni dhe makineri te renda”, ku kapin vlerën totale prej 73.779.265 lekë, e përkatësisht:

- Makineri, paisje, stacione, ne vlerën 4,896,513 lekë.
- Rezervuar, ne vlerën 5,936,325 lekë.
- Kanale ujitës dhe kullues, ne vlerën 52,318,324 lekë.
- Instalime, makineri, ne vlerën 10,628,103 lekë.

Per këto asete disponohen pranë “Drejtorisë se Administrimit te ujrave, te pyjeve, te livadheve dhe te kullotave”, inventarët e pronave te pa luajtshme, per çdo njësi administrative, si kanalet ujitëse dhe kulluese, argjinaturat dhe rezervuarët.

Ne paketën fiskale të miratuar për vitin 2022, me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 69, datë 25.11.2021, konfirmuar me shkresën e Prefekturës Gjirokastrë nr. 1075/1, datë 9.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, është përcaktuar për të gjithë periudhën që u auditua “Tarifa për vaditjen nga rezervuarët” në vlerën 250 lekë/dynim/për çdo vaditje.

- Prane kësaj Drejtorie ekziston evidenca progresive e sipërfaqes së projektuar për vaditje që është 2500 ha, në një kohë që sipërfaqja e cila është nën ujë është 4441 ha, pra e planifikuar me pak për 1941 ha.

Duke ju referuar arkëtimit të pasqyruar me MA për çdo fermer apo dhe në evidencën e paraqitur nga zyra e administrimit të ujrave rezultoi se është arkëtuar vetëm vlera prej 1,040 mijë lekë.

Bashkia Dropull sipërfaqja për ujë është 4000 ha, kjo me rezervuar (*rrjedhje të lirë*) prej 4000 ha. Bashkia disponon 19 rezervuar ku vetëm 6 janë funksional.

Skema kulluese është 5600 ha. Sipërfaqja gjithsej e mbjellë në fshatra është 2100 ha, nga e cila 1300 ha Dropulli Sipërm dhe 800 ha Dropulli Poshtëm. Sipërfaqja e tokës së ujitur sipas fshatrave është 227.5 ha, nga kjo me rrjedhje të lirë 416 ha.

Planifikimi për sipërfaqen për vaditje është $12600 \text{ ha} \times 250 \text{ lekë/ha} = 1,500,000 \text{ lekë}$. Në fakt është vaditur $4160 \text{ Ha} \times 250 \text{ lekë/ha} = 1,040,000 \text{ lekë}$, vlerë e arkëtuar.

Në zbatim të nevojave për “planifikimit të nevojave për ujë për ujë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit, si dhe miratimi i tarifave të shërbimit të ujitjes”, kjo në zbatim të kërkesave të ligjit nr.24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” kreu IV, neni 15 “Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkisë” apo dhe neni 19 “Miratimi i tarifave”, ku nga auditimi është konstatuar se:

1-Nga ana e Drejtorisë së Administrimit të ujrave, të pyjeve, të livadheve dhe të kullotave, pranë Bashkisë, nuk disponohej plani i masave për vënien në gatishmëri të veprave ujëtare dhe kulluese.

2-Nuk ekzistonte programi i ujitjes apo dhe kullimit, ku të ishin pasqyruar qarte:

- Evidentimi i kulturave bujqësore të mbjella dhe sipërfaqet përkatëse, për çdo fermer.
- Përcaktimi i nevojave për ujë për ujë për çdo fermer.
- Hartimi i grafikut paraprak të ujitjes.
- Evidentimi i gjendjes fizike të skemave ujëtare, për dërgimin e ujit në parcela.
- Evidentimi i gjendjes fizike të kanaleve ujëtare dhe kulluese.

3. Nuk është realizuar “Monitorimi” i shpërndarjes së ujit për ujë, e konkretisht:

- Monitorimi i shpërndarjes së ujit për fermerët mbi bazën e sipërfaqes.
- Monitorimi i evidencës numrin e ujitjeve, sasinë e ujit, sipërfaqen e ujitur, për çdo fermer.
- Monitorimi i realizimit të punimeve në kullim.
- Nuk disponohet asnjë akt marrëveshjeje mes fermerëve apo dhe fshatareve me Bashkinë, mbi kërkesën që kanë për vaditje në reference të kulturave që disponojnë. Mbi bazën e se cilës do të bëhet dhe llogaritja e shpërndarjes së ujit sipas nevojave apo dhe llogaritja e detyrimit për shërbimin që do ju kryhet.
- Evidenca e të dhënave mbi bazën e llogaritjes së detyrimit, nga ana e Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, është përcaktuar në sipërfaqe të mbjellë, sipërfaqen e vaditur sipas llojit të vaditjes (me rrjedhje të lirë apo me ngritje mekanike) referuar tarifave të paketës fiskale.

Konkluzioni: Nga ana e kësaj drejtorie të administrimit të ujit për vaditje, nuk disponohet:

- Evidenca e qarte mbi sipërfaqen që është për ujë, për çdo fermer sipas kulturave të mbjella.
- Kërkesat e fermerëve për nevojat që kanë për ujë sipas llojit të të mbjellave, sipërfaqes dhe numrit të vaditjeve.
- Nuk disponohet asnjë proces verbal që të faktojë shfrytëzimin faktik të ujitjeve të realizuara nga fermerët, kjo për të argumentuar dhe arkëtimet e realizuara me ato të programuara apo dhe të deklaruara.

- Nuk disponohet nje evidence e qarte mbi gjendjen e kanaleve ujitëse dhe kulluese, per gatishmërinë e tyre ne realizimin e sezonit te ujitjes.

Për veprimet dhe mosveprimet personat përgjegjës:

Znj. L.XH, me detyrë Drejtor i të ardhurave.

Znj. A.F me detyrë Përgjegjëse e Drejtorisë së të Ardhurave.

Z. LL.N, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të pyjeve, livadheve dhe kullotave.

Z. K,M, me detyrë Specialist i Bujqësisë për tokat.

Z. L.N, me detyrë Specialist për administrimin e kullotave/livadhe.

Pika 2.3 e programit. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022.

-Përshkrimi i situatës.

Auditimi u krye sipas programit të auditimit pika 3. Vlerësimi Raportimit Financiar dhe për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për periudhën raportuese ushtrimore viti 2022 japin paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë të analizuar me nënpikat sa më poshtë:

-*Nënpika 3.1.* Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

-*Nënpika 3.2.* Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

-*Nënpika 3.3.*Opinionin mbi pasqyrat financiare periudha raportuese ushtrimore 2022

-*Nënpika 3.4.* Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

- *Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.*

Në procesin e auditimit mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura për gjatë periudhës raportuese ushtrimore (01.01.2022 deri 31.12.2022) në Bashkinë Dropull u konstatua se: Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia Publike Bashkia Dropull periudha 2022 (*Formati nr.1*) është depozituar në Degën e Thesarit Gjyrokastër me shkresë nr.530 prot, datë 23.03.2023 e konfirmuar nga dega e thesarit duke respektuar afatin ligjor i përcaktuar deri në datën 31 mars të vitit pasardhës, veprim në përputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*”.

- *Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.*

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Në përgjithësi janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj Janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkaku e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare(Cash FLOW)”

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2022, të pozicionit financiar për Njësia Publike Bashkia Dropull;

Formati nr.1, paraqitet si më poshtë:

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2022, të pozicionit financiar Bashkia Dropull; Formatu nr.1, paraqitet në të dhënat e mëposhtme: Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=1,387,321,235 lekë.

Aktivet 1,639,172,458 lekë

Pasivet 251,851,223 lekë

Aktivet neto 1,387,321,235 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **290,441,193 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentit e tyre” në shumën 56,492,949 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 16,383,780 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 25,415,010 lekë.

Llogaritë e Klasës 4”Të tjera aktive afat shkurtra” në shumën 192,149,454 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentit e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	56,492,949	68,022,216	-11,529,267
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		56,492,949	68,022,216	-11,529,267

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 56,492,949 lekë, përbëhet nga: fondi i trashëguar nga transferta e pakushtëzuar, sektoriale dhe të ardhurat e veta, gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 19,207,904 lekë, gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 37,285,045 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2021-2022
31	Materiale	0	0	0
32	Inventar i imet	16,266,780	5,481,907	-10,784,873
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra	117,000	0	-117,000
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmëri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
Totali		16,383,780	5,481,907	-10,901,873

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Dropull në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 16,383,780 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 16,266,780 lekë dhe llogaria kontabël 35 “mallra” ne vlerën 117,000 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -10,901,873 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën -10,901,873 lekë.

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 29,425,276 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	5,481,907
Hyrje gjatë vitit 2022	10,802,873
Dalje gjatë vitit 2022	18,000
Gjendja në 31.12.2022	16,266,780

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

- ***Inventari i vitit 2022***

Nga auditimi u konstatua se titullari i Bashkisë Dropull ka nxjerrë Urdhrin e inventarizimit 137, datë 15.12.2022, ku janë përcaktuar 1 (një) grupe me nga 3 (tre) anëtarë për inventarizimin dhe vlerësimin e materialeve dhe aktiveve të trupëzuara për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Komisioni përbëhet nga:

1-P.F

2-H.B

3-E.L

Me përfundimin e procesit të inventarizimit nga komisionet, janë hartuar përmbledhëset e inventarëve, për llogarinë 218 “Inventarin ekonomik”, në vlerën 19,475,855 lekë, në llogarinë 327 “Inventarë i imët” në vlerën 16,266,780 lekë dhe llogarinë 352 “Mallra” në vlerën 117,000 lekë.

Pas përfundimit të inventarizimit në dt.13.03.2023 është mbajtur proces verbali i inventarizimit dhe vlerësimit fizik të aktiveve.

Me urdhrin e kryetarit të Bashkisë nr.55 datë 26.04.2022 është ngritur komisioni i vlerësimit i cili me proces verbalin e dt.30.05.2022 ka bërë vlerësimin e aktiveve dhe ka hartuar listën për nxjerrjen jashtë përdorimit.

Me vendimin nr.33 datë 30.06.2022 janë miratuar aktivet për nxjerrje jashtë përdorimit për:

1-Inventari ekonomik (llog.218) për vlerën 1,032,289 lekë.

2-Inventari i imët (llog.327) për vlerën 146,577 lekë.

3-Paisje (llog.231) për vlerën 19,800 lekë.

Vlera të cilat u pasqyruan në inventarët e vitit 2022 dhe në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Gjatë auditimit të kësaj procedurë është konstatuar se: Nga grupet e Inventarizimit të aktiveve për vitin 2022, është kryer proceduara sipas kërkesave të UMF 30, datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë Publike. Janë kryer inspektime fizike për të krahasuar gjendjen sipas kartelave kontabël nga anëtarët e grupeve të inventarizimit është hartuar raport përmbledhës apo relacion për përfundimin e Inventarit i cili i është përcjellë Titullarit për tu vënë në dijeni e më tej të miratojë procesin e inventarizimit.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjopa	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal	0	0	
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	
44	Institucione te tjera publike	0	0	
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	
468	Debitorë te ndryshëm	15,142,326	17,019,350	-1,877,024
4342	Te tjera operacione me shtetin(te drejta))	10,272,684	9,729,801	+542,883
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)	0	0	
	Totali	25,415,010	26,749,151	-1,334,141
	Të tjera aktive afatshkurtra	0		
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	0		
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0		
477	Diferenca konvertimi aktive	0		
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0		
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	192,149,454	0	192,149,454
	Totali	0		

-Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet për vitin 2021 në vlerën 17,019,350lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2022 paraqitet në vlerën 15,142,326 lekë, me ulje në vlerën -1,877,024 lekë.

Në mënyrë analitike debitorët paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Pasqyra analitike e llog 468, me datë 31.12. 2022.

Nr	Emri Mbiemri	Vlera	paguar 2022	krijuar 2022	Debitorët 2022
1	S.C	1,146,550			1,146,550
2	N....A	410,993			410,993
3	A...GJ & J....I.	61,804			61,804
4	G.M	116,965			116,965
5	LP	100,000			100,000
6	TH.Q	19,393			19,393
	SHUMA I (1-6)	1,855,705			1,855,705
7	TH.Q	128,067			128,067
8	T....D	122,117			122,117
9	Tatimet (sipas listës)biznesi	1,305,627	770,098	365,541	901,070
10	I.D	300,193			300,193
11	K.B	219,020			219,020
12	P.SH	321,950			321,950
13	J.M	3,555			3,555
	SHUMA II (7-13)	2,400,529	770,098	365,541	1,995,972
14	Debitorë nga taksa e tokës bujqësore (III)	9,343,612	4,560,283	3,087,815	7,871,144
	Debitor nga KLSH 2019				
15	E....N(Unaza Pogon)	1,854,605			1,854,605
16	A....N(Zyrrat)	617,500			617,500
17	A....N(Uj.Manx.)	947,400			947,400
	Shuma IV(15-17)	3,419,505			3,419,505
	SHUMA I+II+III+IV	17,019,350	5,330,380	3,453,356	15,142,326

Nga Drejtoria e Financës është mbajtur në mënyrë analitike (sipas njësive të varësisë dhe listave emërore) llogaria 468, e cila në fund të vitit 2022 rezulton me një ulje prej -1,877,024 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton që totali i llogarisë analitike në fund të vitit 2022, kuadron me llogarinë sintetike në Aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe me lëvizjet e llogarinë 468 të pasqyruara në Librin e Madh (Centralizatori 2022).

Nga shuma prej 15,142,326 lekë debitorë në 31.12.2022, shuma prej 7,871,144 lekë, ose 52% të debitorëve e zënë debitorët e krijuar nga taksa e tokës bujqësore.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 15,142,326 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 15,142,326 lekë. Vlera prej 15,142,326 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar.

Ndërsa sa i përket detyrimeve të papaguara deri më datë 31.12.2022 paraqiten:

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera në lekë
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	1,359,046
Llogaria 467 “Kreditor të ndryshëm”	189,151,168
Paga personeli llog 42	7,189,360
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	452,546
Sigurime shoqërore llog.435	1,142,275
Sigurime shëndetësore llog.436	129,457
Totali	199,423,852

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	12,728,087
Shtesa gjatë vitit 2022(D)	186,777,031
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	-81,266
Gjendja në 31.12.2022	199,423,852

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 192,149,454 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	0
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	192,149,454
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
Gjendja në 31.12.2022	192,149,454

Nga auditimi rezultoi se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 192,149,454 lekë, kjo në zbatim të Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni 3.1. Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

Aktivët Afatgjatë jomateriale (AAJM).

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjatë Jo materiale”, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe kërkime”, (kosto historike) në vlerën 12,665,888 lekë, paraqesin saktë përlllogaritjen e amortizimit në masën 15% sipas përcaktimeve në UMF.

II. AKTIVET AFATGJATA

Në formatin nr. 1 “Aktivët Afatgjatë” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”) në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,094,143,818 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,146,512,087 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,094,143,818 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,146,512,087 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjatë jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 16,758,999 lekë dhe të vitit 2022 paraqitet në vlerën 12,665,888 lekë. Po kështu dhe sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 16,758,999 lekë dhe të vitit 2022 paraqitet në vlerën 12,665,888 lekë.

- Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2022.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”) në mbyllje të vitit 2021 vlerën 1,094,143,818 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,146,512,087 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,094,143,818 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,146,512,087 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 198,582 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 198,582 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 dhe vitit 2022 në të njëjtën vlerë prej 198,582 lekë.

Nr	EMERTIMI	Vlera në lekë
	Troje –terrene	198,582
	shuma	198.582

Llog 211 “Pyje, Kullota, Plantacione paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë.

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 dhe vitit 2022 në të njëjtën vlerë prej 0 lekë.

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 209,261,703 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 200,324,716 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 279,297,209 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 280,903,628 lekë me një diferencë në rritje prej 1,606,419 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i investimit te kryer për rritjen e AQT në vlerën prej 1,606,419 lekë.

Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në (*Aneks nr.1 bashkëlidhur PRA*).

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 868,132,453 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 914,248,281 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 1,015,359,349 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,108,312,353 lekë me një diferencë në rritje prej 92,953,004 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara 101,487,686 lekë si rezultat i investimit te kryer për rritjen e AQT dhe pakësimit per 8,534,682 lekë asete te transferuara pranë Ujësjellës -Kanalizimeve sh.a Dropull.

Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në (*Aneks nr.2 bashkëlidhur PRA*).

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,637,422 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 18,878,278 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 7,591,864 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 21,650,930, lekë.

Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në (*Aneks nr.3 bashkëlidhur PRA*).

-Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 7,079,463 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,149,752 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 17,148,932 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 22,756,659 lekë ,me nje rritje 5,607,727 lekë.

Inventari i mjeteve të transportit në fund të vitit 2022.

	E m e r t i m i	Vlera ne lekë
1	Autoveturë BMW ngjyre blu targaAA...5HB	2,475,000
2	Fugon AA ... RDØ(shasia ËFOCXX....SC53792 ,	790,000
3	Autoveturë Mercedes 2017 GJ ... A	306,015
4	Mercedes benz AA ... AP	306,015
5	MERCEDES 0704 nr.shasie : ËDB656...964854 ,targa AA...UB(makine plerash)(ndihme)	850,000
6	Zjarrfikësi , nr.shasie H680.77/5302/1875(STAYER 680 m3)	600,000
7	Autobuz Mercedes Benx me targa AA...XS nr. I shasise ËDB9...631R178096(bardhe)	1,236,300
8	Automjeti tip Skoda AA ... (sofratik)	2,403,060
9	Xhipi i Pogonit GJ.... A	1,667,000
10	MicubishimetargaAA5....2KYmenumer shasie:MNCJNK....DZ25188 viti i prodhimit 2014	2,340,000
11	Makine Mitsubishi me targa AA ... LA nr.shasie: MMCJNK....FDZ25169 viti i prodhimit 2014	2,040,000
12	Eskavator Caterpillar(dhurimi ne 2017)	545,257
13	Automjeti Grejder tip SHM 5NB me numër motori 2189823 numër shasia 410128prodhim fabrikës GP Center Pararendur(HBM Nova 5)(dhurimi ne 2019)	800,000
14	Autobuz Mercedes Benx me targa AA....9Z nr. I shasise ËDB9...31R375908(bardhe)	1,236,300
15	Ambulance Volkswagen Transportier me targe AA7....XP numri I shasiseËV3...JZ6X012824	660,000
16	Mjet vetëshkarkues	2,400,000
17	Autobus transporti AB...HP	2,101,712
	SHUMA	22,756,659

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në datën 31.12.2021 është në vlerën 3,834,195 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,712,478 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,866,402 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,475,855 lekë në rritje për vlerën 641,742 lekë, e cila përfaqëson shtesat e vitit për blerje të ndryshme në vlerën 220,800 lekë dhe shtesat pa pagesë 420,942 si dhe pakësime ne vlerën 1,032,289 lekë për nxjerrje jashtë përdorimi. Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në (***Aneks nr.4 bashkëlidhur RA***).

Administrimi I aseteve.

Konstatohet se:

Ne Bashkinë Dropull ekziston regjistri i aseteve per asetet te cilat janë në inventar në vlerë.

Regjistri është formuluar me të gjitha të dhënat e kërkuara.

Nuk ekziston regjistri i aseteve për pronat si kullotat pyjet etj për arsye se që të bëhej inventarizimi i tyre duhet të bëhet vlerësimi.

Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë i mundur për arsye se duhet aktivet që të vlerësohen duhet të kenë çertifikatë pronësie.

Nga ana e Bashkisë nuk është e bërë pajisja me çertifikata pronësie jo vetëm për arsye financiare por edhe për shkak të kryerjes së aplikimeve pranë ASHK dhe mos pajisjes me çertifikatat e pronësisë. Nga ana e ish komunave janë bërë aplikime dhe janë kryer pagesat për ish Komunën Dropulli i Poshtëm për 46 copë dhe është kryer pagesa me vlerë 332,000 lekë dhe nuk është bërë pajisja me çertifikatat e pronësisë. Për Dropullin e Sipërm për 91 copë me vlerë të paguar 502,600 lekë. Këto aplikime janë bërë që në vitin 2014. Me shkresën nr.180 prot të datës 20.05.2015 nga ana e ish komunës Dropulli i Poshtëm është dërguar Kërkesë Kryeregjistruesit të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë.

Në datën 16.10.2019 me nr.1851 prot dt.16.10.2019 është ridërguar kërkesë për pajisje me çertifikata pronësie sipas aplikimeve dhe pagesave të kryera. Nga ana e ASHK-së nuk rezulton shkresë e ardhur dhe nuk është marrë asnjë përgjigje. Nga auditimi ka rezultuar se, nga 193 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 “*Toka troje terrene*”, llog. 211 “*Pyje plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në vlerën 1,389,414,563 lekë, Bashkia Dropull **nuk posedon titull**

pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Kriteri:

VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

Ndikimi/Efektiviteti:

Mungesa e titullit të pronësisë është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme, për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre dhe kjo bën që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, duke bërë që këto pasqyra të mos paraqesin vlerën e saktë të këtyre aseteve të njësisë vendore.

Shkaku:

Dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga ish-Komunat, vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë dhe kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në ASHK, e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe menaxhimit të Aseteve të marr masa menjëherë për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat “Toka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksiione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Dropull më 31.12.2022.

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Dropull në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën (309,021,077) lekë. Krahasuar me vitin 2021 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (63,702,557) lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat:

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Akvivet afatgjata me vlerë neto”

Nr. Reference Llogarije	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	16,758,999	0	16,758,999	290,404	2,235,157	2,148,358	0	14,901,045	2,235,157	12,665,888
201	0		0					0		0
202	16,758,999		16,758,999	290,404	2,235,157	2,148,358		14,901,045	2,235,157	12,665,888
203	0		0					0		0
21- 28	1,339,462,338	245,318,520	1,094,143,818	124,705,522	62,851,111	10,869,853	1,383,711	1,453,298,007	306,785,920	1,146,512,087
210	198,582		198,582					198,582		198,582
211	0		0					0		0
212	279,297,209	70,035,506	209,261,703	1,606,419	10,543,406			280,903,628	80,578,912	200,324,716
213	1,015,359,349	147,226,896	868,132,453	101,487,686	48,054,273	8,534,682	1,217,097	1,108,312,353	194,064,072	914,248,281
214	7,591,864	1,954,442	5,637,422	15,361,948	984,824	1,302,882	166,614	21,650,930	2,772,652	18,878,278
215	17,148,932	10,069,469	7,079,463	5,607,727	2,537,438			22,756,659	12,606,907	10,149,752
216	0		0					0		0
217	0		0					0		0
218	19,866,402	16,032,207	3,834,195	641,742	731,170	1,032,289		19,475,855	16,763,377	2,712,478
24	0		0					0		0
28	0		0					0		0
	1,356,221,337	245,318,520	1,110,902,817	124,995,926	65,086,268	13,018,211	1,383,711	1,468,199,052	309,021,077	1,159,177,975

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Dropull, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Llogaria 230 dhe 231 "Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2022, paraqiten në vlerën 186,603,290 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 186,603,290 lekë.

Në mënyrë analitike shtesat për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten si më poshtë:

“Investime, llogaria analitike 23 viti 2022”

Nr.	Llogaria 212/Objekti	Vlerë në lekë
I	Blerje me pagesë	1,606,419
II	Shtesë pa pagesë	
	SHUMA 212	1,606,419

Nr.	Llogaria 213/Objekti	Vlerë në lekë
	Blerje me pagesë	99,339,328
	Shtesë pa pagesë	2,148,358
	Transferimet pranë Ujesjelles –Kanalizime sh.a Dropull	8,534,682
	SHUMA 213	92,953,004

Nr.	Llogaria 214/Objekti	Vlerë
	Blerje me pagesë	8,991,485
1	Shtesë pa pagesë	6,370,463
2	Transferimet pranë Ujesjelles –Kanalizime sh.a Dropull	1,283,082
3	Nxjerrje jashtë përdorimit	19,800
	SHUMA 214	14,059,066

Nr.	Llogaria 215/Objekti	Vlerë
	Blerje me pagesë	2,400,000
1	Shtesë pa pagesë	3,207,727
	SHUMA 215	5,607,727

Nr.	Llogaria 218/Objekti	Vlerë
I	Blerje me pagesë	220,800
II	Shtesë pa pagesë	420,942
1	Nxjerrje jashtë Përdorimit	1,032,289
2		
	SHUMA 218	-390,547

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Dropull më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2021	Viti 2022	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	1,440,312	1,359,046	-81266
42	Detyrime ndaj personelit	6,701,355	7,189,360	488,005
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	425,267	452,546	27,279
435	Sigurime shoqërore	1,044,492	1,142,275	97,783
436	Sigurime shëndetësore	118,375	129,457	11,082
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	28,928,305	37,285,045	8,356,740
467	Kreditorë të ndryshëm	2,998,286	189,151,168	186,152,882
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	17,019,350	15,142,326	-1,877,024
	Gjendja më fund të periudhës	58,675,742	251,851,223	193,175,481

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2021 është në vlerën 1,440,312 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Dropull më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Çelje e vitit 2022	1,440,312
Shtesa (K)	1,359,046
Pakësime (D)	1,440,312
Gjendja në 31.12.2022 (K)	1,359,046

Gjendja e llogarisë 401-408“Furnitorë e llogari të lidhura me to” në shumën 1,359,046 lekë përbëhet nga :

1	energji elektrike	Faturat e muajit Dhjetor 2022	656.690
2	këshilltarët-kryetaret e fshatrave	Pagesa e muajit Dhjetor 2022	455.430
3	posta shqiptare		5.475
4	ndihma ekonomike	Pagesa e muajit Dhjetor 2022	234.226
	SHUMA		1,359,046

- **Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Dropull paraqitet në vlerën 7.189.360 lek dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2022	6.701.355
Shtesa (K)	78,156,552
Pakësime (D)	77,668,547
Gjendja në 31.12.2022(K)	7,189,360

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Numër	Datë	
4	12.01.2023	5,230,653
5	12.01.2023	300,257
6	12.01.2023	126,903
7	12.01.2023	471,499
8	12.01.2023	31,391
9	12.01.2023	147,746
10	12.01.2023	34,810
1	12.01.2023	846,103
	Totali	7,189,360 lek

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 452.546 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2021	425.267

Shtesa (K)	3,095,529
Pakësime (D)	3,068,250
Gjendja në 31.12.2021 (K)	452,546

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Numër	Datë	
13	12.01.2023	114,645
1	12.01.2023	337,901
	Shuma	452,546

- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 1,142,275 lekë dhe 129,457lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2022	1,044,492
Shtesa	11,797,057
Pakësime	11,699,274
Gjendja në 31.12.2022	1,142,275
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2022	118,375
Shtesa	1,337,000
Pakësime	1,325,918
Gjendja në 31.12.2022	129,457

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Numër	Datë	
1	12.01.2023	1.142.273
2	12.01.2023	129.459
	totali	1.271.732

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Dropull, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 37,285,045 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Dropull, sipas akt-akordimit datë 28.03.2023.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2022	28,928,305
Shtesa	15,296,400
Pakësime	6,939,660
Gjendja në 31.12.2022	37,285,045

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në (*Aneks nr.5, bashkëlidhur PRA*).

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 paraqiten në shumën 189,151,168 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2022	2,998,286
Shtesa	247,526,613
Pakësime	61,373,731
Gjendja në 31.12.2022	189,151,168

Këto vlera janë paraqitur në mënyrë analitike dhe përbëhen nga Fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore sipas pasqyrës si më poshtë:

Gjendja e llogarisë 467 (shpenzime 602) me 31.12.2022

Nr	EMERTIMI	FATURA TATIMORE NUMER DHE DATË	SHUMA
1	Energji elektrike	Akt marrëveshje dt.25.08.2022	8.960.119
	SHUMA		8,960,119

Gjendje llogarisë 467 per shpenzime 231 me 31.12.2022

Nr	Emërim i furnitorit	Fatura		Vlera lekë
1	G.....G	37/2021	20.10.2021	16.859
2	R.....U	1/2022	28.07.2022	7.285.993
3	R.....U	02/2022	23.08.2022	56.206.215
4	B.....S	33/2022	29.12.2021	44.172.136
5	B.....S	39/2022	13.07.2022	64.434.255
6	K...N	130/2022	29.04.2022	9.075.591
	Totali			180,191,049

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën 19,207,904 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Dropull trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

Llog. 85 "Rezultati i ushtrimit"	
Çelje e vitit 2021	39,093,911
Shtesa(te ardhurat)	19,207,904
Pakësime	39,093,911
Gjendja në 31.12.2021	19,207,904

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Dropull më datë 31.12.2022 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Gjirokastër, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Diferenca
-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	53,203,598	Akt-Rakordimi me Degën e thesarit	53,203,598	0
-Granti nga buxheti	147,505,007	28.03.2023	147,505,007	0
-Financim i pritshëm nga buxheti	15,142,326		15,142,326	0
-Fonde buxhetore të trashëguara	23,479,812		23,479,812	0
-Të ardhura të trashëguara (rez)	15,614,098		15,614,098	0
-Llog 73 Ndryshim i gjendjes	-10,901,873		-10,901,873	0
0me(+)/0				
Totali të ardhura	244,042,968		244,042,968	0

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2021	Detyrime të vitit 2022	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	84,857,907	6,701,355	91,435,671	100,010,618
601	14,296,924	1,162,867	15,053,972	16,469,162
602	37,762,308	1,440,312	26,425,575	32,496,874
604	4,551,400	0	2,102,191	2,345,625
606	43,117,302	0	88,577,255	88,577,255
63				-1,401,679
8423				1,401,679
8421				1,472,217
8424				7,709,037
Totali	184,585,841	9,304,534	223,594,664	249,080,788

Diferenca në shumën 8,665,892 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca midis detyrimeve të muajit Dhjetor 2021 të paguara në vitin 2022 dhe detyrimeve të Dhjetorit 2022 të paguara në Janar 2023 e vijim në shumën 2,653,304 lekë, vlerës prej -1,401,679 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" dhe si dhe vlerës prej 9,181,716 lekë nga operacione të korigjimit të rezultatit.

Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 "shpenzimet" dhe klasës 7 "të ardhurat", janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore", konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	282,167,578	282,167,578	0
II	Shpenzime	249,080,788	249,080,788	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	33,086,790	33,086,790	0

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën 33,086,790 lekë, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare paraqitet në shumën 33,086,790 lekë.

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2022. Teprica e likuiditeteve në fund te vitit ushtrimor 2021 zë vlerën 68,022,216 lekë, dhe përbëhet nga mjetet në ruajtje në vlerën 28,928,305 lekë plus të ardhurat e trashëguara 39,093,911 lekë.

Teprica e likuiditeteve në fund te vitit ushtrimor 2022 zë vlerën 56,492,949 lekë, përbëhet nga mjetet në ruajtje në vlerën 37,285,045 lekë plus të ardhurat e trashëguara në vlerën 19,207,904 lekë. Nga kontrollt e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2022, e paraqitur në lart rezulton në shumën 56.492,949 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" e cila paraqitet në shumën 56,492,949 lekë.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare".

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Nr. Reshti	Reference	EMERTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Rezerva	Fonde te Tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Tepricë/Deficit	GJITHESEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
a	b	c	1	2	3	4	5
1	101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	1,123,029,779		-18,020,659	345,160,606	1,450,169,726
2		II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	29,451,570	0	-84,972,275	-7,327,786	-62,848,491
3		I.NGA BURIME TE BRENDSHME	28,244,327	0	-84,972,275	-7,327,786	-64,055,734
4	105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)					0
5	1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0				0
6	1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)	0				0
7	12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	46,212,697			-7,327,786	38,884,911
8	85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	39,093,911		-19,886,007		19,207,904
9	111	Nga Rezervat (+,-)	0				0
10	115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	2,763,600				2,763,600
11	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)	0				0
13	1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	-59,825,881		-65,086,268		-124,912,149
14	1015	Nga nxjerrjet jashtëpërdorimi dhe dëmtimet(-)	0				0
15	107	Vlera te AAGJ, te Caktuara ne përdorim(+,-)	0		0		0

Nr. Reshti	Reference	EMERTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Rezerva	Fonde te Tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Tepricë/Deficit	GJITHESEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
a	b	c	1	2	3	4	5
16	109	Diferenca nga Rivlerësimi I AAGJ(+,-)	0				0
17		2.NGA BURIME TE JASHTME	1,207,243	0	0	0	1,207,243
18	106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)	1,207,243				1,207,243
19	1016, 1069	Nga Transferata e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0				0
20		TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	1,152,481,349	0	102,992,934	337,832,820	1,387,321,235

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën 1,387,321,235 lekë. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

Vlera prej -62,848,491 lekë, përfaqëson gjithë pakësimet e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

Vlera prej -65,086,268 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor (shtesa).

Vlera prej 19,207,904 lekë, përfaqëson rezultatit financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.85.

Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën 1,387,321,235 lekë kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

Shënime shpjeguese (Pasqyra F5):

Plotësimi i kësaj pasqyre është bërë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, pika 3.7 "Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale". Nga Bashkia Dropull është plotësuar Pyetëtori dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore".

Pasqyrat statistikore

Pasqyra statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit"

Numër llogarie	Emërtimi	Vlera D	Vlera K	Teprica
	Shpenzimet për investime	302,111,322	112,558,032	189,553,290
230	Shpenzime afatgjata jomateriale			
231	Shpenzime Afatgjate materiale	299,161,322	112,558,032	186,603,290
	Burimet për investime			
26	Shpenzime për aktive Afatgjata financiare	2.950.000		2,950,000
1051	Grante kapitale nga nivele të tjera			
1059	Grante të brendshme kapitale në natyrë			
11	Fonde të tjera të veta			
115	Caktim fondi për investime nga rezultati			
	Balanca	302,111,322	112,558,032	189,553,290

Vlera prej 299,161,322 përfaqëson shpenzimet për investime të cilat janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gjirokastrë.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore "Investimet dhe burimi i financimit" është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.1 "Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore të investimeve dhe burimeve të financimit të tyre".

Pasqyra statistikore nr. 8 “Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave”. Në lekë

Nr.	K A T E G O R I T E	Numri	NUMRI I PUNONJSEVE			FONDI I PAGAVE DHE KONTRIBUTET					
		mesatar	Ndryshuar gjate vitit			Fondi	Shpërblimi	Ndihma	Kontributi	Shpërblimi	Tatimi
		vjetor	Pranuar		Gjendje	pagave	supleme-	shoqërore	sig. Shoq.	te	mbi
		punonjësve	te	Larguar	fund	gjithsej	ntare	te menje-	dhe	tjera	te
		gjithsej	rinj		te vitit			hershme	shendete-		ardhurat
					ushtrimor				sore		
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
	Nr.i punonjësve gjithsej	142	34	27	149						
	(1+2+3+4+5)					81,337,111	0		14,296,925		3,520,796
1	D r e j t u e s	17	1	1	17	14,923,104			2,712,474		1,319,259
2	Spec. Arsime te larte	38	1	1	38	22,156,245			3,944,228		709,465
3	T e k n i k e	19	0	16	3	1,599,292			279,187		72,484
4	Nëpunës te thjeshte	34	11	6	39	17,925,799			3,108,061		685,342
5	Punëtorë	34	21	3	52	24,233,169			4,169,440		733,539
6	Punonjës te përkohshëm	0	5	5	0	499,502			83,535		707

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.4 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave”.

-Është mbajtur dhe përditësuar libri i pagave dhe ditari i pagave.

-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga specialisti i pagave, nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.

-Nga verifikimi me zgjedhje i ushtruar në listë pagesat e muajve Korrik-dhjetor për vitin 2021 rezultoi se pagat, shtesat dhe ndalesat janë përlllogaritur drejt sipas tabelës së pagave si dhe kanë përputhje me nivelin e arsimit. Nga ky sondazh u verifikuan përcaktimi i niveleve të pagave dhe pagesa e tyre, ku rezultoi se: ato ishin në përputhje me nivelet e përcaktuar për shtesat e pozicionit si dhe shtesat e pagës së grupit përputheshin me nivelin e arsimit sipas përcaktimeve të lidhjes nr.5 të VKM të pagave dhe sipas kategorisë 3 së kësaj njësie vendore. Gjithashtu liste pagesat janë të shoqëruara dhe në përputhje me liste prezencat përkatëse. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi financës dhe titullari.

-Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar drejt dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës. Nga sa më sipër konstatohet se, nga verifikimi me zgjedhje i listpagesave, është kryer drejtë përlllogaritja e pagës pasi dhe u janë llogaritur shtesat e viteve të vjetërsisë në punë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të

ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë e konstatuara më sipër, mbi vlerësimin e raportimit financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022 për paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi ngarkohen me përgjegjësi: Zj.TH.P, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të Bashkisë Dropull.

(Nga subjekti audituar Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

Pika 2.4 e programit. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022.

- Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, sipas Aneks 2.4.1 bashkëlidhur Raport Auditimit.

- Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për investime/blerje malli etj.

Për periudhën e vitit 2022 janë parashikuar realizimi i procedurave të vlerë të lartë dhe të ulët në artikullin (602/231) në shumën 130,994,200 lekë, nga e cila:

- c- Prokurime me vlerë të lartë 115,340,010 lekë për 13 procedura.
- d- Prokurime me vlerë të vogël me vlerë 15,654,191 lekë kjo për 40 procedura.

Në fakt nga të parashikuara janë realizuar vlera 109,954,949 lekë, nga e cila:

- c- Procedura me vlerë të lartë 99,617,511 lekë.
- d- Procedura me vlerë të vogël 10,337,438 lekë.

Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2022, për artikullin (602/231) janë në vlerë 181,550,095 lekë, nga e cila:

- c- Procedura me vlerë të lartë 180,191,049 lekë.
- d- Procedura me vlerë të vogël janë 1,359,046 lekë.

Në lidhje me procedurat e mosrealizuara dhe të planifikuara për periudhën 2021-2022, kemi këtë situatë:

Për vitin 2021

Nuk janë realizuar 4 procedura, si vijon:

- 5) Rikonstruksioni ne ujësjellësit ishte planifikuar në vlerën 6,750,833 lekë dhe nuk u realizua për arsye se qeveria Shqiptare ka miratuar 2 (dy) projekte të mëdha ujësjellësit për Bashkinë tone të cilat përfshinin edhe këtë procedure ndaj dhe Bashkia e pa të pa arsyeshme të zhvillonte një procedure të tilla.
- 6) Rikonstruksioni I sistemit të ngrohjes në vlerën 2,533,333 lekë, nuk u realizua për arsye se nuk kishim një projekt të realizueshëm konkret.
- 7) Per blerjen mjet vetëshkarkues me vlerë 2,500,000 lekë, procedura u krye por nuk arriti të lidhte një kontrate për arsye se operatori ekonomik nuk përmbushte kriteret e vendosura në DST.

- 8) *Blerje mjet me vlerë 2,083,333 lekë*, nuk u realizua per arsye se nuk u realizua plani i te ardhurave te parashikuara.

Për vitin 2022:

- 5) *Blerje automjeti me vlerë 2,500,000 lekë*, nuk u zhvillua per arsye se nuk u be tenderimi i procedurës.
- 6) *Hartimi i planit te mbarështimit me vlerë 8,250,000 lekë*, nuk u realizua per arsye se u be procedura e prokurimit shërbim konsulence me dy faza, faza e dyte u be shkesore e cila ishte e gabuar dhe nuk u arit te ritenderohet.
- 7) *Blerje beton me fond 2,500,000 lekë*, ishte planifikuar per mirëmbajtjen e rrugëve ne Pogon, pas nje marrëveshje me shoqërinë “T” dhe dhurimin e çimentos u planifikua procedura “Rikonstruksion i pjesshme i rrjetit të vjetër rrugor të njësisë administrative Pogon me shtresë betoni” per Bashkinë Dropull.
- 8) *Blerje mjet gërmimi me vlerë 3,139,166 lekë*, nuk u realizua per arsye se qeveria Shqiptare vendosi t’i dhuronte Bashkise tone nje mjet te tille.

Përsa i përket procedurave me vlere te vogel te porealizuara per vitet respektivisht 2021-2022 arsyeja ka qene mos planifikimi i sakte nga ana e drejtuesve te programeve dhe ndjekja e buxhetit te planifikuar nga ana e drejtorive respektive.

- Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH^{së}, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 – 31.12.2022 nga subjekti Bashkia Dropull, konstatohet se janë zhvilluar gjithsej **74** procedura prokurime me vlere të larta dhe të vogël me fond limit 509,635 mijë lekë dhe vlerë kontratë të lidhur prej 479,632 mijë lekë me një diferencë prej 30,003 mijë lekë ose 5.8% e fondit të prokuruar, *nga të cilat:*

a- Procedurat me vlerë të lartë (2021+2022) janë gjithsej **21** proçedura me fond limit 477,559 mijë lekë dhe vlerë kontratë të lidhur prej 461,605 mijë lekë, me një diferencë prej 15,953 mijë lekë ose 3.3%.

b- Procedurat me vlerë të vogël (2021+2022) janë gjithsej **53** proçedura me fond limit 32,076 mijë lekë dhe vlerë kontratë të lidhur prej 18,026 mijë lekë, me një diferencë prej 14,049 mijë lekë ose 43.7%, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

Në 000/lekë

EMERTIMI	Nr.	Fondi limit	Vl. Kontrate	Diferenca (FL-VLK)
Procedura me vlerë të lartë 2021+2022	21	477,559	461,605	15,953
<i>Procedura te realizuara viti 2021</i>	<i>12</i>	<i>377,941</i>	<i>375,387</i>	<i>2,554</i>
<i>Procedura realizuara viti 2022</i>	<i>9</i>	<i>99,617</i>	<i>86,218</i>	<i>13,399</i>
Procedura vlerësuara per auditim	5	419,855	408,420	
<i>Nga viti 2021</i>	<i>3</i>	<i>361,237</i>	<i>354,475</i>	
<i>Nga viti 2022</i>	<i>1</i>	<i>58,648</i>	<i>53,945</i>	
<i>Shprehur ne %</i>	<i>23.8</i>	<i>87.9</i>	<i>88.4</i>	
Procedura blerje me vlere vogël	53	32,076	18,026	14,049

EMERTIMI	Nr.	Fondi limit	Vl. Kontrate	Diferenca (FL-VLK)
<i>Procedura te realizuara viti 2021</i>	29	19,070	8,657	10,412
<i>Procedura realizuara viti 2022</i>	24	13,006	9,368	3,637
Procedura vlerësuarë per auditim	10	3,692	3,840	
<i>Nga viti 2021</i>	5	1,061	1,488	
<i>Nga viti 2022</i>	5	2,631	2,352	
<i>Shprehur ne %</i>	18.87	11.51	21.31	
TOTALI GJITHSEJ (2021+2022)	74	509,635	479,632	30,003
<i>Procedura te realizuara viti 2021</i>	41	397,011	384,045	12,966
<i>Procedura realizuara viti 2022</i>	33	112,623	95,586	17,036
Procedura vlerësuarë per auditim	58	451,962	426,446	
<i>Nga viti 2021</i>	33	380,307	363,133	
<i>Nga viti 2022</i>	25	71,654	63,313	
<i>Shprehur ne %</i>	78.3	88.6	88.9	

Mbi bazën e materialitetit të bërë nga grupi i KLSH, nga **74** procedura prokurimi të zhvilluara me fond limit **509,635** mijë lekë, janë vlerësuar për auditim nga **57** procedura me fond limit **434,955** mijë lekë ose 85.35% e totalit të procedurave, nga të cilat:

a- Procedurat me vlerë të lartë (2021+2022), nga 21 procedura me fond limit 477,559 mijë lekë, janë vlerësuar për auditim 5 procedura me fond limit 419,885 mijë lekë ose 87.9% e fondit.

b- Procedurat me vlerë të vogël (2021+2022) nga 53 procedura me fond limit 32,076 mijë lekë janë vlerësuar për auditim 10 procedura me fond limit 3,692 mijë lekë ose 11.51% e fondit:

Nga auditimi i **5** procedurave me vlerë të lartë me fond limit 419,885 mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **4** procedura me vlerë të fondit limit 402,919 mijë lekë. *Shkeljet kanë konsistuar në këto drejtime:*

Titulli i gjetjes 1: *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë, duke përdorur kriterë të ekzagjeruar, të panevojshme për realizimin e objektivit të prokurimit dhe të pa-argumentuara, konstatuar kjo në **4** procedura prokurimi.*

Situata:

Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të lartë me fond limit 419,885 mijë lekë të vlerësuarë për auditim për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në **aplikimin e kriterëve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara gjithsej **3** procedura me fond limit **402,919** mijë lekë, kriterë të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

Procedura me objekt	Fondi limit	Kontrata	OE fitues	Viti
<i>Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "Bularat"+kopesht Bularat,Dropull i Siperm</i>	58,648,181	53,945,123	GJ....A	2022
<i>Rikonstruksion i rrjetit te brendshëm te ujësjellësit te Dervician,Sofratik dhe Terihat ,Bashkia Dropull</i>	120,286,360	119,025,533	K....N	2021
<i>Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujësjellësit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashan,Lugar dhe Grapsh,Bashkia Dropull</i>	210,633,067	206,313,149	R.....U	2021
<i>Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme ne fshatrat e Bashkise e mbrojtje malore</i>	13,352,072	13,214,300	M....S	2021

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me kriteret specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit. Kërkesa për mjek të përgjithshme të pambështetur në ligj, etj.

Vendosja si kriteret e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “Për prokurimin publik”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

Mos hartimi i oponenta teknike në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 120/2020, datë 7.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Kriteri:

Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efektiviteti:

Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumentuara, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa e konkurrencës.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Njësia e Prokurimit*).

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria Juridike (Sektori i procedurave të Prokurimit) në Bashkinë Dropull, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për të gjithë procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera nuk duhet të hidhen në prokurim pa marrë më parë miratimin nga Instituti i Ndërtimit për oponentin teknike të investimit.

Titulli i gjetjes 2: *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e pjesëmarrjes, konstatuar kjo në 2 procedura prokurimi.*

Situata:

Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të lartë me fond limit 419,885 mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **2 procedura** me vlerë të fondit limit **269,281** mijë lekë, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.

Procedura me objekt	Fondi limit	Kontrata	OE fitues	Viti
Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "Bularat"+kopsht Bularat,Dropull i Sipërm	58,648,181	53,945,123	GJ...A	2022
Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujësjetës të fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan,Lugar dhe Grapsh,Bashkia Dropull	210,633,067	206,313,149	R.....U	2021

Kriteri:

Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit".

Ndikimi/Efektiviteti:

KVO, ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE në paligjshmëri të LPP, pasi nuk plotëson kriteret e DT.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave*)).

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i bashkisë Dropull, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Rastet e shkeljeve sipas procedurave paraqiten si vijon:

1- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në fshatrat e bashkisë Dropull (mbrojte malore)", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në fshatrat e bashkisë Dropull (mbrojte malore).		
1. Urdhër Prokurimi nr. 453, datë 9.3.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 453, datë 9.3.2021	4. Komisioni VO nr. 455/1, datë 9.3.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur",	M.Q A.T S.E	TH.P E.L L.K
5. Fondi Limit (pa TVSh) 13,352,070 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) "M...S" ShPK me vlerën e ofertës 13,214,220 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 98.9 %.
8. Data e hapjes së tenderit 22.4.2021 REF -90128-03-17-2021	9. Burimi Financimit Buxheti Bashkisë.	10. Operatorë Ekonomike 2: a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 1 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		

13. Lidhja e kontratës Nr. 788, datë 10.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 13,214,220 lekë me afat 2 muaj	
--	--	--

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se nga AK Bashkia Dropull nuk është hartuar oponenta teknike në zbatim të nenit 6⁸ të ligjit nr. 120/2020, datë 7.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, **duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK z. DH.T.**

Me urdhër nr. 455/2, datë 9.3.2021 të titullarit të AK z. DH.T është ngarkuar z. A.T për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim.

- Vlerësimi i kritereve:

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 15.3.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 33, datë 9.3.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 22.4.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Në aplikimin e kritereve me gjithë ndërhyrjet e APP dhe ndryshimet të bërë nga AK, janë konstatuar kritere **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, konkretisht:

Pika 2.3.5 të DST, për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Certifikatën e marrjes në dorëzim.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e nenin 26, pika 6⁹, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar.

Sa më sipër kjo kërkesë e pengon OE për të marrë pjesë në garë për një punë për të cilën ende nuk e kanë marrë certifikatën e marrjes në dorëzim.

⁸ Oponenta teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik. 2. Për çdo rast, institutet shtetërore ose entet e tjera, që kryejnë oponentin teknik, janë solidarisht përgjegjëse me projektuesin për çdo dëm që rrjedh si pasojë e gabimeve ose të metave të oponentit teknik, si dhe mbajnë përgjegjësi administrative ose penale, sipas rastit, për shkeljen e legjislacionit në fuqi. Rregullat për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponentit teknik sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

⁹ Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Pika 2.3.4/d. e DST. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar **1 (një) mjek** të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçensë per ushtrimin individual te profesionit, diplomë.

Nga sa më sipër rezulton se, në Vendimin nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011”, të KM “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, germa “b” dhe pika 4 germa “b” thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i KM, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, **shfuqizohet**. Në çdo rast, njësia e prokurimit në vendosjen e këtij kriteri duhet të merrte parasysh faktin se në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 ndër të tjera përcaktohet se: “shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim”.

Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar. Gjithashtu punësimi i mjekut në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muaj, rezulton të jetë një kriter i pa-argumentuar i cili sjell ngushtime të mëtejshme të konkurrencës, duke favorizuar operatorë të caktuar që kanë mjek në listëpagesës.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi; anëtarët e NJP, respektivisht: M.Q me detyrë Juriste Drejtoria e Buxhet financës, z. A.T me detyrë Drejtor PZHT dhe z. S.E me detyrë specialist (ing. Elektrik)Drejtoria e Shërbimit Urban.

- Zhvillimi procedurës.

Me urdhrin e prokurimit nr. 455, datë 9.3.2021 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 13,352,070 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 455/1, datë 9.3.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 22.4.2021.

Me datë 22.4.2021 ora 10.00 në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”.

Pas përfundimit të dorëzimit të ofertave, anëtarët e KVO në mënyrë të pavarur kanë bërë vlerësimin.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. Bashkimi i OE “T...D” ”6...N” me ofertë **8,693,100** lekë pa TVSH
2. Shoqëria “M...S” Shpk me ofertë **13,214,300** lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Shoqëria “T...D” Sh.p.k.&”6...N” Shpk, pasi:**

a. Staf i drejtuesve teknik i shoqërisë të ketë në përbërje :

Inxhinier Hidroteknik (Nuk ka paraqitur dokumentacion per inxhinier hidroteknik)

Inxhinier Gjeodet (Inxh. Gjeodet i pa siguruar ne mujon Dhjetor 2020, Janar 2021)

b. Të ketë në stafin e punonjësve dhe te figurojnë ne listëpagesat per periudhën Dhjetor 2020–shkurt 2021,

9 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimit e sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit ne fuqi si dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi ku nga këta të jenë të paktën: 3 Ekskavatorist i përgjithshëm, ku 2 nga këta te jene edhe te pajisur me leje drejtimi me kategoritë B, C, Një Hekurkthyes; një mekanik, një karpirtjer, një teknik ndërtimi i pajisur me dokumente shkolle të mesme profesionale, 2 murator. Këto dëshmi duhen shoqëruar me kontrata pune si dhe me dokument certifikimi/ leje manovrimi.

Nuk plotëson pjesërisht kushtin: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

-Kamion vetëshkarkues i pajisur edhe me vinç me kapacitet mbajtës 5-7 ton copë nje

-Eskavator me zinxhirë te pajisur dhe me çekiq copë nje

-Betoniere kantieri me kapacitet 3.5 m3 shoqëruar me foto copë nje

-Kriko mbi pjastër (deflektometer) per testimin e ngjeshmërisë se dheut ne rruge copë nje

-Pirun ngritës 2.5ton aftësi ngritëse per ngritjen e ngarkesave te ndryshme ne objekt

3. Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:
 I mungon dokumentacion per te vërtetuar se disponon:
 - semaforë per bllokim rruge 2 (dy) cope
 - kulle ndriçimi 1 (nje) cope

Pas përfundimit KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues shoqërinë “M.S” shpk me ofertë **13,214,300 lekë pa TVSH** pikët totale të marra 100 është identifikuar si oferta e suksesshme. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26/04/2021.

Ankesa: nuk ka.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i OE “M.S” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se shoqëria plotëson kriteret e DST të miratuar nga AK dhe vlerësimi i bërë nga KVO është i saktë.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanistër, Haskov, Dhujan, Frashtan, Lungar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanistër, Haskov, Dhujan, Frashtan, Lungar dhe Grapsh, Bashkia Dropull.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 333, datë 19.2.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 333, datë 19.2.2021	4. Komisioni VO nr. 333/1, datë 19.2.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”,	M.Q A.T S.E	TH.P G.M L.K
5. Fondi Limit (pa TVSh) 210,633,067 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “R....A”, “T.....U” & “SH....I” & “V.....N” ShPK me vlerën e ofertës 206,313,149 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 98 %.
8. Data e hapjes së tenderit 9.4.2021 REF -89291-03-08-2021	9. Burimi Financimit Buxheti Shtetit.	10. Operatorë Ekonomike 2: a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 1 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
13. Lidhja e kontratës Nr. 760, datë 6.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 206,313,149 lekë me afat 18 muaj	

Me shkresën nr. 215, datë 28.01.2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime) është miratuar fondi në vlerën 252,320,861 lekë për buxhetin e vitit 2021-2024, me financim për 2021- 2022-2023.

Me shkresën nr. 269/2, datë 5.3.2021 është dërguar opoenca teknike nga Instituti i Ndërtimit sipas shkresës së bashkisë nr. 251, datë 5.2.2021.

Leje infrastrukturore nr. 920/12, datë 4.6.2021, me afat kohorë deri me datë 4.12.2022.

Me urdhër nr. 333/2, datë 19.2.2021 të titullarit të AK z. DH.T është ngarkuar z. A.T për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim.

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se nga AK Bashkia Dropull nuk është hartuar opoenca teknike në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 120/2020, datë 7.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, **duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK z. DH.T.**

- **Vlerësimi i kritereve:**

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 23.2.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 33, datë 19.2.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 9.4.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Në aplikimin e kritereve me gjithë ndërhyrjet e APP dhe ndryshimet të bërë nga AK, janë konstatuar kritere **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, konkretisht:

Pika 3.1/i të DST, për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e nenin 26, pika 6, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar.

Sa më sipër kjo kërkesë e pengon OE për të marrë pjesë në garë për një punë për të cilën ende nuk e kanë marrë certifikatën e marrjes në dorëzim.

Pika 3.2 e DST, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jenë:

N.P- 12/D Punime të inxhinierisë mjedisore - ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë. Nga sa më sipër rezulton se, në Vendimin nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011”, të KM “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, germa “b” dhe pika 4 germa “b” thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i KM, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, **shfuqizohet**. Në çdo rast, njësia e prokurimit në vendosjen e këtij kriteri duhet të merrte parasysh faktin se në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 ndër të tjera përcaktohet se: “shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të

punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim”.

Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar. Gjithashtu punësimi i mjekut në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muaj, rezultoi të jetë një kriter i pa-argumentuar i cili sjell ngushtime të mëtejshme të konkurrencës, duke favorizuar operatorë të caktuar që kanë mjek në listëpagesat.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: M.Q me detyrë Juriste Drejtoria e Buxhet financës, z. A.T me detyrë Drejtor PZHT dhe z. S.E me detyrë specialist (ing. Elektrik)Drejtoria e Shërbimit Urban.

Zhvillimi procedurës.

Me urdhrin e prokurimit nr. 333, datë 19.2.2021 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 210,633,067 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 322/1, datë 19.2.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 9.4.2021.

Me datë 9.4.2021 ora 10.00 në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”.

Pas përfundimit të dorëzimit të ofertave, anëtarët e KVO në mënyrë të pavarur kanë bërë vlerësimin.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. Shoqëria “**A....S**” Shpk me ofertë 168,252,603 lekë pa TVSH.
2. Bashkimi i OE “R.....U” & “SH....I” & “V.....N” me ofertë 206,313,149 lekë pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1- Shoqëria “A....S” Sh.p.k., pasi:

- Nga shoqëria nuk është paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave lokale viti 2019/2020 Bashkia Durrës, ku nga QKB ka adresë të hapur.

- Nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme, pasi kontrata me datë 5.12.2016 me vlerë 186.901.165 lekë është mbyllur me datë 28.2.2018, pra jashtë afatit 3 vjeçar nga dita e hapjes së procedurës. Kontrata shtesë 37,328,467 lekë nuk plotëson 50% të vlerës së punimeve.

- 3 nga punonjësit me profesion montim tubash, nuk kanë kartelë personale të sigurimit teknik.

- certifikata PAS 99-2012 nuk është depozituar.

- Nuk disponon mjetet si vijon: Tronket për hapje kanalesh mbi 10 ton, pitër laser KL-81L si dhe paisje për matjen e presionit të tubove (ka paraqitur kontratë qiraje por firma e zotëron me nje fletë dalje nga një OE. Fletëdalja nuk është faturë shitje).

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimi i OE “R....A”, “T.....U” & “SH....I” & “V.....N” oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej vlera 206,313,149 lekë **pa TVSH** pikët totale të marra 100 është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16/04/2021.

Me shkresën datë 26.4.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i miratuar nga titullari i AK.

Me vendim nr. S’ka, datë 26.4.2021 nga titullari i AK është bërë shpallja fitues e bashkimit të OE “R.....U” & “SH....I” & “V.....N” oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej vlera 206,313,149 lekë **pa TVSH**.

Formulari i njoftim fituesit datë 26.4.2021, shpallur në Buletin e SPP nr. 66, datë 4.5.2021

Midis bashkimit të OE “R.....U” & “SH....I” & “V.....N” Shpk dhe Bashkia Dropull, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 760, datë 6.5.2021 për “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme

të ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanistër, Haskov, Dhujan, Frashtan, Lungar dhe Grapsh, Bashkia Dropull” me vlerën 206,313,149 lekë pa TVSh. me afat punimesh 18 muaj.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i OE “R....A”, “T.....U” & “SH....I” & “V.....N” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se shoqëria nuk plotëson disa nga kriteret e DST të miratuar nga AK, konkretisht:

- OE “SH.I” shpk (B) ndërkohë kërkohet kategoria N.P – 12/D (Punime të Inxhinierisë së Mjedisit).

- Nga shoqëria “R. U” shpk, nuk janë depozituar çertifikatat ISO 14000/2015; OHSAS 18001/2007; PAS 99-2012 dhe ISO 39001/2012, ku sipas kërkesave të DST thuhet se nëse kemi bashkim OE çdo njëri nga OE duhet ti paraqesë ato.

- Nga shoqëria “R. U shpk nuk është plotësuar kriteri për linecës e shoqërisë, pasi liçensa e kësaj shoqëria nuk ka kategorinë e punimeve NP-1/B, NP-5/B, NP-7/D, NP-12/D, NS-8/A, NS-9/A, NA-16/A dhe NS-18/A.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i bashkimit të OE “R. U” & “SH. I” & “V.N”, nuk është në kushtet e plotësimin të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si më lart, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, , të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e KVO i përbërë: znj. TH.P me detyrë Drejtor Finance, G.M me detyrë Specialist tek ND. Ujësja Dropull dhe z. L.K me detyrë specialist në Drejtorinë e PZHT.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshtit në fazën e Projektraport Auditimit)

4- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellës Dirvican, Sofratik dhe Terihat Bashkia Dropull”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellës Dirvican, Sofratik dhe Terihat Bashkia Dropull.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 332, datë 19.2.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 332, datë 19.2.2021	4. Komisioni VO nr. 332/1, datë 19.2.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”,	M.Q A.T S.E	TH.P G.M L.K
5. Fondi Limit (pa TVSh) 120,286,360 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “K....N” ShPK me vlerën e ofertës 119,025,532 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 99.1 %.
8. Data e hapjes së tenderit 16.4.2021 REF -89561-03-10-2021	9. Burimi Financimit Buxheti shtetit.	10. Operatorë Ekonomike 4: a- Skualifikuar 3 OE b- Kualifikuar 1 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
13. Lidhja e kontratës Nr. 793, datë 11.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 119,025,532 lekë me afat 6 muaj	

Me shkresën nr. 213, datë 28.01.2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Agjensia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime) është miratuar fondi në vlerën 144,343,632 lekë për buxhetin e vitit 2021-2024, me financim për 2021- 2022-2023.

Me shkresën nr. 334/2, datë 5.3.2021 është dërguar oponenta teknike nga Instituti i Ndërtimit. Leje infrastrukture nr. 1010, datë 14.6.2021, me afat kohorë deri me datë 14.12.2021

Me urdhër nr. 332/2, datë 19.2.2021 të titullarit të AK z. DH.T është ngarkuar z. A.T për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim.

- **Vlerësimi i kritereve:**

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 22.02.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 322, datë 19.2.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 16.4.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Në aplikimin e kritereve me gjithë ndërhyrjet e APP dhe ndryshimet të bërë nga AK, janë konstatuar kritere **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 dhe neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, konkretisht:

Pika 3.2 e DST, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Licencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jenë:

Punime të përgjithshme ndërtimi

N.P – 7 D Ujësjetësi, gazsjellësa, vajsjetësa, vepra kullimi e vaditje

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me kritere specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe natyrën e objektit të prokurimit. Kërkohet licenca, ndërkohë që referuar dokumenteve teknike të tenderit nuk rezultojnë të përfshihen punime për të cilat do të nevojitej kjo licencë dhe në përputhje me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, pasi:

Në të gjitha rastet, për secilën licencë të kërkuar, është limituar në argumentimin se “licencat kërkohen duke pasur parasysh preventivin e punimeve”, por në asnjë rast nuk është specifikuar konkretisht se për cilat zëra të preventivit është e domosdoshme një licencë e kërkuar.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: M.Q me detyrë Juriste Drejtoria e Buxhet financës, z. A.T me detyrë Drejtor PZHT dhe z. S.E me detyrë specialist (ing. Elektrik)Drejtoria e Shërbimit Urban.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

- **Zhvillimi procedurës.**

Me urdhrin e prokurimit nr. 332, datë 19.2.2021 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 120,286,360 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 322/1, datë 19.2.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 16.4.2021.

Nga OE pjesmarrjes dhe APP nuk ka pasur ankesa për DST. Nuk ka pasur ankesa nga OE.

Me datë 16.4.2021 ora 10.00 në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”.

Pas përfundimit të dorëzimit të ofertave, anëtarët e KVO në mënyrë të pavarur kanë bërë vlerësimin.

Konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

- 1- Shoqëria “K.N” shpk me ofertë 119,025,532 lekë.
- 2- Shoqëria “A.S” shpk me ofertë 96,352,152 lekë.
- 3- Shoqëria “E.T” shpk me ofertë 119,552,909 lekë

Në përfundimi të vlerësimit të dokumentacionit, KVO nga 3 OE ka kualifikuar 1 OE.

Janë skualifikuar shoqëritë:

1- Shoqëria “A.S” shpk me ofertë 96,352,152 lekë, pasi:

- Nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme për një objekt të vetëm jo më pak se 50%. Kontrata 5.12.2016 me vlerë kontratë 186,901,165 lekë ka përfunduar me datë 28.2.2018. kontrata shtesë me vlerë 37,328,467 lekë nuk plotëson kushtin e 50%. **Ky konstatim nuk qëndron pasi kontrata merret në total dhe jo e ndarë. Pra është brend afatit 3 vjeçar.**

- Vërtetimi FSHU nuk është hedhur në sistem lista e kontratave, bashkëlidhur vërtetimit..

- Referuar pikës 5 trecher për gjermim dhe hapje kanali, mjeti sipas specifikimeve teknike duhet të jetë min 20 ton nga ana subjekti është paraqitur fletë dalje me nr. Seri 01704, nr. 24, datë 16.7.2004 me përshkrimin 1. Motor kompresor 15 m copë një me vlerë 288,000 lekë. 2. Turbo presioni 1000 ml me vlerë 500 lekë. Kontratë qiraje nr. 1705prot/503kol, datë 15.4.2021 e shoqëruar me fletëdalje i cili nuk është dokument ligjorë që nuk vërteton pronësisë e pajisjes, ku nga AK është kërkuar mjet gjermimi për hapje kanali dhe jo motor kompresor dhe tubo presioni. Pra nuk është paraqitur mjeti trecher për gjermim dhe hapje kanali, mjeti sipas specifikimeve teknike duhet të jetë min 20 ton.

Për mjetin trencher me vakum për punime specifike është paraqitur kontratë qiraje mjeti tip BobCat me targë ADTMT48 i cili kalon funksionet për mjetin trencher për hapje kanali të tubacionit me aksesori përkatës të paraqitur në foto, por jo për kalim nëntokësorë të tubacionit në disa segmente të caktuara sipas specifikimeve teknike.

- Nuk është plotësuar kërkesa për rul me kompresor. Referuar zërit të punimit shtresë asfalti me ngjyra t=3cm, me makineri nr. 7 tek punimet në rrugë të përfshira në preventiv. Nga subjekti janë paraqitur dy rullua cilindër gomë për punime përkatëse të përfshira në preventivin :Shtresë stabilizanti t=10.

- Mungon certifikata PAS 99:2012.

Nga vetë shoqëria me shkresën nr. 700, datë 22.4.2021 është paraqitur kërkesë për tërheqja nga gara.

2- Shoqëria “E.T” shpk me ofertë 119,552,909 lekë, pasi nuk ka dorëzuar dokumentacionin sipas kërkesave të DST, duke mos plotësuar pjesën më të madhe të kërkesave.

Në përfundim KVO ka vlerësuar si fitues shoqërinë “K. N” shpk me ofertë 119,025,532 lekë, pasi plotësin të gjitha kriteret e DST, sipas KVO.

Vlerësimi është mbyllur me datë 26.4.2021 dhe nuk ka ankesa.

Me vendim nr. Sk.a datë 4.5.2021 titullari i AK ka shpallur fitues shoqërinë “K. N” shpk me ofertë 119,025,532 lekë.

Me shtojcën nr.13 datë 4.5.2021 është plotësuar njoftim fituesi, shpallur në buletin nr. 70, datë 10.5.2021

Midis shoqërisë “K. N” Shpk dhe Bashkia Dropull, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 793, datë 11.5.2021 për “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellës Dirvican, Sofratik dhe Terihat Bashkia Dropull” me vlerën 119,025,532 lekë pa TVSh. me afat punimesh 6 muaj.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i OE “K. N” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE dhe kundërshtive të subjekti me shkresën nr. 926/14, datë 03/07/2023, rezulton se shoqëria plotëson kriteret e DST të miratuar nga AK dhe vlerësimi i bërë nga KVO është i saktë.

3- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Bularat + kopshti Bularat, Dropulli sipërm”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Bularat + kopshti Bularat, Dropulli sipërm.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1484, datë 8.9.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 1484, datë 8.9.2022	4. Komisioni VO nr. 1484/1, datë 8.9.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”,	M.Q A.T G.M	A.M L.K TH.P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 58,648,181 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “GJ....A” ShPK me vlerën e ofertës 13,214,220 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 98.9 %.
8. Data e hapjes së tenderit 11.11.2022 REF -44934-10-10-2022	9. Burimi Financimit Buxheti Shtetit.	10. Operatorë Ekonomike 2: a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 1 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
13. Lidhja e kontratës Nr. 2072, datë 9.12.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 13,214,220 lekë me afat 6 muaj	

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se nga AK Bashkia Dropull nuk është hartuar oponenca teknike në zbatim të nenit 6¹⁰ të ligjit nr. 120/2020, datë 7.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, **duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK z. DH.T.**

- Vlerësimi i kriterëve:

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 6.10.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 1484, datë 8.9.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 11.11.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Në aplikimin e kriterëve me gjithë ndërhyrjet e APP dhe ndryshimet të bërë nga AK, janë konstatuar kriteret **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të cilat në mënyrë

¹⁰ Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik. 2. Për çdo rast, institutet shtetërore ose entet e tjera, që kryejnë oponencën teknike, janë solidarisht përgjegjëse me projektuesin për çdo dëm që rrjedh si pasojë e gabimeve ose të metave të oponencës teknike, si dhe mbajnë përgjegjësi administrative ose penale, sipas rastit, për shkëlqjen e legjislacionit në fuqi. Rregullat për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, konkretisht:

Pika 2.3.3.(f) e DST. *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:*

*-Operatori ekonomik te këtë **Liçensë per Mbrojtjen nga Zjarri** te lëshuar nga QKL. Kodi 1.2.A. si dhe te këtë ne stafin e tij min 1 (nje) **specialist Ekspert Zjarrfikës** ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpëtimin, ne mbështetje te pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Per shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpëtimin", te figurojnë ne listëpagesat e shoqërisë. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria e MZSH dhe i pajisur me Liçensë per Mbrojtjen nga Zjarri te lëshuar nga QKL. Kodi 1.2.A.*

Kërkesa e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e një ekspert zjarrfikës, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Pika 2.3.4/d. e DST. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçensë per ushtrimin individual te profesionit, diplomë.*

Nga sa më sipër rezulton se, në Vendimin nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011", të KM "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, germa "b" dhe pika 4 germa "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i KM, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", **shfuqizohet**. Në çdo rast, njësia e prokurimit në vendosjen e këtij kriteri duhet të merrte parasysh faktin se në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 ndër të tjera përcaktohet se: "shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim".

Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar. Gjithashtu punësimi i mjekut në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muaj, rezulton të jetë një kriter i pa-argumentuar i cili sjell ngushtime të mëtejshme të konkurrencës, duke favorizuar operatorë të caktuar që kanë mjek në listpagesës.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: M.Q me detyrë Juriste Drejtoria e Buxhet financës, z. A.T me detyrë Drejtor PZHT dhe z. G.M me detyrë specialist (ing. Elektrik)Drejtoria e Shërbimit Urban.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

- Zhvillimi procedurës.

Me urdhrin e prokurimit nr. ---, datë 8.9.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 58,648,181 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "E hapur" ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 1484/1, datë 8.9.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 11.11.2022.

Me datë 11.11.2022 ora 10.00 në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike".

Pas përfundimit të dorëzimit të ofertave, anëtarët e KVO në mënyrë të pavarur kanë bërë vlerësimin.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. Bashkimi i OE 2. T + “B.N” shpk me ofertë **49,211,603 lekë pa TVSH.**

2. Shoqëria “GJ. A” shpk me ofertë **53,945,123 lekë pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE : 2....T dhe “B.N” shpk, pasi”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit kualifikues për Bashkimin e Operatorëve Ekonomik 2.....T shpk & B..N shpk, ne mbështetje te nenit 92, pika 3 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, per “Prokurimin Publik”, ne baze te nenit 82, te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe Dokumenteve Standarte te tenderit, Kritereteve te veçanta per kualifikim; Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se:

BOE 2.....T shpk & B. N shpk, nuk plotësojnë piken 2.3.3 (c)te kapacitetit teknik, te Kritereteve te Veçanta te Kualifikimit, te Dokumenteve Standarte te Tenderit,Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, personelin kryesor dhe punonjësit specialistë të kualifikuar, të vërtetuar me dëshmi kualifikimi profesionale, certifikata ose diploma ose çertifikata të shkollës profesionale përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licënsuar nga organet përkatëse kontrate pune individuale, jo më pak si më poshtë:

Teknik Ndërtimi 1 (një); Inxhinier Gjeoteknik 1 (një); Inxhinier Elektrik 1 (një); - Hidraulikë 2 (dy);

- Elektracistë 4 (katër); - Hekurkthyes 2 (dy); - Saldator 1 (një); - Murator 2 (dy); - Bojaxhinj 2 (dy);

- Hidroizoluese 1 (një); - Shtrues pllakash 3 (tre); - Specialist per punime ne lartësi 4 (katër).

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Sipas Kontratës së Bashkëpunimit datë 09.11.2022, OE “B.N” shpk, pjesëmarrës i BOE, deklaron se do të realizojë 40 % . Nga verifikimi që KVO i bëri preventivit të punimeve për zërat e punimeve që do realizojë OE “B. N”, rezulton se ka marrë përsipër të realizojë të gjitha zërat e punimeve që kanë të bëjnë me punimet elektrike të kontratës objekt prokurimi.

Referuar formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, operatori ekonomik ka deklaruar vetëm një punonjës elektrikist, konkretisht z. B.P.

Në mbështetje të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 88, pika 3, OE në bazë të natyrës të punimeve të marra përsipër në preventivin e punimeve duhet të dispononte 4 elektrikistë për realizimin e punimeve.

*Edhe nëse do ti referohemi përqindjes të ndarë në kontratën e bashkëpunimit OE duhet të dispononte **2 punonjës elektrikistë** për realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

Sipas KVO pas vlerësimit të dokumentacionit, konkludon se shoqëria “GJ.A” shpk me ofertë prej **53,945,123 lekë pa TVSH** më të lartë se BOE është vlerësuar si fitues.

Ankesa: nuk ka

Me shkresën datë 5.12.2022 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i miratuar nga titullari i AK. Me datë 23.11.2022 është bërë mbyllja e procedurës. Me datë 5.12.2022 titullari i AK ka marrë vendim për shpallje fitues shoqëria “GJ. A” shpk me ofertë prej **53,945,123 lekë pa TVSH.**

Formulari i njoftim fituesit datë 5.12.2022, shpallur në Buletin e SPP nr. 164, datë 30.11.2022 Midis shoqëria “GJ....A” shpk dhe Bashkia Dropull, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 2072, datë 9.12.2022 për “Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Bularat + kopshti Bularat, Dropulli sipërm” me vlerën **53,945,123 lekë pa TVSh.** me afat punimesh 18 muaj.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit kualifikues të shoqërisë “GJ. A” shpk, ne mbështetje te nenit 92, pika 3 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, nenit 82, te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Dokumenteve Standarte te tenderit, Kritereteve te veçanta per kualifikim, konstatohet se kjo shoqëri nuk plotëson piken 2.3.3 (c)te kapacitetit teknik, te Kritereteve te Veçanta te Kualifikimit, te Dokumenteve Standarte te Tenderit,Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të

figurojnë në listëpagesat e subjektit, personelin kryesor dhe punonjësit specialistë të kualifikuar, të vërtetuar me dëshmi kualifikimi profesionale, certifikata ose diploma ose certifikata të shkollës profesionale përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licencuar nga organet përkatëse kontrate pune individuale, më poshtë:

1- **Z. D.M.**, i punësuar pranë shoqërisë në rolin e specialistit për punime në lartësi, me certifikatë “Trajtim për punime në lartësi” lëshuar nga HSEM, e pajisur me Nr. Liçensë LC-8617-02-2017, nuk rezultoi i regjistruar në listëpagesat e muajt Prill, Maj dhe Qershor 2022.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

- Procedurat me vlerë të vogël periudha 2021 – 2022.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Ekonomike për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (**nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2021**), u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor (*Bashkia Dropull*) në cilësinë njësi shpenzuese publike vendore në raste ka kryer shpenzime me fonde publike me objekt për; (*blerje mall, punë dhe shërbime publike*), blerje e vogël si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi periudha raportuese (*nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2021*), AK ka realizuar gjithësej 29 procedura me vlerë fondi limit për 19,070 mijë lekë dhe vlerë kontrate 8,657 mijë lekë, me një diferencë nga fondi limit për vlerën 10,412 mijë lekë ose 54 %, sipas pasqyrës Aneks 2.4.2, *bashkëlidhur Projektraport Auditimit*.

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë kryer shpenzime me fonde publike me objekt për; (*blerje mall, punë dhe shërbime publike*), gjithësej 24 procedura blerje me vlerë të vogël me fond limit prej 13,006 mijë lekë dhe vlerë kontrate 9,368 mijë lekë, me një diferencë në shumën 3,637 mijë lekë ose 28%, *sipas aneksit 27.9 bashkëlidhur Projektraport Auditimit*.

Grupi i KLSH në zbatim të materialitetit, vlerësojë për auditim 10 procedura me fond limit 3,692 mijë lekë ose 11.51% e fondit të prokuruar për vitet 2021 – 2022.

Konkluzione: Vlera e fondit të prokuruar sipas urdhër prokurimit nuk ka qenë mbi 1,000,000 lekë pa TVSh, pra mbi kufirin monetar, ndërsa kërkesa për prokurim në të gjitha rastet është miratuar nga Njësia e Autorizuar i AK, si është përcaktuar në ligj.

-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezultoi se në **4 raste** për procedurat e vitit 2021, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor „Bashkia Dropull, zj. TH.P si anëtar e Njesisë së Prokurimit dhe hartimit të specifikimeve teknike, llogaritjes së fondit limit dhe hartimit të Dokumenteve të Tenderit.

Zj. TH.P është me pozicion pune Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, është njëkohësisht dhe anëtar i Grupit të Menaxhimit Strategjik të institucionit. Vendosja e zj. TH.P me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatuesi i Bashkia Dropull, si anëtar i Njesisë së Prokurimit, është jo në përputhje me kuadrin ligjor, konkretisht të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.

Nënpika 2.4.4 Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Nga grupi i auditimit referuar materialitetit, u vlerësua për t’u audituar kontrata për punë publike sipas pasqyrës tabela nr. 1, me vlerë konkrete **695,805,419.16 lekë pa TVSH ose 834,966,503 lekë me TVSH**, me objekt “Mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet

publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimi, zbatimi i afateve të kontratave si dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera”.

Tabela nr. 1. Kontrata zbatimi të audituara

Nr	Objekti	Kontraktori Sipërmarrës	Vlera e kontratës me TVSH
Viti 2020			
1	Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Dervičan, Bashkia Dropull.	BOE “E.....I & B.....S” SHPK	92,783,599
2	Ujësllësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësllësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II	JV “B.....S” & “2-T” & “V....A” SHPK	393,039,116
Viti 2021			
1	Sistemim-asfaltim i rrugëve “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësllësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull	BOE “R.....A T.....U” & “SH...I” & “V.....E” SHPK	206,313,149
2	Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësllësit Dervičan, Sofratik dhe Terihat	OE “K....N” SHPK	142,830,639
Shuma në lekë me TVSH			834,966,503

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, në vijim po trajtojmë problematikat e konstatuara si vijon:

1. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësllësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”, me këto të dhëna.

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësllësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull, Dropull”.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 760 prot., datë 06.05.2021 BOE “R.....A T.....U” SHPK & “SH...I” SHPK & “V.....E” SHPK	15. Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 247,136,960 lekë me TVSH	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 28,040,225 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 2,190,967,35 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 219096735 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 04.06.2021 Përfundimi punimeve: 02.12.2022	19. Zgjatja e kontratës S’ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “Z.....T” & “Z.....O” SHPK	Licenca MK.2.../5	Kontratë me nr. 920 prot., datë 03.06.2021
21. Kolaudatori i punimeve OE “H.....I1” SHPK	Licenca Nr: MK...../23	Kontratë nr. 2075/1 prot, datë 12.12.2022
22. Akt Kolaudimi Datë: 27.12.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 27.12.2022.	

Titulli i Gjetjes 1: *Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësllësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”.*

Situata:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultu+an punime të pa kryera në volumet e situacionuara në gërmime për zërat: “Zëri 1(3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m2”, “Zëri 3(2.47/An) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **185,561.4 lekë** pa TVSH.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. L.H., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 760 prot., datë 06.05.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 920 prot., datë 03.06.2021.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Dropull.

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: I lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **185,561.4 lekë pa TVSH** nga JV “R.....U” & “SH...I” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”.

2. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” Bashkia Dropull, me këto të dhëna.

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” Bashkia Dropull.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 793 prot., datë 11.05.2021 OE “K.....N” SHPK	15. Vlera e kontratës - 142,830,639 lekë me TVSh.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 28,868,726 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 20,000,000 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 63,509,594 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 6,647,212.50 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 14.06.2021 Përfundimi punimeve: 14.12.2022	19. Zgjatja e kontratës -14.04.2022, sipas amendimit me nr. 2251 prot., datë 14.12.2021. -14.12.2022, sipas amendimit me nr. 681/2 prot., datë 15.04.2022
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “G.....G” SHPK	Licenca MK...../1	Kontratë me nr. 953 prot, datë 07.06.2021
21. Kolaudatori i punimeve OE”H.....11” shpk	Licenca Nr: MK...../23	Kontratë nr. 1631 prot., datë 28.09.2022
22. Akt Kolaudimi Datë: 21.12.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë ---. Nga Kryetari i Bashkisë Dropull nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Veprim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 793 prot, datë 11.05.2021.	

Titulli i Gjetjes 1: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” Bashkia Dropull.

Situata:

1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara në gërmime për zërat: “Zëri 1(3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²”, “Zëri 3(2.47/An) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir”, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **313,500 lekë** pa TVSH.

2. Objekti: “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” nga Kryetari i Bashkisë Dropull nuk është marrë në dorëzim për shkak të mos plotësimit të rekomandimeve të lëna nga grupi i marrjes në dorëzim, për arsyet:

-Mos vendosje reduktor presioni, për: rezervuarin 200 m³ nr. 1 (Nga ana e Goraxisë) dhe rrjetin shpërndarës; për dhomën e komandimit rezervuari nr. 2 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rezervuarin 200 m³ nr. 3 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rrjetin shpërndarës fshati Sofratikë sipas projektit të zbatimit, si dhe për mos zbatimin e disa zërave të përcaktuar në proces verbalin e datës 29.03.2023 hartuar nga grupi i punës pranë Njësinë Administrative të Dropullit të Poshtëm në Bashkisë Dropull.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.H.T, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë; Z. G.B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve dhe Z. F.B, në cilësinë e Kolaudatorit të punimeve.

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3, i ndryshuar.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 793 prot., datë 11.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 953 prot, datë 07.06.2021.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Dropull.

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe sipas projektit të zbatimit.

Rëndësia: I lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **313,500 lekë pa TVSH** nga OE “K.N” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 793 prot., datë 11.05.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” Bashkia Dropull.

Për këtë rekomandojmë:

Bashkia Dropull në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e punimeve dhe Kolaudatorin e punimeve, të marrin masa për marrjen në dorëzim të parakohshëm të investimit me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat”, pasi të plotësohen nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “K.N” SHPK rekomandimet e lëna nga grupi i marrjes në dorëzim sipas proces verbalit të datës 29.03.2023 hartuar nga grupi i punës në Njësinë Administrative të Dropullit të Poshtëm në Bashkisë Dropull.

Gjithashtu të merren masa të menjëhershme për vendosjen e reduktorëve të presionit, për: rezervuarin 200 m³ nr.1 (Nga ana e Goraxisë) dhe rrjetin shpërndarës; për dhomën e komandimit rezervuari nr. 2 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rezervuarin 200 m³ nr. 3 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rrjetin shpërndarës fshati Sofratikë sipas projektit të zbatimit.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

2. **Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt:** “Rikonstruksion i rrjetit të “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Derviçan, Bashkia Dropull”, me këto të dhëna.

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Dervičan, Bashkia Dropull”.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1502 prot., datë 19.08.2020 BOE “B.....S & E....P” SHPK	15. Vlera e kontratës - 79,129,675 lekë pa TVSh.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 28,868,726 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 72,385,425 lekë me TVSH
17. Situacioni Përfundimtar -20,398,174 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 14.10.2020 Rifillimi i punimeve: 01.03.2021 Përfundimi punimeve: 12.11.2021	19. Zgjatja e kontratës -afati i shtyrjes 5 muaj sipas amendimit me nr. 777/1 prot., datë 11.05.2021. sipas nenit 6, afati nga 7 muaj bëhet 13 muaj.
20. Mbikëqyrësi i punimeve JV “E...G” SHPK & “Z....T” SHPK	Licenca MK..../12 dhe MK: 3360/2	Kontratë me nr. 1914 prot, datë 14.10.2020
21. Kolaudatori i punimeve OE “H...Y” shpk	Licenca Nr: MK..../1	Kontratë nr. 694 prot., datë 20.04.2022
22. Akt Kolaudimi Datë: 04.05.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 05.05.2022 Gripi i marrjes në dorëzim përbëhet nga: Teleman Qirko, G.M dhe A.T.	

Titulli i Gjetjes 1: *Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Dervičan, Bashkia Dropull”.*

Situata:

-Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2020 nga shoqëria JV: “Z....O & Z....T” SHPK me Nr. License N..../1 dhe Nr. License; N..../16; me përbërje të grupit të punës: (I.H. M.M, Inxh. Elek. P.P, Ark. R.M, Inxh. Ndert. R.T, Inxh. Gjeodet. B.S, Inxh. Gjeo. Y/M, Inxh. Mek. A.P, Inxh. Ndert. L.H, Inxh. Gjeodet. L.V, Inxh. Ndërt. F.D).

Për projektin e zbatimit: “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Dervičan, Bashkia Dropull” Bashkia Dropull” nga Titullari i Bashkisë Dropull është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore me Nr. 1502/1 prot, datë 14.08.2020.

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve: “Zëri 1(3.87/a) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shk. në tokë” dhe, “Zëri 2(47/an) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Shtetit, në vlerën **260,786 lekë** pa TVSH.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. G.I, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3, i ndryshuar.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1502 prot., datë 19.08.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1914 prot, datë 14.10.2020.

Ndikimi/Efekt: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Dropull.

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe sipas projektit të zbatimit.

Rëndësia: I lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **260,786 lekë pa TVSH** nga BOE “E....I” SHPK & “B.....S” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1502 prot., datë 19.08.2020, me objekt “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Dervican, Bashkia Dropull”.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

4. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Ujësjetësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjetësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II” Bashkia Dropull, me këto të dhëna.

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ujësjetësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjetësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II” Bashkia Dropull.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 962 prot., datë 04.06.2020 JV "B.....S" & "2-T" & "V....A" SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 393,039,116 lekë me TVSH. VI nga rishikimi i preventivit 393,039,010 lekë me TVSH	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 24,925,807 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 38,960,045 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 15,449,074 lekë me TVSH Sit. 4 në vlerën 20,214,627 lekë me TVSH Sit. 5 në vlerën 52,837,146 lekë me TVSH Sit. 6 në vlerën 21,387,932 lekë me TVSH Sit. 7 në vlerën 104,172,136 lekë me TVSH Sit. 8 në vlerën 63,343,255 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 393,039,010 lekë me TVSH.	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 04.06.2020 Përfundimi punimeve: 03.06.2022	19. Zgjatja e kontratës -afati i shtyrjes 12 muaj sipas amendimit me nr. 797/2 prot., datë 17.05.2021, sipas nenit 6, afati nga 12 muaj bëhet 24 muaj.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “Z....O” SHPK	Licenca MK.,.,/3	Kontratë me nr. 934 prot, datë 02.06.2020
21. Kolaudatori i punimeve OE “E.....G” shpk	Licenca Nr: MK.,.,/7	Kontratë nr. 934 prot., datë 05.12.2022
22.Akt Kolaudimi Datë: 09.12.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 06.01.2023. Gripi i marrjes në dorëzim përbëhet nga: G.M, A.Tj dhe T.T.	

Titulli i Gjetjes 1: *Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin “Ujësjetësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjetësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II” Bashkia Dropull.*

Situata:

-Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2019 nga shoqëria "Z....O" SHPK me Nr. License N.,.,/16. Grupi i projektimit përbëhet nga: (Inxh. Elek. S.P, Ark. R.M, Inxh. Gjeodet. B.S, Inxh. Gjeol. Y.M, Inxh. Hidro. G.SH, Inxh. Mek. A.P, Inxh. Ndert. L.H, I.GJ. L.V).

-Për projektin e zbatimit për objektin “Ujësjetësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjetësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II” nga Titullari i Bashkisë Dropull është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore me Nr. 962/1 prot, datë 04.06.2020.

-Për projektin e zbatimit të objektit: “Ujësjetësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjetësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II” është kryer oponentë teknike nga Instituti i Ndërtimit.

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara në gërmime për zërin “Zëri 1(3.124/1a) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zingjir”, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **179,190 lekë** pa TVSH.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A.P, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3, i ndryshuar.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 962 prot., datë 04.06.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 934 prot, datë 02.06.2020.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Dropull.

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe sipas projektit të zbatimit.

Rëndësia: I lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **179,190 lekë pa TVSH** nga JV "B.S" & "2-T" & "V.A" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 962 prot., datë 04.06.2020, me objekt “Ujësjiellësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjiellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II”.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

Pika 2.5 e programit. Mbi zbatimin e procedurave të lejeve të ndërtimit dh zhvillimit.

Bashkia Dropull ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.2, datë 10.02.2021.

Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën 01.01.2021- 31.12.2022

Lejet ndërtimi 2021-2022				
Envidetimi i Lejes	Date	Nr Prot.	Taksat e lejes	Preventiv
Shtese fabrike prodhim kartonash Konstruksion Metalik	3/2/2021	272	74.452,00	3.197.621,00
Rikonstruksion Pa ndryshim funksioni Banese 2 katesh	1/3/2021	422	82.317,00	1.205.483,00
Shtese Anesore per Banese	28/04/2021	750	47.224,00	1.626.411,77
Rrethim Prone	9/5/2021	769	8.384,00	119.177,00
Shtese Objekti Depo Uji, Dhome e Trajtimit te Ujit per Lujen Aseptike	16/06/2021	1047	351.358,00	16.092.304,00
Shtese kati banese	27/06/2021	1090	81.075,00	3.753.735,00
Rrethim Prone	26/07/2021	1331	14.172,00	408.587,00
Magazine Bujqesore konstruksion metalik	29/07/2021	1358	85.211,00	3.735.560,00
Rrethim Prone	25/08/2021	1532	58.964	2.048.198,40
Magazine prodhime bujqesore Konstruksion metalik	4/9/2021	1589	217.656,00	10.107.789,00
Fabrike Prodhim Konstruksion metalik	8/9/2021	1646	1.871.282,00	92.664104,00
Magazine per prodhim, perpunim letrë Konstruksion metalik	15/09/2021	1649	161.565,00	7.553.272,00
Rrethim Prone	8/11/2021	1998	12.435,00	321.724,00
Rrethim Prone	27/12/2021	2348	52.144,00	2.082.178,00
Shtese Magazine e Lendeve te Para konstruksion metalik	28/12/2021	2347	1.757.216,00	86.960.817,00
Shtese Magazine per prodhim, perpunim letrë Konstruksion metalik	19/01/2022	116	35.648,00	1.257.418,00
Shtese Magazine e Lendeve te Para konstruksion metalik	15/02/2022	319	726.491,00	23.616.364,00
Rrethim Prone	24/03/2022	555	173.956,00	5.198.538,00
Rrethim Prone	30/03/2022	566	42.721,00	1.074.031,00
Shtese Kati Banese 2 katesh	15/04/2022	684	30.134,00	5.898.149,00
Dhoma Zhveshesh konstruksion metalik	26/04/2022	720	521.880,00	16.795.986,00
Rrethim Prone	5/6/2022	1051	24.409,00	695.434,00
Rrethim Prone	30/08/2022	1433	9.435,00	343.508,60
Rrethim Prone	2/10/2022	1672	7.639,00	163.860,00

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Dropull, gjatë periudhës 01.01.2021 - 31.12.2022, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje			
Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i miratimeve
1	Certifikatë përdorimi	0	0
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	9	3
3	Leje infrastrukture	3	3
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	3	2
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	0	0
6	Leje për ndryshim funksioni	0	0
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	1	1
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	0	0
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	1	1
10	Leje rindërtimi, rikonstruksion dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	0	0
11	Leje zhvillimi	5	0
12	Njoftim për fillim punimesh	5	5
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	1	1
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m ²	1	0
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	3	2
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	0	0
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	0	0



Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Dropull, rezulton se janë miratuar **leje ndërtimi**, ndër të cilat:

- 1- Leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **2 leje** ndërtimi.
- 2- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.
- 3- Leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.
- 4- Leje për shtesë në ndërtimin ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.
- 5- Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni janë miratuar **0 leje**.
- 6- Leje ndërtimi për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit janë miratuar **1 leje**.
- 7- Leje për ndryshim funksioni dhe leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni, janë miratuar **0 leje**.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit dhe dhënia e certifikatave të përdorimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m²:

Nr.	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit / Lekë
1.	Leje ndërtimi me sipërfaqe 63.2 m ²	“Shtese Anësore Banese Adresa e realizimit të punimeve”	TH.N	750/ 28.4.2021	1,626,411.77
2.	Leje ndërtimi me sipërfaqe 100 m ²	“Shtese kati mbi objekt ekzistues - Jorgucat t”	R.V	1090/27.6.2021	3,753,735

Titulli gjetjes 1. Miratim i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit të miratuar me vendim Nr. 750, datë 28/4/2021, të Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin “Shtese Anësore Banese Adresa e realizimit të punimeve”.

Situata:

Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe 63.2 m²”, për të cilën është marrë vendimi Nr.750, datë 28/4/2021, i Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin “Shtese Anësore Banese Adresa e realizimit të punimeve”, me zhvillues **TH.N**, u konstatua si më poshtë:

- Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se planvendosjen e miratuar nuk është e saktë pasi nuk ka të detajuara të gjitha elementët e nevojshëm si, distancat e objektit që do ndërtohet nga objektet rreth tij, si dhe numrat e kateve në kundërshtim kjo me Kushtet Teknike të Projektimit KTP.

- Preventivi i llogaritur nga projektuesi nuk është llogaritur bazuar në çmimet e referencës për koston e ndërtimit sipas zonave përkatëse. Për ndërtime të caktuara sipas kategorive të tyre

preventivi nuk mund të jetë më i ulët se kostoja e ndërtimit çmimi i të cilës është caktuar nga Enti Kombëtar i Banesave EKB. Kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m².

- Planvendosjen e miratuar nga ana e DPZHKT bashkia Dropull nuk është respektuar distanca e objektit që do ndërtohet me kufirin e pronës, në kundërshti me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 35 Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m ($d = nr. k + 1m$) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.

- Nuk është marrë mendim nga institucionet (Agjensia e Zhvillimit të territorit ASHK, UK, ASHK) për lejet, në kundërshtim kjo me Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori, Neni 15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.

Kriteri:

Në kundërshtim me çmimet e Enti Kombëtar i Banesave (EKB), *kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m²; VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, respektivisht nenet:*

Neni 35 *Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m ($d = nr. k + 1m$) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve*

Neni 15 pika (ë) *Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.*

Ndikimi/Efekti:

Mos respektimi i distancave të lejuara nga kufiri i pronës sjell kequrbanizim të zonave si dhe cënon të drejtat e pronarit kufitar.

Mosmarrjen e mendimeve pozitive nga institucionet e tjera të përfshira ndikon negativisht në zhvillimin e zonës pasi leja e miratuar pa aprovimin e këtyre institucioneve mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin e tyre.

Llogaritja fiktive e preventivit mund të ndikojë në keqlllogaritjes të taksës në infrastrukturë

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dropull

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Dropull, të marrë masa për:

- Të mos pranuar preventiv fiktiv nga ana e projektuesit duke kontrolluar zërat e punës dhe llogaritur preventivin jo më pak se kostoja e ndërtimit
- Të respektuar distancat e lejuara nga kufiri i pronës.
- Të miratuar leje ndërtimi me mendimet pozitive të aprovuara nga institucionet e nevojshme për të dhënë këtë mendim.

Titulli gjetjes 2. *Miratim i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit të miratuar me vendim Nr. 1090, datë 27/6/2021, të Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin: ” Shtese kati mbi objekt ekzistues - Jorgucat – Gjirokastër”, me zhvillues R.V, në Dropull.*

Situata:

Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe 100 m²”, për të cilën është marrë vendimi Nr.1090, datë 27/6/2021, i Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin “Shtese kati mbi objekt ekzistues - Jorgucat – Gjirokastër”, me zhvillues **R.V**, u konstatua si më poshtë:

-Planvendosjen e miratuar nuk është e saktë pasi nuk ka të detajuara të gjitha elementët e nevojshëm si distancat e objektit që do ndërtohet nga objektet rreth tij si dhe numrat e kateve në kundërshtim kjo me Kushtet Teknike të Projektimit KTP.

- Miratuar leje ndërtimi për shtesë kati në objektin ekzistues 2 kate. Objekti në fjalë nuk është i gjithi në pronësi të personit që është miratuar leja e ndërtimit por janë pronarë familje të ndryshme. Leja e miratuar nga ana e DPZHKT bashkia Dropull është dhënë mbi tarracën e personit që ka aplikuar ndërkohë tarraca hynë tek objektet e përbashkëta referuar ligjit nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta” Neni 5 Objekte në pronësi të përbashkët

1. Objekte në pronësi të përbashkët janë të gjitha pjesët e një prone në bashkëpronësi, përveç njësisë. Prona e përbashkët është e pandashme dhe është në pronësinë e përbashkët të pronarëve të njërive individuale, në përputhje me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi. Prona e përbashkët përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, territorin, pajisjet, mjedisin dhe objektet në shërbim të saj, që nuk janë destinuar për përdorim individual dhe nuk janë pronë publike, si truallin, mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, parkimet, pishinat, gjelbërimin, themelet, muret mbajtëse, çatinë, tarracën, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, puset, pusetat, depozitat e ujit dhe kaldajat.

2. Prona e përbashkët përfshin, gjithashtu, pjesë të ndërtesës për përdorim të përbashkët, të cilat janë vendosur gjatë ndërtimit ose më vonë, si kanalizime, kolona shkarkimi, oxhakë, sisteme elektrike, hidraulike, gazi ose ngrohjeje, që mund të kalojnë nëpër pronën e përbashkët deri në pikat e shpërndarjes në njësitë individuale.

Kriteri:

Në kundërshtim me ligjin nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta”, Neni 5 Objekte në pronësi të përbashkët:

1. Objekte në pronësi të përbashkët janë të gjitha pjesët e një prone në bashkëpronësi, përveç njësisë. Prona e përbashkët është e pandashme dhe është në pronësinë e përbashkët të pronarëve të njërive individuale, në përputhje me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi. Prona e përbashkët përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, territorin, pajisjet, mjedisin dhe objektet në shërbim të saj, që nuk janë destinuar për përdorim individual dhe nuk janë pronë publike, si truallin, mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, parkimet, pishinat, gjelbërimin, themelet, muret mbajtëse, çatinë, tarracën, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, puset, pusetat, depozitat e ujit dhe kaldajat.

2. Prona e përbashkët përfshin, gjithashtu, pjesë të ndërtesës për përdorim të përbashkët, të cilat janë vendosur gjatë ndërtimit ose më vonë, si kanalizime, kolona shkarkimi, oxhakë, sisteme elektrike, hidraulike, gazi ose ngrohjeje, që mund të kalojnë nëpër pronën e përbashkët deri në pikat e shpërndarjes në njësitë individuale.

Ndikimi/Efekti:

Miratimi i lejes së ndërtimit në pronësi të përbashkët për vetëm një person çënon të drejtat pasurore të personave të tjerë të cilët janë pronarë të asaj prone.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dropull

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Dropull, të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi në tarracave ku ka bashkëpronësi dhe në mosrespektim të nenit 5 të ligjit nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta”, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. Z. DH.T me detyrë kryetar i bashkisë Dropull

2. **Z. A.T** me detyrë drejtor DPZHKT bashkia Dropull
3. **Z. L.K** me detyrë përgjegjës i DPZHKT bashkia Dropull.
4. **Z. S.E** me detyrë specialist i DPZHKT bashkia Dropull

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

Pika 2.6 e programit. Mbi veprimtarinë e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi zbatimin e pikës 2.6 të programit të auditimit, mbi veprimtarinë e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit, rezulton se në bashkinë Dropull kjo strukturë nuk është e plotësuar pasi ka vetëm një person të punësuar në këtë inspektoriat. IMT nuk posedon blloqe të procesverbaleve të kundërvajtjes si dhe blloqe për daljen e vendimeve të gjobave apo prishjes së objekteve të cilat janë në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin e territorit” si dhe ligjin 9780 “Për inspektimin e ndërtimit”, ku thuhet se:

Neni 4 Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës Pranë çdo bashkie/komune ngrihet inspektorati ndërtimor e urbanistik, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, ushtron përgjegjësinë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të bashkisë/komunës. Struktura e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës miratohet nga këshilli vendor përkatës, me propozimin e kryetarit të bashkisë/komunës. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë/komunës. Për përmbushjen e përgjegjësiave të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës mbështetet nga policia bashkiake/komunale dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga bashkia/komuna.

Neni 5 Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës Gjatë ushtrimit të përgjegjësiave të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme: a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; b) vendos gjopa sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi; e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.

(Nga subjekti Bashkia Dropull nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit)

Pika 2.7 e programit. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshme.

Mbi auditimi i dokumentacionit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar në Bashkinë Dropull me nr. nr. 800/7 prot., datë 19.12.2022” dhe miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 236 datë 16.12.2022.

Nga auditimi i bërë mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **12** rekomandime të lëna, nga Subjekti janë pranuar të **12** rekomandimet nga të cilat: janë zbatuar **7** masa ose **58.3%** e tyre; **2** masa janë zbatuar pjesërisht

dhe në proces zbatimi si dhe **3** masa janë pa zbatuar; pra **5** masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti Bashkia Dropull për periudhën në vijim, rezultoi si më poshtë vijon:

a. Për përmirësimin e Legjislacionit në fuqi nuk është lënë masë;

b. **Masa Organizative** janë lënë **8**, dhe janë pranuar **8** masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar **6** masa dhe **2** masa janë pa zbatuar;

Nga *Rekomandimet e lëna në RPA* e auditimeve të mëparshme dhe rikërkuar nga grupi i auditimit në RPA me nr. 800/7 datë 19.012.2022, janë lënë për t'u zbatuar **2** masa, pranuar **2** masa; nga të cilat **1** masë është zbatuar dhe **1** masë pa zbatuar .

Në total janë lënë **10** masa dhe pranuar **10** masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar **7** masa dhe **3** masa pa zbatuar.

c. **Masa për Uljen e borxhit tatimor** dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat e munguara) në bashkinë Dropull është lënë **1** masë e cila është pranuar në vlerën 10,649,239 lekë. Kjo masë rezulton pjesërisht zbatuar.

Nga *Rekomandimet e lëna në RPA* e auditimeve të mëparshme dhe rikërkuar nga grupi i auditimit në RPA me nr. 800/7 datë 19.012.2022, janë lënë për t'u zbatuar **1** masë, pranuar **1** masë në vlerën 11,092,920 lekë;

Në total është **1** masë në vlerën totale 10,649,239 lekë¹¹: e cila rezulton e zbatuar pjesërisht me arkëtim në vlerën 5,576,164 dhe deri më 31.12.2022 mbetur për tu arkëtuar nga detyrimi total vlera **8,772,214** lekë për 1114 debitorë¹²;

d. **Masa Shpërblim dëmi** nga auditimi i fundit nuk është lënë;

Nga *Rekomandimet e lëna në RPA* e auditimeve të mëparshme dhe rikërkuar nga grupi i auditimit në RPA me nr. 800/7 datë 19.12.2022, është lënë për t'u zbatuar **1** masë dhe pranuar në vlerë të plotë prej 3,419,505 lekë, e cila vazhdon të jetë pjesërisht zbatuar;

Në total është lënë **1** masë shpërblim dëmi dhe pranuar në vlerën 3,419,505 lekë dhe rezulton pjesërisht zbatuar.

e. **Masa disiplinore** nuk janë lënë.

Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranuar dhe të zbatuara nga Bashkia Dropull (njësitë përgjegjëse të saj), arriti në konkluzionin që për kategorinë “Masa Organizative”-Rekomandimet 1.2; 2.1; 3.1; 4.1; 5.1; 6.1; dhe nga Rekomandimet e rikërkuar 5.1, janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti – Bashkia Dropull, **prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.**

Titulli gjetjes 1. <i>Statusit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 800/7 datë 12/12/2022.</i>
--

Situata:

Bashkia Dropull me Urdhër të Kryetarit nr. 7 dhe me nr. 22 prot., datë 06.01.2023 ka ngritur grupin e punës, i cili ka hartuar Planin e veprimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit” dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Dropull.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ” Bashkia Dropull ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 60 datë 12.01.2023, brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

¹¹ Meqënëse janë masa të të njëjtës natyrë dhe i përkasin të njëjtës kategori, i përmblohdhëm në një masë të vetme në vlerën e detyrimit 10,649,239 lekë.

¹² Informacioni i detajuar në tabelën e debitorëve

- Bashkia Dropull ka raportuar në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së” dhe Planin e veprimit për zbatimin e tyre, me shkresën “Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Dropull” nr. 449 prot., datë 07.03.2023, me rendin e ditës prej pesë pikash, ndër to edhe pika me objekt “Raportim mbi rekomandimet e lëna nga KLSH në RPA dhe Planin e veprimit”.

- Në zbatim të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA shkriresish me objekt “Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit” dërguar me shkresën nr. 800/7 prot., datë 19.12.2022, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Dropull me nr. 2168 prot., datë 27.12.2022. Ky raportim nuk është bërë, pasi afati 6 mujor përmbushet në datën 29.06.2023, periudhë e cila përkon me fazën në terren të grupit të auditimit për zbatimin e programit të auditimit nr. 424/1 datë 19.05.2023. Nga ana e saj Bashkia Dropull iu përgjigj kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre.

Bashkia Dropull ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:

a. Masa Organizative janë lënë **10** Rekomandime që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat rikërkohet **3** masa të pazbatuara;

b. Masa për Uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat e munguara) në bashkinë Dropull është lënë **1** rekomandim i cili rikërkohet si i zbatuar pjesërisht në vlerën e mbetur deri më 31.12.2022 prej **8,772,214** lekë për 1114 debitorë;

c. Masa shpërbllim dëmi është lënë 1 masë (e rikërkuar) në vlerën 3,419,505 lekë dhe rikërkohet në vlerën e saj të plotë si e zbatuar pjesërisht (në proces gjyqësor);

Kriteri:

Ligji nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 gërma j; Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”;

Shkaku:

Mos ndjekja e gjitha procedurave nga ana e njësive përgjegjëse të Bashkisë Dropull, për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna në përgjithësi dhe ato me arkëtimin të vlerës 8,772,214 lekë në veçanti.

Ndikimi/Efekti:

Moszbatimi i Rekomandimeve ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale dhe pengon për përmirësimin e tyre në dobi të komunitetit, në mospërdorimin me efikasitet të fondeve të saj si dhe në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Dropull.

Rëndësia: E Lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Dropull të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 800/7 prot., datë 19.12.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, si dhe përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma.

Nga sa më lart, Grupi i Auditimit të KLSH-së rikërkon si më poshtë vijon:

A. Masat Organizative

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të plotë të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale në Bashkinë Dropull të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës llog.7206 "Financim i pritshëm nga buxheti". Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit.

Menjëherë

4.1 Rekomandim (rikërkuar): Titullari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe menaxhimit të Aseteve të marrë masa menjëherë për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat "Toka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksiione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Dropull më 31.12.2020.

(Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Dropull nuk e ka zbatuar rekomandimin. Pazbatuar).

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

11.1 Rekomandim (rikërkuar): Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Dropull të vazhdojë ndjekjen e të gjitha shkallëve të proceseve gjyqësore për arkëtimin e dëmit në vlerën 3,419,505 lekë. *(Nga verifikimi rezultoi se, rekomandimi është në proces nga Bashkia Dropull, Zyra juridike e ka çuar çështjen në Gjykatën e Apelit që të vazhdojë ndjekjen e të gjitha shkallëve të proceseve gjyqësore. Rekomandimi është pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi).*

Me zbardhjen e Vendimit të Gjykatës

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për të ndjekë të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve deri më datën 31.12.2022 prej 8,772,214 lekë për 1114 taksapaguese privat dhe familjarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Më hollësisht janë trajtuar në Aneksin 7.1 bashkëlidhur Raport Auditimit.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se plani i shpenzimeve në fillim të vitit është miratua në vlerën 220,105 mijë lekë, gjatë vitit ka pësuar rritje kryesisht për investime nga Ministria për ujësjellës, donacione nga projektet e BE si dhe ndihma ekonomike dhe paaftësi në vlerën 423,152 mijë lekë pra shpenzimet buxhetore gjithsej për vitin janë në vlerën 643,257 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 483,747 mijë lekë ose 75%.

U konstatua se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit për disa zëra të shpenzimeve buxhetore, që mbulohen nga të ardhurat e veta, kështu shpenzime operative është planifikuar në vlerën 55,003 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 34,719 mijë lekë, ose në masën 63%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 54,328 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 12,301 mijë lekë, ose në masën 23 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dropull në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifrat vendore dhe ky planifikim nuk korrigohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Për periudhën e vitit 2022 janë parashikuar realizimi i procedurave të vlerë të lartë dhe të ulët në artikullin (602/231) në shumën 130,994,200 lekë, nga e cila: prokurime me vlerë të lartë 115,340,010 lekë për 13 procedura dhe prokurime me vlerë të vogël me vlerë 15,654,191 lekë kjo për 40 procedura.

Në fakt nga të parashikuara janë realizuar vlera 109,954,949 lekë, nga e cila: procedura me vlerë të lartë 99,617,511 lekë dhe procedura me vlerë të vogël 10,337,438 lekë.

Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2022, për artikullin (602/231) janë në vlerë 181,550,095 lekë, nga e cila: procedura me vlerë të lartë 180,191,049 lekë dhe procedura me vlerë të vogël janë 1,359,046 lekë.

Situata financiare e Bashkisë Dropull, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 dhe gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 3.44 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare, veprime në mospërputhje me pikën (a) të nenit 5 dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe vendimet përkatëse të këshillit bashkiak (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 41-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe sektorët e tjerë të bashkisë, të marrin masa për hartimin e një buxheti sa më real në raport me strukturën aktuale të bashkisë, të planifikimit të procedurave të prokurimit për investime/shërbime dhe blerje mallrash sipas nevojave që vetë bashkia ka dhe jo të planifikohen jashtë mundësive reale të cilat dështojnë në fazën e zbatimit të tij.

12. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektori i Menaxhimit të kontratave), të marrin masa për likuidimin e të gjitha faturave të depozituara me dokumentacion të rregullt ligjorë, si dhe të verifikojnë në cdo fazë afatet e përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të faturave brenda afatit ligjorë. Në rast të evidentimit të vonesave të llogaritet penalitetet për kamatëvonesë, si dhe t’i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë llogaritjen e penaliteteve për TVSH e shitjes për vonesa në deklaram jashtë afateve.

Menjëherë dhe vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave vendore dhe akt akordimeve me Degën e Thesarit Gjirokastër, rezulton se:

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave, sipas *Aneks 2.6.1 bashkëlidhur Raport Auditimit*.

Të ardhurat totale të Bashkisë Dropull janë realizuar në masën 84%, ku nga vlera e planifikuar prej 71,168 mijë lekë është arkëtuar vlera 59,699 mijë lekë me një mosrealizim në vlerën 11,469 mijë lekë. Në totalin e të ardhura rezulton se 11 zëra paraqiten me realizim mbi 100%, ndërsa 13 zëra paraqiten me mos realizim nga 2 deri në 90%.

Për vitin 2022 janë parashikuar 71,168 mijë lekë të ardhura nga 73,489 mijë lekë të parashikuara në vitin 2021 **ose më pak për vlerën 2.321 mijë lekë**. Ndërsa në arkëtim nga 59,699 mijë lekë janë arkëtuar në vitin 2022 nga 68,755 mijë lekë të arkëtuara në vitin 2021 **ose më pak për shumën 9,056 mijë lekë**. *Ky mosrealizim ose planifikim dhe arkëtim i taksave e tarifave vendore me ulje nga njëra periudhë në tjetër tregon punën e pamjaftueshme të Drejtorisë së të Ardhurave vendore në menaxhimin më të mirë të të ardhurave, pasi faktorët që mund të argumentonin këtë mos realizim dhe ulje të detyrimeve, si numër i subjekteve dhe niveli i tyre sipas VKB, nuk janë faktorë të cilët mund të kenë ndikuar në këtë gjendje (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 54-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave bashkia Dropull, duhet te behet analize e plote dhe analitike e shkaqeve të mos realizimeve të të ardhurave sipas zërave, duke vlerësuar bazën e llogaritjes së detyrimeve apo dhe arsyet e tjera qe kane krijuar këtë lloj situate, si dhe të marrin masa për një planifikim të saktë të detyrimeve nga takat e tarifave vendore dhe rritjen e përgjegjësisë për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj dhe janë regjistruar në evidencat përkatëse, si dhe protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga DSHTRR derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Dropull brenda datës 5 të çdo muaji. Këto derdhje bëhen rregullisht dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Gjirokastrë.

Konstatohet se nuk kanë mbajtur aktrakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, mbi nivelin e taksës së rentës minerale dhe tatimit mbi të ardhurat, sa është dhe sa duhet paguar në buxhetin e bashkisë Dropull.

Gjithashtu, nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë ASHK Dega Gjirokastrë, mbi numrin e transaksioneve të kryera, nivelin e tarifës së arkëtuar dhe xhiruar për llogari të bashkisë Dropull. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel mesatar të realizimi. Bashkia Dropull nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Dropull nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me detyrimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Dropull, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjatë të këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura”, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, datë 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 54-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Dropull, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifave vendore të cilat gjenerohen

nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Brenda datës 31.12.2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi si me poshtë:

Me VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Per transferimin ne pronësi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrisë se Mjedisit e te ish komunave/bashkive”, ndryshuar me VKM nr.398, datë 13.05.2020 është miratuar lista e inventarit te pyjeve dhe kullotave qe transferohen ne pronësi te Bashkise Dropull”, sipas te cilit jane transferuar **24.841,6704 ha** gjithsej, nga e cila, **13.091,0369 ha** kullota, **11.558,1446 ha pyje**, **88,63 ha toke shkëmbore**, **88,63 ha** sipërfaqe rezervuari dhe **47,68 ha** sipërfaqe ranishte.

Per periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, jane miratuar tarifat per dhënie me qira te sipërfaqeve kullimore e pyjore per kullota dimërore, ne mbështetje te VKM nr.632, datë 11.06.2009 “Per miratimin e tarifave te përdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje” me VKB nr. 69, datë 25.11.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1075/1, datë 9.12.2021. Nga kjo Bashki per periudhën e mësipërme, jane lidhur 43 kontrata qiraje per kullota dimërore me nje sipërfaqe prej 4239.88 ha.

Per periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, jane miratuar tarifat per dhënie me qira te sipërfaqeve kullimore e pyjore per kullota verore ne mbështetje te VKM nr.632, datë 11.06.2009 “Per miratimin e tarifave te përdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje” me VKB nr. 69, datë 25.11.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1075/1, datë 9.12.2021.

Nga kjo Bashki per periudhën e mësipërme, jane lidhur 35 kontrata qiraje per kullota verore me nje sipërfaqe kullimore prej 6467.59 ha, ne nje kohe, qe sipas VKB nr. 2, datë 27.01.2022 “Per miratimin e listës se kullotave te gatshme per kullotje per sezonin veror –dimërore” është miratuar per dhënie me qira sipërfaqja kullimore prej 6819.68 ha.

Gjithashtu, nga ana e Drejtorisë se Administrimit te Ujrave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave, nuk është hartuar regjistri i kapacitete kullimore per sipërfaqet kullimore dhe pyjore qe ka ne pronësi Bashkia, por, per sipërfaqet e dhëna me qira jane aplikuar kapacitetet e përcaktuara ne Planin e mbarështimit per periudhën 2009 / 2019 te hartuar nga ish Drejtoria e Pyjeve e cila është hartuar per nje sipërfaqe pjesore prej 5.175 ha dhe jo per gjithë sipërfaqen kullimore qe ka ne pronësi Bashkia Dropull.

Nga auditimi i dosjeve te kontratave verore dhe dimërore te lidhura, rezultoi se, është zbatuar procedura e përcaktuar ne Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit Nr.4, datë 10.04.2008 “Per kriteret teknike te klasifikimit te kullotave e livadheve dhe procedurat per dhënien e tyre per kullotje e kositje bari”, pasi te gjitha dosjet e subjekteve qiramarrës te kullotave jane plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar ne Udhëzimin e sipërpërmendur, qe nga kërkesa deri te proces verbali i dorëzimit te parcelave te marra me qira, me përjashtim te pikave te mëposhtme:

- Nga ana e Zyrës se Pyje kullotave nuk është shpallur lista e kullotave te gatshme per kullotje dhe sipërfaqet qe përjashtohen nga kullotja, ne muajin Shkurt te cdo viti, ne zbatim te kreut II “Procedurat e dhënies per kullote dhe kositje bari”, pika 2 te Udhëzimit te mësipërm.

- Nga ana e qiradhënësit, Bashkise, nuk jane bërë sondazhe gjate kullotjes per te mos lejuar futjen e bagëtive ne kullote jashtë kapacitetit kullisor te kontraktuar, ne kundërshtim me kreun III “Kërkesat teknike te përdorimit te fondit kullisor per kullotje”, pika 7 te Udhëzimit te mësipërm.

- Nga ana e strukturës përgjegjëse nuk është bërë verifikimi ne terren nëse është zbatuar kontrata dhe nëse ne parcele jane futur po aq krerë sa është lidhur kontrata, per te cilën, rekomandohet te behet verifikimi me nje komision te miratuar nga titullari.

- Nuk ka bashkëpunim me AZHBR Qarku Gjirokastër në lidhje me numrin e bagëtive të regjistruara për bashkinë Dropull.

- Kontratat në çdo rast nuk kanë bërë përcaktimin se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave (*sipas vendimit të Komisionit të Ndarjes së Kullotave apo vendimit të këshillit të komunës*).
- Nuk administrohej hartë për sipërfaqen e shfrytëzueshme.
- Për të gjitha kontratat, konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfituar kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinare për numrin e regjistrit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar numri real i secilit blegtor.
- Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).
- Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.
- Nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullor.
- Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie, si dhe nuk është vijuar me regjistrimin e pronave të paregjistruara, pasi këto prona nuk janë të regjistruara në emër të NJQV, duke sjellë për pasojë të qenurit pronar me të drejta jo të plota por të kufizuara.
- Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.
- Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.
- Nuk janë përcaktuar kriteret për dhënien me qira të tyre, nga ku kriteret prioritare si p.sh. fermerët me banim brenda territorit të njësisë, me vendndodhje afër kullotës, që mbarështojnë një numër të madh bagëtitish, të atyre që shtegtojnë tufat në ekonomi të tjera kullimore e që kanë qenë të kontraktuar sezonin e kaluar.
- Nuk ka hartuar planet e mbarështimit të kullotave.

Veprime në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për Fondin Kullor”, i ndryshuar me Ligjin nr. 49/2016, neni 26, “*Bashkitë janë pronarë të kullotave që gjenden brenda territorit administrativ të tyre dhe kanë për detyrë të a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij; b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet*”; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në NJQV”; Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; Udhëzimi nr. 4, datë 10.04.2008, “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, të livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”; VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”; Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe VKM nr.22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 3 e vijim; pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006,; me nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10210, datë 25.3.2010, në referim të ligjit 5 “Planet e Mbarështimit”, nenin 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, nenin 15/2 “Pronësia e Fondit Pyjor” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 54-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, si dhe të marrin të gjitha masa për inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës); mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës

truall; mbajtjen, evidentimin, administrimin e balancimit të fondit kullor; pasqyrimin në kontabilitet, në llogaria nr. 211 “*pyjet, kullotat dhe plantacione*”, aplikimit për regjistrim të parcelave në ASHK Drejtoria Gjirokastrë; hartimin e plan mbarështimit për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme; krijimin të ardhura nga lëndët drusore, përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, dhe hartimin e plan mbarështimit menaxhimit të pyjeve dhe kullotave; përcaktimin e kriterëve për dhënien me qira të tyre.

Brenda datës 31.12.2023

5. Gjetje nga auditimi: Auditimi për administrimin dhe dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, u krye në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8312 datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pa ndara”, VKM nr. 531 datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, Udhëzimit KM nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies të tokave bujqësore të pandara” Udhërit të MBU nr 10 datë 13.09.2012 “Për mënyrën e përllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore, të pandara” dhe Udhërit të Ministrit të M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara”, *ku u konstatua se:*

Për periudhën e audituar 01.01.2022 – 31.12.2022, nga kjo bashki nuk është lidhur asnjë kontratë për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandara, por ka në vazhdim 5 kontrata me një sipërfaqe totale prej 91.761 m², të lidhura nga ish Njësitë e Qeverisjes vendore (Komunat), e përkatësisht:

- Kontrata e lidhur me **z. F.L** me nr rep. 1222 dhe koleksioni nr 758 datë 08.07.2011, për parcelën me nr kadastral 95/37 në fshatin Bodrishte me sipërfaqe 18.748 m², për kultivim peme frutore, me çmim 6.000 lekë/ha/vit, me afat dhënie me qira për 99 vjet.

- Kontrata e lidhur me **z. J.LL** me nr rep. 1221 dhe koleksioni nr 757 datë 08.07.2011, për parcelën me nr kadastra l 94/1 në fshatin Bodrishte me sipërfaqe 34.976 m², për kultivim peme frutore, me çmim 6.000 lekë/ha/vit, me afat dhënie me qira për 99 vjet.

- Kontrata e lidhur me subjektin **2B...K** me nr rep. 666 dhe koleksioni nr 303 datë 27.03.2013, për parcelën me nr kadastral 138/2 e pjesëshme në fshatin Bularat, sipërfaqen prej 7.300 m², për një afat 35 vjet, me tarife 6.100 lek/ha/vit kalendarik, për përdorim sipas planit të biznesit të datës 15.11.2012, ku përcakton mbjelljen e 460 rrënjëve dardhe.

- Kontrata e lidhur me **z.S.Ç**, me nr rep. 665 dhe koleksioni nr 302 datë 27.03.2013, për parcelat 301/9 deri 301/19 tek zona kadastrale 2278, në fshatin Krioner, për sipërfaqen prej 14.914 m², me afat për 35 vjet, me tarife 6.200 lek/ha/vit kalendarik, për mbjellje dru frutore sipas planit të biznesit, ku përcakton mbjelljen e 315 rrënjëve ara.

- Kontrata e lidhur me **z.TH.Q**, datë 30.03.2017, për parcelat me nr. pasurie 236/23, tek zona kadastrale 3018, në fshatin Poliçan, për sipërfaqen prej 16.547 m², me afat për 99 vjet, me tarife 9.000 lek/ha/vit kalendarik, për mbjellje të kulturës ara.

- Kontrata nr. 545/169 e lidhur me **z. DH.GJ**, datë 20.5.2022, për parcelat me nr. pasurie 456, tek zona kadastrale 2233, në fshatin Koshivic, për sipërfaqen prej 0.1769 ha, me afat për 10 vjet, me tarife 6,500 lek/ha/vit kalendarik, për mbjellje të kulturës patate.

- Kontrata nr. 1346/447 e lidhur me **z. DH.GJ**, datë 24.11.2022, për parcelat me nr. pasurie 442, tek zona kadastrale 2483, në fshatin Llongo, për sipërfaqen prej 5.9229 ha, me afat për 99 vjet, me tarife 7,200 lek/ha/vit kalendarik, për mbjellje të kulturës gështenjë.

Gjithashtu:

- Bashkia Dropull në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, ka iniciuar procesin për dhënien me qira të tokave bujqësore **por pa miratim në Këshillin Bashkiak** për dhënien me qira të tokave bujqësore të lira me qëllim sigurimin e të ardhurave.

- Mungon procesi verbal mbi tërheqjen e dokumentacionit të plotë të dhënies me qira të këtyre sipërfaqeve.

- Nuk disponohet regjistri i plotësuar me të gjitha të dhënat për të ndjekur kërkesat e kontratave të lidhura si dhe arkëtimet në vazhdimësi.

- Në kundërshtim me kërkesat e kontratës tip, kontrate të miratuara me Urdhrit të Ministrit të M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara”, neni 2 “Detyrimet e qiramarrësit” pika “dh”, ku jo të gjitha rastet është paraqitur në Bashki, kontrata e depozituar pranë ASHK Gjirokastër, kjo për të lënë gjurmë auditimit në verifikimin e tyre.

- Në kundërshtim me kërkesat e kontratës tip neni 3, pika “c”, kontrate të miratuara me Urdhrit të Ministrit të M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara”, nga ana e qiradhënësit nuk është kryer asnjë kontroll periodik, për të verifikuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi token bujqësore, ato të kësaj kontrate, kriteret dhe elementet e përcaktuar në kërkesën e paraqitur prej tij pranë autoritetit qiradhënëses për marrjen me qira të pasurisë.

- Nga Bashkia Dropull, nuk është dërguar informacion me shkrim, për zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Gjirokastër, në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në dhjetor të çdo viti, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 4.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu II, pika 1; VKM nr. 510 datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 54-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë bashkia Dropull të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për verifikimin e zbatimit të kontratave të qirasë së tokave bujqësore të lidhura nga ish- komunitat, nëse ato shfrytëzohen për llojin e kontratës për të cilën është lidhur dhe nëse respektojnë detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi token bujqësore.

Për sipërfaqet e reja që do lëshohen me qira, fillimit duhet të miratohen në Këshillin Bashkiak përpara shpalljen në ankand.

Për të gjitha kontratat e lidhura, të informohet zyrtarisht Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Gjirokastër.

Brenda datës 31.12.2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2022, rezulton se në bashkinë Dropull nuk ekziston regjistri i aseteve për pronat si për kullotat, pyjet etje, si dhe nuk është kryer vlerësimi dhe inventarizimi i tyre. Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë i mundur për arsye se duhet aktivet që të vlerësohen duhet të kenë certifikatë pronësie. Nga bashkia Dropull nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie, jo vetëm për arsye financiare por dhe për shkak të kryerjes së aplikimeve pranë ASHK dhe mos pajisjes me certifikatë pronësie. Nga ish komunitat janë bërë aplikime dhe janë kryer pagesat për 46 prona dhe kryer pagesa me vlerë 332,000 lekë, por që nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie.

Për NJA Dropull i Sipërm janë 91 prona me vlerë 502,600 lekë, aplikime këto të bëra që në vitin 2014. Me shkresën nr. 180 prot, datë 25.5.2015 nga ish-komuna Dropull i Poshtëm është dërguar kërkesë Kryeregjistrusit të ish- ZVRPP Tiranë. Me datë 16.10.2019 me shkresën nr. 1815 prot, datë 16.10.2019 është ripërsëritur kërkesa për pajisje me certifikatë pronësie sipas aplikimeve dhe pagesave të kryera. Nga ASHK nuk rezulton të jetë bërë shkresë për përgjigje. Nga 193 prona inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 toka troje terren, llog. Pyje plantacione, 212 ndërtesa e konstruksione, bashkia Dropull nuk posedon titull pronësie në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.8.2001 “për inventarizimin

dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, kreu VI ‘*Transferimi i pasurive*’, pika 1 dhe 2.

Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale nuk është mbështetur në dokumentacion e duhur në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, kapitulli III pika 35 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 75-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkise Dropull në bashkëpunim me Sektorin e Buxhetit dhe Menaxhimit të Asteve të marrë masa të menjëhershme për përmisimin e gjendjes me parashtrimin të problematikës në GSM.

Të ndërmarë dhe nisë të gjitha procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titull pronësie për pronat; “toka, troje, terrene, pyje, plantacione. Ndërtesa dhe konstruksione”, për vlerësim e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë me qëllim paraqitje e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiar të njësishë publike vendore.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së miratimit të “*Leje ndërtimi, me sipërfaqe 63.2 m²*”, për të cilën është marrë vendimi **Nr.750, datë 28/4/2021**, i Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin “Shtese Anësore Banese Adresa e realizimit të punimeve”, me zhvillues **TH.N, u konstatua si më poshtë:**

- Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se planvendosjen e miratuar nuk është e saktë pasi nuk ka të detajuara të gjitha elementët e nevojshëm si, distancat e objektit që do ndërtohet nga objektet rreth tij, si dhe numrat e kateve në kundërshtim kjo me Kushtet Teknike të Projektimit KTP.

- Preventivi i llogaritur nga projektuesi nuk është llogaritur bazuar në çmimet e referencës për koston e ndërtimit sipas zonave përkatëse. Për ndërtime të caktuara sipas kategorive të tyre preventivi nuk mund të jetë më i ulët se kostoja e ndërtimit çmimi i të cilës është caktuar nga Enti Kombëtar i Banesave EKB. Kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m².

- Planvendosjen e miratuar nga ana e DPZHKT bashkia Dropull nuk është respektuar distanca e objektit që do ndërtohet me kufirin e pronës, në kundërshtim me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 35 *Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës*. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. K +1m) ku: d – distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. K – numri i kateve.

- Nuk është marrë mendim nga institucionit (Agjensia e Zhvillimit të territorit ASHK, UK, ASHK) për lejet, në kundërshtim kjo me Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori, Neni 15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit, veprime në kundërshtim me çmimet e Enti Kombëtar i Banesave (EKB), *kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m²*; VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori”, respektivisht nenet 15 dhe 35 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 115-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Dropull, të marrë masa për:

- Të mos pranuar preventiv fiktiv nga ana e projektuesit duke kontrolluar zërat e punës dhe llogaritur preventivin jo më pak se kostoja e ndërtimit
- Të respektuar distancat e lejuara nga kufiri i pronës.
- Të miratuar leje ndërtimi me mendimet pozitive të aprovuara nga institucionet e nevojshme për të dhënë këtë mendim

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe 100 m²”, për të cilën është marrë vendimi **Nr.1090, datë 27/6/2021**, i Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin “Shtese kati mbi objekt ekzistues – Jorgucat – Gjirokastër”, me zhvillues **R.V.**, u konstatua si më poshtë:

-Planvendosjen e miratuar nuk është e saktë pasi nuk ka të detajuara të gjitha elementët e nevojshëm si distancat e objektit që do ndërtohet nga objektet rreth tij si dhe numrat e kateve në kundërshtim kjo me Kushtet Teknike të Projektimit KTP.

- Miratuar leje ndërtimi për shtesë kati në objektin ekzistues 2 kate. Objekti në fjalë nuk është i gjithi në pronësi të personit që është miratuar leja e ndërtimit por janë pronarë familje të ndryshme. Leja e miratuar nga ana e DPZHKT bashkia Dropull është dhënë mbi tarracën e personit që ka aplikuar ndërkohë tarraca hynë tek objektet e përbashkëta referuar ligjit nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta” Neni 5 Objekte në pronësi të përbashkët, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta”, Neni 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 115-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Dropull, të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi në tarracave ku ka bashkëpronësi dhe në mosrespektim të nenit 5 të ligjit nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta”, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi veprimtarinë e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit, rezulton se në bashkinë Dropull kjo strukturë nuk është e plotësuar pasi ka vetëm një person të punësuar në këtë inspektoriat. IMT nuk posedon blloqe të procesverbaleve të kundërvajtjes si dhe blloqe për daljen e vendimeve të gjobave apo prishjes së objekteve të cilat janë në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, si dhe ligjin 9780 “Për inspektimin e ndërtimit”, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 115-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit Mbrojtjes Territorit, si një strukturë e domosdoshme nga ndërtimet pa leje.

Në rast mungesë specialisti të fushës sipas përcaktimeve të ligjore të bëhet marrëveshje me IKM të Qarkut Gjirokastër për kontrollin e territorit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës për punë publike, me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” Bashkia Dropull, rezultoi se investimi, nuk është marrë në dorëzim për shkak të mos plotësimit të rekomandimeve të lëna nga grupi i marrjes në dorëzim, për arsye:

-Mos vendosje reductor presioni, për: rezervuarin 200 m³ nr. 1 (Nga ana e Goraxisë) dhe rrjetin shpërndarës; për dhomën e komandimit rezervuari nr. 2 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rezervuarin 200 m³ nr. 3 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rrjetin shpërndarës fshati Sofratikë sipas projektit të zbatimit, si dhe për mos zbatimin e disa zërave të përcaktuar në proces verbalin e datës 29.03.2023 hartuar nga grupi i punës pranë Njësinë Administrative të Dropullit të Poshtëm në Bashkisë Dropull (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 108-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Dropull në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e punimeve dhe Kolaudatorin e punimeve, të marrin masa për marrjen në dorëzim të parakohshëm të investimit me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat”, pasi të plotësohen nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “K. N” SHPK rekomandimet e lëna nga grupi i marrjes në dorëzim sipas proces verbalit të datës 29.03.2023.

Gjithashtu të merren masa të menjëhershme për vendosjen e reduktorëve të presionit, për rezervuarin 200 m³ nr.1 (Nga ana e Goraxisë) dhe rrjetin shpërndarës; për dhomën e komandimit rezervuari nr. 2 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rezervuarin 200 m³ nr. 3 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës, për rrjetin shpërndarës fshati Sofratikë sipas projektit të zbatimit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të lartë me fond limit **419,885** mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në **aplikimin e kritereve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara gjithsej **3** procedura me fond limit **402,919** mijë lekë, kritere të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

a- Procedura me objekt “Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar “Bularat”+kopsht Bularat,Dropull i Siperem” zhvilluar në vitin 2022, me fond limit 58,648,181 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 53,945,123 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJA”.

b-P{r}vedura me objekt Rikonstruksion i rrjetit te brendshëm te ujësjellësit te Dervician,Sofratik dhe Terihat ,Bashkia Dropull”, zhvilluar në vitin 2021, me fond limit 120,286,360 lekë dhe vlerë kontrte 119,025,533 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K...N”.

c- Procedura me objekt “Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujësjellësit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan,Lugar dhe Grapsh,Bashkia Dropull”, zhvilluar viti 2021, me fond limit 210,633,067 lekë dhe vlerë kontrate 206,313,149 lekë, ku fitues është shpallur JV “R...A”, “T...U” & “SH...I” & “V...N” ShPK.

d- Procedura me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme ne fshatrat e Bashkise e mbrojtje malore” zhvilluar viti 2021, me fond limit 13,352,072 lekë dhe vlerë kontrate 13,214,300 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “M...S”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me kriteret specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit. Kërkesa për mjek të përgjithshme të pambështetur në ligj, etj.

Vendosja si kritere e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “Për prokurimin publik”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

Mos hartimi I oponenca teknike në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 120/2020, datë 7.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 91-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike (Sektori i procedurave të Prokurimit) në Bashkinë Dropull, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për të gjithë procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera nuk duhet të hidhen në prokurim pa marrë më parë miratimin nga Instituti i Ndërtimit për oponencën teknike të investimit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, mbi vlerësimin e aktivitetit të Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Dropull u konstatua se:

1.1 Referuar Planeve Strategjike [2021-2023 dhe 2022-2024] dhe atyre Vjetorë [2021 dhe 2022], planifikimit dhe grafikut të shpërndarjes së misioneve audituese për tu realizuar nga NJAB, regjistrin dhe vlerësimin të riskut, rezulton se ndihet e nevojshme realizimi i Auditimit IT, pasi konstatimet dhe rekomandimet e të cilit përpos të tjerave, do të mundësonin lehtësi edhe në procesin auditues të fushave/sistemeve të tjera vlerësuar me risk të lartë. Kjo sipas komunikimit me NJAB vjen si rezultat i mungesës së kapaciteteve, për të cilat nga ana e NJAB *duhej të parashtrohej te Titullari me rëndësinë e duhur.*

1.2 Nga auditimi i planeve strategjike dhe vjetorë të miratuar si edhe realizimit të tyre për vitet 2021 e 2022, rezultoi se NJAB nuk ka planifikuar mision auditues për fushën e “menaxhimit të burimeve njerëzore”, duke rezultuar e klasifikuar me risk të ulët. Vlerësimi jo real me koeficientin e riskit të kësaj fushe, ka sjellë mungesën e misionit auditues të paktën këto 3 vitet e fundit në strukturën përgjegjëse të menaxhimit të burimeve njerëzore – Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme. Kjo ka sjellë mospërfshirjen në planet strategjike dhe ato vjetorë të të gjitha njësive të strukturës organizative me referim koeficientin e riskit, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, të gjitha këto në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, pika 3.1.2; 3.

1.3 Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 3 vitet e fundit, rezulton se numri i rekomandimeve të lëna dhe numri i atyre të zbatuara vijnë në rënie; ndërsa rekomandimet e shprehura në vlerë mbeten në statusin “në proces”.

1.4 Nga auditimi mbi raportimin në NJAB/ Bashkia Dropull të subjekteve të audituara mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe përcjellë në Raportin Përfundimtar të Auditimit, rezultoi se nuk janë ndjekur hapat e monitorimit të tyre. Ndonëse, NJAB ka ushtruar dy misione audituese “për zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara”, nuk justifikon mospërbushjen e detyrimit ligjor nga ana e subjekteve të audituara, në mos zbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4, të “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Përgjegjësi për mosraportim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga misioni auditues i NJAB, kanë edhe subjektet e audituara, në moszbatim të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2, faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së auditimit të brendshëm me auditues në përmbushje të kërkesave për hartimin e planeve strategjike e vjetorë nga NJAB, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave;

12.2. Rekomandimi: Njësia e auditimit të brendshëm të bëjë një vlerësim real të koeficientit të riskut për fushat/sistemet objekt i misioneve audituese; të përfshijë në planet strategjike dhe vjetorë sektorët e fushave me risk, siç janë: zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, menaxhimi i burimeve njerëzore, sistemet e teknologjisë së informacionit të implementuar etj., duke respektuar raportin 60/40 mes sistemeve/fushave me koeficient të lartë risku ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët risku në hartimin e planeve strategjike e vjetorë të njësisë;

12.3. Rekomandimi: Njësia e auditimit të brendshëm, të ndjekë me korrektësi fazën e misionit

auditues, pas dërgimit të raportit përfundimtar në subjektin e audituar; t'i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht Njesisë e auditimit të brendshëm sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit;

- Drejtuesi i Njesisë së auditimit brendshëm duhet të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t'ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas Manualit të auditimit të brendshëm, i cili do të ndihmojë në hartimin e një plani strategjik e vjetor sa më efektiv për NJAB.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dropull nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk ka takime të dokumentuara të GMS, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, nuk ka hartuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, Rregullore të posaçme të konfliktit të interesit, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit; Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike; menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe programeve IT, nuk bëhet sipas kërkesave dhe standardeve ligjore në fuqi dhe paraqet risk në komprometimin e të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes. vendore”, urdhrin e Kryeministrit nr. 164 datë 05.10.2017 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.

13.2. Rekomandimi: GMS dhe Koordinatorin e menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

13.3. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një rregulloreje për menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

13.4. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, u konstatua se:

1.1 Nga auditimi rezultoi se VKB nr. 62 datë 24.11.2020 dhe VKB nr. 2 datë 28.01.2021 nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9154 datë 6.11.2003 “Për Arkivat” nenet 23, 24; “Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 13 dhe neni 19 dhe Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë”;

1.2 Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e Bashkisë Dropull, rezultoi se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, kryefamiljare, të komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “ Për Nxitjen e Punësimit”;

1.3 Në Bashkinë Dropull për periudhën 2021-2022 informacioni i vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore për punonjësit veçanërisht ata me kontratë të përkohshme (bashkë me njësitë administrative) rezultoi se në aktin e hartuar “për numrin e punonjësve të Bashkisë Dropull dhe nivelit të pagave të tyre” për tu miratuar në Këshillin Bashkiak, nuk është pasqyruar edhe numri i punonjësve me kontratë (me/pa afat apo të përkohshme) të planifikuar si dhe sektorët/drejtoritë që u nevojitet ky kontingjent, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika c, neni 54 pika dh, neni 64 pika j.

1.4.a Nga ana e Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk janë bërë pjesë e Rregullores së Brendshme tek “Përshkrimet e Punës” kriteret e veçanta që duhet të plotësohen për çdo pozicion i strukturës organizative;

b Nuk ka pasqyruar numrin e të punësuarve që i nënshtrohen procedurave të Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, në aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak për numrin e punonjësve dhe nivelin e pagave për vitin në vijim;

c Njoftimet për punësim me procedurën sipas Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, janë bërë vetëm në stendat e bashkisë, dhe nuk janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Dropull, nuk janë shpallur në portalin për punësim të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, nuk janë publikuar as në rrjetet sociale të Bashkisë Dropull, kjo në moszbatim të Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, neni 19

1.5. Referuar Ligjit 152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, neni 7, pika 5 “Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë”; pika 6 “Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se 14 zjarrfikës, personel profesionist”, nga auditimi u konstatua se njësia e MZSH-së në Bashkinë Dropull, *nuk janë respektuar kriteret* përsa i përket numrit të personelit zjarrfikës profesionist, duke e tejkaluar me të punësuar me kontratë të përkohshme, paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak pa dhënë një relacion argumentues, pasi është një numër i konsiderueshëm të punësuarish sezonal për këtë sektor; nisur nga numri i banorëve, Bashkia Dropull hyn në kategorinë nga [20000-50000] banorë, duhet që njësia e MZSH-së në këtë bashki të ketë 15 zjarrfikës personel profesionist;

1.6. Nga auditimi i dosjeve të personelit në pozicionin “shofer”, rezultoi se për automjete me destinacion të veçantë, që duhet të përdoren nga drejtues që janë të pajisur me “leje drejtimi” dhe me “dëshmi aftësie profesionale” (sipas llojit të mjetit që ka në përdorim), punonjësit e punësuar si drejtues mjeti (shoferë), u konstatua se *nuk janë të gjithë të pajisur* me dokumentacionet justifikuese profesionale, në moszbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 200 datë 16.05.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve,

si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”;

1.7 Nga të dhënat e pasqyrës së pagave, rezultoi se fondi i pagave në Bashkinë Dropull për vitin 2021 zë 17.2% të buxhetit faktik dhe për vitin 2022 zë 20.5% të tij. Nga auditimi mbi planifikimin e fondit të pagave, u **konstatua** se: nuk ka fond për shpërblime mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve me “Status të Nëpunësit civil”; gjithashtu për punonjësit me “kod pune” nuk zbatohet VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”;

1.8 Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2021-2022 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan:

- Në *dosjet e personelit* mungonin: praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; për pozicionet “shoferë” dhe punonjës A.K dokumenti mbi formimin arsimor të tyre; formulari i vetdeklarimit; Kontratat e punës të paregjistruara në Protokollin e Bashkisë; Urdhri për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së punonjësit K.G duhet të përpilohej veçmas nga Urdhri për emërimin në punë të punonjësit J. Xh., ndonëse zëvendësuan njëri tjetrin;

- *Dosjet e punonjësve të larguar* nuk kishin praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Burimeve njerëzore dhe e Shërbimeve të Brendshme, menaxherët e të gjitha njësive të strukturës në Bashkinë Dropull të kompozojnë dhe miratojnë një strukturë organizative, konform funksioneve që i atribuon ligji; të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, me qëllim motivimin e punonjësve në rritjen e efektivitetit të shërbimeve që bashkia i ofron komunitetit;

14.2. Rekomandimi: Drejtorja e Burimeve njerëzore dhe e Shërbimeve të Brendshme të marrë masa të regjistrojë çdo akt administrativ të miratuar konform akteve ligjore të arkivave; për hartimin e kriterëve specifike për pozicionet e veçanta në strukturë, të cilat kërkojnë arsimin profesional përkatës apo certifikatë profesionale; të shpallë në portalin e punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Dropull, vendet vakante dhe për pozicionet me Kod pune; të caktojë në strukturën organizative pozicione për kategorinë “grup i veçantë”; plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin përkatës, për të rritur performancën e shërbimeve dhe arritjen e objektivave institucionale në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për sa më sipër në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Bashkia Dropull ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:

a. Masa Organizative janë lënë **10** Rekomandime që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat rikërkohet **3** masa të pazbatuara;

b. Masa për Uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat e munguara) në bashkinë Dropull është lënë 1 rekomandim i cili rikërkohet si i zbatuar pjesërisht në vlerën e mbetur deri më 31.12.2022 prej 8,772,214 lekë për 1114 debitorë;

c. Masa shpërblim dëmi është lënë 1 masë (e rikërkuar) në vlerën 3,419,505 lekë dhe rikërkohet në vlerën e saj të plotë si e zbatuar pjesërisht (në proces gjyqësor);

Ligji nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 gërma j; Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 119-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 518/18 prot., datë 08.09.2022 si dhe Akt Verifikimit nr.1 të datës 23.03.2023, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga sa më lart, Grupi i Auditimit të KLSH-së rikërkon si më poshtë vijon:

A. Masat Organizative

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të plotë të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale në Bashkinë Dropull të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit.

Menjëherë

4.1 Rekomandim (rikërkuar): Titullari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe menaxhimin të Aseteve të marrë masa menjëherë për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmerë të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat “Toka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Dropull më 31.12.2020.

Menjëherë

B. Masa shpërblim dëmi

11.1 Rekomandim (rikërkuar): Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Dropull të vazhdojë ndjekjen e të gjitha shkallëve të proceseve gjyqësore për arkëtimin e dëmit në vlerën 3,419,505 lekë.

Menjëherë

C. Mas a për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për të ndjekë të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve deri më datën 31.12.2022 prej 8,772,214 lekë për 1114 taksapaguese privat dhe familjarë.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **939,037 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”, me vlerë 247,136,960 lekë me TVSH, fituar nga JV “R.....A T.....U” & “SH....I” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²”, “Zëri 3(2.47/An) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën **185,561 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 760 prot., datë 06.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “R.....U” & “SH....I” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 108-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **185,561 lekë pa TVSH** nga JV “R.U” & “SH. I” shpk, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”.

Brenda datës 31.12.2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” Bashkia Dropull, me vlerë 142,830,639 lekë me TVSH, fituar nga OE “K....N” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²”, “Zëri 3(2.47/An) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën **313,500 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 793 prot., datë 11.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe OE

“K...N” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 108-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **313,500 lekë pa TVSH** nga shoqëria “K...N” shpk, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 793 prot., datë 11.05.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat” Bashkia Dropull.

Brenda datës 31.12.2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Derviçan,” Bashkia Dropull, me vlerë 79,129,675 lekë me TVSH, fituar nga JV “E...I” & “B.....S” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.87/a) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shk. në tokë” dhe, “Zëri 2(47/an) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën **260,786 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1502 prot., datë 19.08.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “E...I” & “B.....S” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 108-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **260,786 lekë pa TVSH** nga JV “E...I” & “B.....S” shpk, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1502 prot., datë 19.08.2020, me objekt “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Derviçan, Bashkia Dropull”.

Brenda datës 31.12.2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ujësjellësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II” Bashkia Dropull, me vlerë 393,039,116 lekë me TVSH, fituar nga JV “E...I” & “B.....S” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërin e punëve: “Zëri 1(3.124/1a) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zingjir” në vlerën **179,190 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 962 prot., datë 04.06.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “B.....S” & “2-T” & “V....A” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 108-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **179,190 lekë pa TVSH** nga JV “B.....S” & “2-T” & “V....A” shpk, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 962 prot., datë 04.06.2020, me objekt “Ujësjellësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II”.

Brenda datës 31.12.2023

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të lartë me fond limit 419,885 mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 2 procedura me vlerë të fondit limit 269,281 mijë lekë ose 64% e vlerës së fondit limit të audituar, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.

a- *Procedura me objekt “Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar “Bularat”+kopsht Bularat,Dropull i Sipërm” zhvilluar në vitin 2022, me fond limit 58,648,181 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 53,945,123 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJ...A”.*

b- *Procedura me objekt “Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujësijellësit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan,Lugar dhe Grapsh,Bashkia Dropull”, zhvilluar viti 2021, me fond limit 210,633,067 lekë dhe vlerë kontrate 206,313,149 lekë, ku fitues është shpallur JV “R...A”, “T....U” & “SH...I” & “V....N” ShPK.*

Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 91-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë Dropull, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe vijimësi

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Dropull ushtrojnë aktivitet të tregtimit të hidrokarbureve, gjithsej **7 subjekte**. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit (autorizime) dhe pagesat e tyre në zbatim të VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.”, rezulton se autorizimet nuk lëshoheshin për periudhën 5 vjeçare, por për periudha më të shkurtër nga një deri në 5 vite.

Për 7 subjekte që tregtojnë hidrokarbure, detyrimi sipas bashkisë është 4,800,000 lekë, nga e cila është likuajduar vlera 4,022,000 lekë, **duke mbetur pa likujdim vlera 778,000 lekë, si**

ardhur e munguar, konkretisht: subjekti “B...T” shpk në shumën 130,000 lekë, subjekti “B.....O’ shpk në shumën 384,000 lekë dhe subjekti “A.....U” shpk në shumën 264,000 lekë.

Në kundërshtim me VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 54-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave vendor të marrë masa për arkëtimin e vlerave të paarkëtuara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në shumën **788,000 lekë**, respektivisht: *subjekti “B...T” shpk në shumën 130,000 lekë, subjekti “B.....O’ shpk në shumën 384,000 lekë dhe subjekti A...U shpk në shumën 264,000 lekë.*

Brenda datës 31.12.2023

3. Gjetje nga auditimi: Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Dropull dhe nga auditimi u konstatua se, totali i debitorëve me 31.12.2022 është në vlerën **10,126,180 lekë**, nga të cilat: debitorë të abonentëve familjarë në shumën 7,871,121 lekë, debitorë subjekte juridik në shumën 855,888 lekë, debitorë subjekte fizik në shumën 45,183 lekë dhe kamatëvonesa nga moslikuidimin i detyrimeve në shumën 1,353,988 lekë.

Vlera prej **10,126,180 lekë**, përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Dropull.

Në totalin e detyrimeve, konstatohet se peshën kryesore e zënë detyrimet nga abonentët familjarë, të cilat janë 75.8% e totalit të detyrimit.

Për menaxhimin e taksave e tarifave vendore, Bashkia Dropull nuk kishte aktmarrëveshje me ND. Ujësjiellës Kanalizime por me Zyrën e Postës Shqiptare.

Konstatohet se një pjesë e subjekteve të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet nga Drejtoria e të Ardhurave vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, duke u lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite. Gjithashtu dhe subjekte të cilët janë me status pasiv/ ose të mbyllur nuk kanë bërë të mundur likuidimin total të detyrimeve.

Në lidhje me masat e marra, konstatohet se në raport me vlerën e detyrimeve, nga bashkia janë marrë masa vetëm 3.4% e totalit të detyrimeve. Në krahasim me nivelin e detyrimeve në fund të periudhës, konstatohet se procedura për zbatimin e masave shtrëngues nuk është e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, ku një pjesë e masave nuk është batur. Mungon bashkëpunimi me DSHTRR, Drejtorinë ASHK Dega Gjirokastër, bllokim aktivitet, sekuestrim etj.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH:, i ndryshuar, respektivisht nenet:

-Nuk gjen zbatim neni 89-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve;

-Nenet 90-Urdhër bllokimet dhe 92-Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë, duke lënë jashtë një pjesë të konsiderueshme të tyre, por dhe subjekte me detyrime nga viti në vit;

-Neni 93-Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë dhe neni 94-Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër;

-Për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, nuk është kërkuar nga DTTV që për të gjithë subjektet të cilat janë njoftuar për pagesën e detyrimeve dhe zbatuar një pjesë e procedurave të kërkohej kallëzim penal, bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe

tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 54-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake Bashkia Dropull, të marrin masa, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **10,126,180 lekë**.

Brenda datës 31.12.2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Pyjeve dhe kullotave, rezulton se në Bashkinë Dropull operojnë me kontratë dy shoqëri të telefonisë celulare, konkretisht shoqëria “T...A” për periudhën 2.3.2019 – 2.3.2028 për vlerën 100,000 lekë/viti, e likujduar sipas mandate arkëtimeve dhe kontrata me shoqëria “V...A” për periudhën 5 vjeçare nga 21.11.2017 deri me 21.11.2022 për vlerën 450,000 lekë/viti.

Nga të dhënat, për periudhën 22.11.2021 deri me 22.11.2022 nga shoqëria “V...A” është likujduar vlera 361,250 lekë, **duke mbetur për diferencë vlera 88,750 lekë, si ardhur munguar në buxhet.**

Gjithashtu, konstatohet se në kontrata e nënshkruara:

-Nuk është përcaktuar nr. Parcelës, vendi ku ndodhet dhe kufizimet.

-Nuk është llogaritur qira per përdorim rruge per lidhjen e sipërfaqes se dhënë ne përdorim me rrjetin rrugor, për të cilën duhet të bëhet verifikimi i gjatësisë se rrugës, te llogaritet vlera e qirasë.

Veprime në kundërshtim me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Per disa ndryshime ne Vendimin nr.391, datë 21.06.2006 te KM “Per përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave”, i ndryshuar, si dhe kushteve të zbatimit të kontratës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 54-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (*Spektori i Pyjeve*), të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **88,750 lekë** ndajë subjektit “V...A”, si e ardhur e munguar.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (*Spektori i Pyjeve*), për të gjitha rastet e mos likujdimet në afat ë detyrimeve kontraktuale, në zbatim të nenit 5 të kontratës të llogariten kamatëvonesat në masën 0.01% për çdo ditë vonesë nga momenti i pagesës dhe në rast refuzimi të shlyerjes të kërkohet prishja e kontratës për mos zbatim të kushteve.

4.3. Rekomandimi: Drejtoria e Bujqësisë (*Spektori i Pyjeve*), të marrë masa që në fazën e hartimit të kontratave të reja bashkëlidhur të jetë dhe nr. parcelës ku ndodhet dhe kufizimet. Gjithashtu për kontratat e vijim të evidentohet dhe llogaritet detyrimi i qirasë për rrugën në përdorim dhe arkëtimin e detyrimit.

Brenda datës 31.12.2023

E. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Dropull**, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale për **14 punonjës, respektivisht:**

1. Z. A.T me detyrë drejtor DPZHKT bashkia Dropull

3. Z. L.K me detyrë përgjegjës i DPZHKT bashkia Dropull.

4. Z. S.E me detyrë specialist i DPZHKT bashkia Dropull

Për shkeljet e konstatuara:

- Planvendosjen e miratuar nga ana e DPZHKT bashkia Dropull nuk është respektuar distanca e objektit që do ndërtohet me kufirin e pronës, në kundërshti me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 35 Distanca e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m ($d = nr. k + 1m$) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.

- Nuk është marrë mendim nga institucionet (Agjensia e Zhvillimit të territorit ASHK, UK, ASHK) për lejet, në kundërshtim kjo me Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori, Neni 15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.

-Planvendosjen e miratuar nuk është e saktë pasi nuk ka të detajuara të gjitha elementët e nevojshëm si distancat e objektit që do ndërtohet nga objektet rreth tij si dhe numrat e kateve në kundërshtim kjo me Kushtet Teknike të Projektimit KTP (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 52-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5. Z. LL.N, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të pyjeve, livadheve dhe kullotave.

6. Z. K,M, me detyrë Specialist i Bujqësisë për tokat.

7. Z. L.N, me detyrë Specialist për administrimin e kullotave/livadhe.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Nga ana e Zyrës së Pyjeve kullotave nuk është shpallur lista e kullotave të gatshme për kullotje dhe sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja, në muajin Shkurt të çdo viti, në zbatim të kreut II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 2 të Udhëzimit të mësipërm.

- Nga ana e qiradhënësit, Bashkise, nuk janë bërë sondazhe gjatë kullotjes për të mos lejuar futjen e bagëtive në kullote jashtë kapacitetit kullor të kontraktuar, në kundërshtim me kreun III “Kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullor për kullotje”, pika 7 të Udhëzimit të mësipërm.

- Nga ana e strukturës përgjegjëse nuk është bërë verifikimi në terren nëse është zbatuar kontrata dhe nëse në parcele janë futur po aq krerë sa është lidhur kontrata, për të cilën, rekomandohet të behet verifikimi me një komision të miratuar nga titullari.

- Nuk ka bashkëpunim me AZHBR Qarku Gjirokastrë në lidhje me numrin e bagëtive të regjistruara për bashkinë Dropull.

- Nuk administrohej hartë për sipërfaqen e shfrytëzueshme.

- Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullorë, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

- Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.

-Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.

- Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.

- Nuk janë përcaktuar kriteret për dhënien me qira të tyre, nga ku kriteret prioritare si p.sh. fermerët me banim brenda territorit të njësisë, me vendndodhje afër kullotës, që mbarështojnë një numër të madh bagëtish, të atyre që shtegtojnë tufat në ekonomi të tjera kullorë e që kanë qenë të kontraktuar sezonin e kaluar.

- Mungon proces verbal i mbi tërheqjen e dokumentacionit të plotë të dhënies me qira të këtyre sipërfaqeve.

- Nuk disponohet regjistri i plotësuar me të gjitha të dhënat për të ndjekur kërkesat e kontratave të lidhura si dhe arkëtimet në vazhdimësi.

- Në kundërshtim me kërkesat e kontratës tip neni 3, pika "c", kontrate të miratuara me Urdhrin e Ministrisë të M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara", nga ana e qiradhënësit nuk është kryer asnjë kontroll periodik, për të verifikuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi token bujqësore, ato të kësaj kontrate, kriteret dhe elementet e përcaktuara në kërkesën e paraqitur prej tij pranë autoritetit qiradhënës për marrjen me qira të pasurisë.

- Nga Bashkia Dropull, nuk është dërguar informacion me shkrim, për zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Gjirokastrës, në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në dhjetor të çdo viti, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", kreu V, pika 4 Në zbatim të nevojave për "planifikimit të nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit, si dhe miratimi i tarifave të shërbimit të ujitjes", kjo në zbatim të kërkesave të ligjit nr.24/2017 datë 09.03.2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit" kreu IV, neni 15 "Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive" apo dhe neni 19 "Miratimi i tarifave", ku nga auditimi është konstatuar se:

1-Nga ana e Drejtorisë së Administrimit të ujërave, të pyjeve, të livadheve dhe të kullotave, pranë Bashkisë, nuk disponohej plani i masave për vënien në gatishmëri të veprave ujëtare dhe kulluese.

2-Nuk ekzistonte programi i ujitjes apo dhe kullimit, ku të ishin pasqyruar qarte:

- Evidentimi i kulturave bujqësore të mbjella dhe sipërfaqet përkatëse, për çdo fermer.
- Përcaktimi i nevojave për ujë për ujitje për çdo fermer.
- Hartimi i grafikut paraprak të ujitjes.
- Evidentimi i gjendjes fizike të skemave ujëtare, për dërgimin e ujit në parcela.
- Evidentimi i gjendjes fizike të kanaleve ujëtare dhe kullues.

3. Nuk është realizuar "Monitorimi" i shpërndarjes së ujit për ujitje, e konkretisht:

- Monitorimi i shpërndarjes së ujit për fermerët mbi bazën e sipërfaqes.
- Monitorimi i evidencës numrin e ujitjeve, sasinë e ujit, sipërfaqen e ujitur, për çdo fermer.
- Monitorimi i realizimit të punimeve në kullim.
- Nuk disponohet asnjë akt marrëveshjeje mes fermerëve apo dhe fshatareve me Bashkinë, mbi kërkesën që kanë për vaditje në reference të kulturave që disponojnë. Mbi bazën e se cilës do të bëhet dhe llogaritja e shpërndarjes së ujit sipas nevojave apo dhe llogaritja e detyrimit për shërbimin që do të kryhet.
- Evidenca e të dhënave mbi bazën e llogaritjes së detyrimit, nga ana e Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, është përcaktuar në sipërfaqe të mbjella, sipërfaqen e vaditur sipas llojit të vaditjes (me rrjedhje të lirë apo me ngritje mekanike) referuar tarifave të paketës fiskale (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 54-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8. Zj. M.Q me detyrë Juriste Drejtoria e Buxhetit financës,

9. Z. A.T me detyrë Drejtor PZHT.

10. Z. S.E me detyrë specialist (ing. Elektrik) Drejtoria e Shërbimit Urban.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 -Kërkesa të veçanta për kontratat e

shërbimeve dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht në praktikat:*

a- Procedura me objekt “*Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "Bularat"+kopsht Bularat,Dropull i Sipërm*” zhvilluar në vitin 2022, me fond limit 58,648,181 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 53,945,123 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJ....A”.

b-Procedura me objekt “*Rikonstruksion i rrjetit te brendshëm te ujësjellësit te Dervician, Sofratik dhe Terihat ,Bashkia Dropull*”, zhvilluar në vitin 2021, me fond limit 120,286,360 lekë dhe vlerë kontrate 119,025,533 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K....N”.

c- Procedura me objekt “*Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujësjellësit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan, Lugar dhe Grapsh ,Bashkia Dropull*”, zhvilluar viti 2021, me fond limit 210,633,067 lekë dhe vlerë kontrate 206,313,149 lekë, ku fitues është shpallur JV “R....A”, “T....U” & “SH....I” & “V....N” ShPK.

d- Procedura me objekt “*Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme ne fshatrat e Bashkise e mbrojtje malore*” zhvilluar viti 2021, me fond limit 13,352,072 lekë dhe vlerë kontrate 13,214,300 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “M....S”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11. Znj. TH.P me detyrë Drejtor Finance.

12. Z. L.K me detyrë specialist në Drejtorinë e PZHT

13. Zj. A.M me detyrë Drejtoreshë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, *konkretisht në praktikat:*

a- Procedura me objekt “*Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "Bularat"+kopsht Bularat,Dropull i Sipërm*” zhvilluar në vitin 2022, me fond limit 58,648,181 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 53,945,123 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJ....A”.

b- Procedura me objekt “*Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujësjellësit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan,Lugar dhe Grapsh,Bashkia Dropull*”, zhvilluar viti 2021, me fond limit 210,633,067 lekë dhe vlerë kontrate 206,313,149 lekë, ku fitues është shpallur JV “R....A”, “T....U” & “SH....I” & “V....N” ShPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14. Z. G.M me detyrë Specialist tek ND. Ujësjellës Dropull.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -Kërkesa të veçanta për kontratat e

shërbimeve dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

a-Procedura me objekt “*Rikonstruksion i rrjetit te brendshëm te ujësjellësit te Dervician, Sofratik dhe Terihat ,Bashkia Dropull*”, zhvilluar në vitin 2021, me fond limit 120,286,360 lekë dhe vlerë kontrate 119,025,533 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K....N”.

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, konkretisht në praktikat:

a- Procedura me objekt “*Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "Bularat"+kopsht Bularat,Dropull i Sipërm*” zhvilluar në vitin 2022, me fond limit 58,648,181 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 53,945,123 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJ....A”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 111-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

V. ANEKSET

Anekset e mëposhtme, tabelat dhe pasqyrat janë pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështje të caktuara.

Aneksi nr. 1

Materialiteti dhe faktorët e riskut për subjektin Bashkia Dropull .

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër transfertave).

Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht ne pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe

- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogaritë u vlerësua nga 0.7 deri 2; dhe

✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:

Bashkia Dropull Viti 2022 NE 000/LEKE			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	84,858	0.70	8
Sigurime Shoqërore (601)	14,297	0.70	1
Mallra e Shërbime (602)	37,762	0.70	3
Subvencione (606)	43,117	0.60	3
Princila + Interesa	-	0.60	0
Investime të brend. (230-231)	299,161	2.00	76
Te tjera transfer. korren (604)	4,551	0.70	0
Total	483,747		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	9,675		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	9,675		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	967		
Nëntotali	8,707		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	7,837		
Emërtimi i të ardhurave	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	404,163	0.70	35
Të ardhura te tresheguara	39,094	0.70	3
Të ardhurat e veta	59,697	0.70	5
Total	502,954		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	10,059		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	10,059		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,006		
Nëntotali	9,053		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	8,148		

Shënim: Te dhënat janë marra nga pasqyrat e subjektit sipas faktit dhe rakorduar me Degën e Thesarit

Aneksi 2.2.6.1

Evidenca e realizmit të të ardhurave sipas rakordimit me Degën e Thesarit Gjirokastrë

Evidenca e realizimit te te ardhurave te bashkise per periudhen Janar/Dhjetor 2022			ne 000lek	
LLOJI I TE ARDHURES	PLANI 2022	FAKTI	2022	
TE ARDHURA TAKSA VENDORE	25,923	24,683		
7020200 Taksë mbi Ndërtesat	9,500	9,339		
7002200 Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin		50		
7020100 Taksë mbi tokën bujqësore	7,800	7,889		
7035025 Takse mbi truallin	2,500	2,686		
7035005 Taksë fictie në hotel	123	121		
7035003 Taksë Ndikimit në Infrastrukturë	5,000	3,613		
7035009 Taksë Tabele	1,000	985		
7035008 Taksë Reklame				
Te ardhura nga taksat e ndara(grante)	5,320	6,675		
7029200 Taksë mbi Kalimin e Pronësisë	100			
7204100 Taksa e Rentes minerare	120	2		
7204101 Taksë Regjistrim Automietit	3,400	4,187		
7204102 Të ardhura nga të ardhurat personale	1,700	2,486		
TE ARDHURA IO TATIMORE	27,085	23,225		
7110501 Tarifë Pastrimi	12,760	12,808		
Tarifë pastrimi per familiet	5,000	4,684		
Tarifë pastrimi per biznesint	7,500	7,864		
Tarifë pastrimi per institucionet	260	260		
7035023 Tarifë Ndricimi Publik	1,000	843		
7035045 Tarife vendore per varreza	500	467		
7113011 Te ardhura nga sherbimi MNZH	200	58		
7110599 Taarifa administrative dhe rregullatore	1,975	1,975		
7035001 Tarifë Rregjistrimi Subjekt i Ri	50	67		
7035037 Tarife vendore per kontroll shfrytez territor				
7110106 Tarife Leje Transporti	100	70		
7111007 Tarife Parkimi	100	133		
7035039 Tarife vendore per leje shfrytezimi karburanteh	1,000	1,329		
7113001 Shitje e produkteve pyjore	200	227		
7109200 Oera Trualli(kullota,antena)	4,550	3,106		
7109300 Te ardhura nga shfrytezim karriera	150	27		
7109900 Te tjera te ardhura (pronet fond pjvor-kullusor)	1,600	122		
Tarife vendore per urbanistiken	1,300			
7035029 Tarife vendore per urbanistiken		175		
7035028 Tarife vendore per certifikate perdorimi		505		
7035031 Tarife vendore e sistemimeve te jashtme per leje ndertimi		30		
7035032 Tarife vendore per shqyrtim leje zhvillimi		26		
7035034 Tarife vendore per shqyrtim ose nxjerrje dosje		8		
7035038 Tarife vendore per konfirmim hartash				
7035040 Tarife vendore per leje ndertimi		143		
7035043 Tarife vendore per piketim objekti		66		
7035002 Taksë Zënie Hapësirave Publike	100			
7113099 Te tjera nga shitja e mallrave e sherbimeve(vaditje)	1,500	1,040		
TE ARDHURA TE TJERA	12,840	5,116		
7109100 Oera Toke Bujqesore	60	105		
7109600 Oera Objektesh	50	57		
7035011 Tarife shfrytezimi lendes drusore	10,000	112		
7115001 Gjoha te sistemit tatimor	200	480		
7115499 Gjoha		9		
7207010 Sponsorizime	1,000	1,662		
1161110 Te ardhura nga shitje trualli	1,500	642		
7111099 Të ardhura të tjera	30	53		
7190990 Të ardhura të tjera jo tatimore				
7780100 Garanci punimesh		1,996		
T O T A L I	71,168	59,699		

Aneksi 2.2.6.2

Regjistrin e subjekteve në total me gjithë ngarkesat fiskale në elektronik, vitet 2022

Permbledhese e debitoreve familjare ne vlere viti 2022								
Nr	Njesia Administrative Dropull I Poshtem	MBETUR DEBITORE						Shuma e debise
		TOKA	NDERTESA	TRUALI	PASTRIME	NDRICIMI	SH/V	
1	Derivician	622060	266448	8525	314400	52200	26100	1,289,733
2	Goranxi	192497	65343	2635	98400	16400	8200	383,475
3	Vanister	32611	26500	806	18000	3000	1500	82,417
4	Haskove	61221	33608	1023	37200	6200	3100	142,352
5	Dhuvjan	107160	14954	671	25200	4200	2100	154,285
6	Sofratike	84571	31613	1054	40800	6800	3400	168,238
7	Terihat	124776	46038	1736	67200	11200	5600	256,550
8	Gorice	28817	2339	93	3600	600	300	35,749
9	Frashtan	188428	67658	2232	86400	14400	7200	366,318
10	Lugar	130834	29102	837	27600	4600	2300	195,273
11	Grapsh	164507	36738	1457	56400	9400	4700	273,202
12	Vrahogoranxi	55376	4403	248	3600	1600	800	66,027
13	Gline	130711	36885,98	1426	54900	9200	4600	237,723
14	Peshkepi e Posht	43054	5794	232	9000	1500	750	60,330
15	Peshkepi e Siperm	56916	14058	558	21600	3600	1800	98,532
	Shuma	2023539	681482	23533	864300	144900	72450	3,810,204
Nr	Njesia Administrative Dropull I Siperm	MBETUR DEBITORE						Shuma e debise
		TOKA	NDERTESA	TRUALI	PASTRIME	NDRICIMI	SH/V	
1	Jorgucat	97634	54724	2054	70200	11800	5900	242,312
2	Zervat	36001	8592	403	15600	2600	1300	64,496
3	Bodrishte	99083	88416	2542	91500	15400	8500	305,441
4	Bularat	100341	85816	2666	85500	14400	7200	295,923
5	Kakavi	28529	10393	217	8400	1400	700	49,639
6	Kerra	50497	77786	2759	0	17800	8900	157,742
7	Klishar	23467	23808	837	26400	5000	2500	82,012
8	Koshovice	57156	43960	1426	51000	8600	4300	166,442
9	Vodhino	26882	13625	434	16800	2800	1400	61,941
10	Pepel	13102	18530	465	17700	3000	1500	54,297
11	Selo	34404	32778	1364	44400	7600	3800	124,346
12	Krioner	20812	12671	465	10800	3000	1500	49,248
13	Sotire	9732	70866,2	2945	104400	18000	9000	214,943
14	Llongo	24928	30978	806	24000	4000	2000	86,712
15	Llovine	31632	24866	868	33300	5600	2800	99,066
16	Likomil	5569	7490	279	10800	1800	900	26,838
17	Vrisera	22513	21699	248	26100	4400	2200	77,160
18	Ajnikolla	15299	6624	124	4800	800	400	28,047
	Shuma	697,581	633,622	20,902	641,700	128,000	64,800	2,186,605
Nr	Njesia Administrative Pogon	MBETUR DEBITORE						Shuma e debise
		TOKA	NDERTESA	TRUALI	PASTRIME	NDRICIMI	SH/V	
1	Catiste	249786	131753	5084	52800	38400	19200	497,023
2	Hilomo	82654	65690	1767	20400	13800	6900	191,211
3	Mavrojero	60266	0	0	0	0	0	60,266
4	Polican	64730,7	79118	3224	36000	24800	12400	220,273
5	Skore	168565	101000	3813	33600	28200	13600	348,778
6	Sopik	196410	86931	3937	42000	30200	15100	374,578
7	Seicke	75701	63183	1922	16800	16400	8200	182,206
	Shuma	898,113	527,675	19,747	201,600	151,800	75,400	1,874,335
Nr	Bashkia Dropull	Toka	Ndert	Truall	Pastrm	Ndririm	Sh/V	Shuma
1	Dropull I Poshtem	2023539	681482	23533	864300	144900	72450	3,810,204
2	Dropull I Siperm	697581	633622	20902	641700	128000	64800	2,186,605
3	Pogon	898113	527675	19747	201600	151800	75400	1,874,335
	TOTAL BASHKIA	3,619,233	1,842,779	64,182	1,707,600	424,700	212,650	7,871,144

Anekse që i përkasin të dhënave analitike të pasqyrave të Bilancit kontabël të Bashkisë Dropull për periudhën e vitit ushtrimor 2022.

Aneks nr. 3.1

Llogaria ekonomike 212“Ndërtime konstruksione” të Bashkisë Dropull në 31.12.2022, sipas inventarit.

Nr	E m e r t i m i	Vlera ne leke
1	Shkolla 8/vjeçare Jergucat	3,704,391
2	Shkolla 8/vjeçare Zervat	25,000
3	Shkolla 8/vjeçare Bularat	3,775,108
4	Shkolla 8/vjeçare Bodrishte	300,000
5	Shkolla 8/vjeçare Kerre	45,000
6	Shkolla 8/vjeçare vrisera	150,000
7	Shkolla 8/vjeçare klishar	1,189,781
8	Shkolla 8/vjeçare Sotire	200,000
9	Shkolla 8/vjeçare koshovice	23,000
10	Shkolla fillore Vodhino	20,000
11	Shkolla 8/vjeçare Kakavi	583,919
12	Shkolla fillore Selo	30,000
13	Shkolla fillore Pepel	45,000
14	Shkolla mesme Llongo	300,000
15	Shkolla fillore Llovine-poshtme	1,214,272
16	Shkolla fillore Llovine-siperm	15,000
17	Shkolla fillore Krioner	20,000

Nr	E m e r t i m i	Vlera ne leke
18	Kopshti I femjeve-Bodrishte	20,000
19	Kopshti I femjeve-Kakavi	20,000
20	Zyrat e vjetra te Komunes	18,000
21	Zyrat e reja te Komunes	57,200
22	Zyrat e Komunes (spitali Vrisera)	9,465,503
23	Ambulanca Selo	10,000
24	Ambulanca Jergucat	1,574,445
25	Ambulanca Zervat	585,292
26	Banjat e shkolles –Bularat	896,585
27	Vatra e kultures-jergucat	2,460,727
28	Zyrat e kryepjegesise - Sotire	299,967
29	Ambulanca Pepel	728,698
30	Ambulanca Bodrishte	594,165
31	Kopshti Bularat	3,808,548
32	Vatra e kultures Bodrishte	4,285,512
33	Banjat Vrisera	910,710
34	zyra e keshillit Llovine	497,672
35	Vatra e kultures Llovine	581,770
36	Zyra e keshillit Kerre	594,569
37	Ambulanca Vodhino	282,815
38	Ambulanca Kakavi	1,012,169
39	Zyrat Ajnikolla	3,042,082
40	Mulliri Selo	290,700
41	Zyrat Krioner	189,000
42	Zyra Vodhino	516,097
43	Vatra e kultures Llongo	3,167,757
44	Vatra e kultures Zervat	6,919,111
45	Vatra e kultures Pepel	2,516,600
46	Vatra e kultures Kerre	465,822
47	Q.shendetesore Likomil	1,965,199
48	Q.shendetesore Klishtar	877,248
49	Vatra e kultures Koshovice	4,957,903
50	Vatra e kultures (shkolla Llovine)	1,233,434
51	Vatra e kultures (shkolla Selo)	3,898,886
52	Vatra e kultures (shkolla Bodrishte)	3,844,745
53	Zyra e kryesise fshati Llongo	474,098
54	Qendra multifunkionale sherbimesh - blerje godine	100,138,548
55	Garazh per mjetet e MZSH,Vrisera	1,526,656
56	Ndertim Lera Bulerat-sotire-Bodrishte	38,000
57	Vatra Kultures Grapsh	2,525,094
58	Vatra Kultures Lugar	1,978,454
59	Vatra Kultures Frashtan	2,606,000
60	Vatra Kultures Gorice	458,300
61	Vatra Kultures Gline	1,086,654
62	Zyrat Komuna	15,079,844
63	Dhome Roje Komune	168,012
64	Lapidari Dervician	169,200
65	Qendra fshati Goranxi	692,208
66	Qendra fshati Haskove	347,028
67	Qendra e fshatit Terihat	1,804,746
68	Ambulanca Dervician	1,482,722
69	Ambulanca Goranxi	1,557,719
70	Ambulanca Vaniste	1,549,804
71	Ambulanca Frashtan	15,000
72	Ambulanca Frashtan	161,100
73	Ambulance Dervician 2	4,080,557
74	Shkolla e mesme Dervician	22,580,606
75	Shkolla 8-Vjecare Goranxi	2,036,392
76	Shkolla 8-Vjecare Sofratike	7,528,022
77	Shkolla 8-Vjecare Peshkepi	50,000
78	Shkolla 8-vjecare Radat	409,806
79	Shkolla 8-vjecare Gline	50,000
80	Shkolla 8-Vj. Vrahogoranxi	20,000
81	Shkolla fillore Dervician	6,135,370
82	Shkolla fillore Vaniste	37,000
83	Shkolla fillore Haskove	20,000
84	Shkolla fillore Grapsh	40,000
85	Kopshti Terihat	50,000
86	Kopshti Gline	15,000
87	Rrethimi I kopshtit Dervician	694,776
88	Monument kulture Dervician	234,660
89	Rikonstruksion Shkollat	2,195,532

Nr	Emertimi	Vlera ne leke
90	Rikons.shkollat,kopshti dervician dhe ambulanca Frashtan	6,717,055
91	Rikonstruksion shkolla e vjeter Dervician(Sociale-e)	1,606,419
92	Shkolla polican	11.855.318
93	Shkolla catiste	3.948.108
94	Kjoske per stacionin pyjor pogon(konteiner)	474.000
95	Gjelberim e mbeshetje pemtarie	2,036,418
	Shuma	280,903,628

Burimi: Bashkia Dropull

Aneks nr.2 :

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”

Nr	Emertimi	Vlera ne leke
1	Ura Dervician	3,977,239
2	Ura Rruge Grapsh	3,060,757
3	Rruge Terihat	5,569,230
4	Rruge Gorice	289,978
5	Rruge Goranxi	337,779
6	Rruge Dervician	767,232
7	Rruge ne fshatrat e Dropullit	13,005,581
8	Rruge ne fshatrat e Rrezes	5,152,296
9	Rruge sheshe Komuna	4,842,224
10	Qendra Sofratike	762,262
11	Qendra Frashtan	897,712
12	Prite beto Sofratike	136,390
13	Lapidari Gline	206,610
14	Ndricim rruge Dervician	300,000
15	Perroi Grapsh	1,509,400
16	Sistem Perroi Dervician	32,826,134
17	Rruga hyrese Dervician	31,373,400
18	Prita Proi Dhuvjan	447,800
19	Rik.Varezat Vaniste	802,977
20	Rik.Varezat Frashtan	322,503
21	Rik.Varezat Goranxi	465,570
22	Rik.Rruga P/Poshtme-P/Sip	11,350,880
23	Riveshje e aksit rrugor Grapsh-Gline dhe rik.rruga P/Poshtme- P/Siperme	58,906,860
24	Rik.rruge ne disa fshatra I	4,445,840
25	Varrezat Grapsh	960,600
26	Rikonstruksion I rrugeve te brendshme ne fshatrat e Bashkise e mbrojtje malore (likomil,dervician terjehat,krioner,koshovice,kaakvi,bulerat,goranxi	26,114,155
27	Rruga Llongo – Vrisera(asfaltim)+tek rapishtet386397	24,091,871
28	Rruga e fshatit Zervat(asfaltim)	6,889,500
29	Rruga Kerre (rikonstruksion)	575,134
30	Urta Krioner (rikonstruksion)	779,977
31	Qendra Kakavi (asfaltim)	686,624
32	Rrug Krioner-Llongo(rikonstruksion)	3,106,637
33	Rruga Vodhino	10,708,103
34	Rruga Vrisera-Pepel (tombino)	5,244,817
35	Rruga Jerg-Zerv-Bul-Vrisera	298,036
36	Rruga Bodrishte-Vrisera	296,993
37	Ndertim ura Likomil	2,030,530
38	Prita malore Jergucat	804,348
39	Ndertim ura Bodrishte	262,124
40	Ristruksion I Qendres Bodrishte	109,200
41	Rrethim varrezat -Koshovice	99,408
42	Rrethim fusha sportive Vrisera	738,000
43	Ristruksion I Qendres Bularat	381,223
44	Rruga Pigadhi-Selo	299,071
45	Ndertim rruga-ura Likomil	710,199
46	Prita malore Zervat	758,674
47	Rruga Krioner-Koshovice-Selo	2,276,653
48	Ruga Ajnikolla	368,643
49	Ure lumi-Selo	598,422
50	Ura Koshovice-tombino	299,868
51	Kend lodrash-Jergucat	551,361
52	Rregullim qendra-Vrisera	1,065,055
53	Fusha sportive - Jergucat	996,528
54	prita malore Krioner	584,986
55	prita malore Sotire	357,038
56	rruga fshati Vrisera-fshati Llongo	418,663

Nr	Emertimi	Vlera ne leke
57	rruga fshati Krioner-fshati Sotire	290,067
58	Rikostruksion rruga Bodrishte - Vrisera	18,730,779
59	Qendra Krioner	284,892
60	Fusha Bularat - Bodrishte	1,487,680
61	Rruge te brendeshme Jergucat	3,506,701
62	Rruge te brendeshme Vrisera	1,229,693
63	Qendra Koshovice	280,000
64	Qendra Klishar	805,202
65	Qendra Kerre	974,411
66	Qendra sportive Bularat	5,181,418
67	Rruga Likomil-Selo	16,861,763
68	Ura Llovine	452,244
69	Prita malore Kakavi	377,977
70	Rruga Kakavi	1,499,764
71	Rruga Kerre	10,935,916
72	Ura Likomil	2,629,720
73	Ura bejli nga ushtria - vrisera	1,544,652
74	Rikostruksion Rruge ne fshatrat e Bashkise	41,515,644
75	Kanali ushqyes rezervuari Pepel	3,745,750
76	Finacim projekt BE(rruga Peshkopi)	4,010,000
77	Ndertim Lera Bulerat-Sotire-Bodrishte	2,215,007
78	Rikonstruksion ura Llongo	17,373,931
79	Pagese per projektin Extrovert (restaurim I rrugete hyrese te kisha bizantine lindjesHyjlindese ne peshkepine e poshtme dhe fshatin Radat)	14,904,360
80	Rrikonstruksion rruge te brendshme hyrja Vrisera	19,264,872
81	Mbrojtja e rrugete me gabion ne peroin e Selose dhe muri mbajtes ne Koshovice	451,777
82	Rruga ne fshatin Bulerat(Extrover road extention"	46,721,497
83	Rruga ne fshatin Bodrishte (Extrover road extention")	11,334,669
84	Qendra e fshatit,fusha e sportit polican dhe fusha e sportit skore	4,647,811
85	Rikostruksion rruga Sopik	4,966,623
86	Rikostruksion rrugeve Pogon	3,580,200
87	Rikostruksion rrugeve Pogon	4,343,944
88	Rikonstruksion I pjeshem I rrjetit rrugor Pogon	
89	Unaza Pogon	22,175,593
90	Unaza Pogon	116,572,802
91	Ura bejli nga ushtria - e Zalos	4,855,274
92	Ujesjellesi nga burimi I Manxifes & rikonstruksioni I ujesjellesit te fshatrave Selo,Llovine,Krioner,&sotir	175,569,770
93	Rehabilitimi I digave te ujembledhesve te bashkise dropull (fshati Kakavi,Likomil,Peshkopi,Bodrisht)dhe kanali ujites irezervuarit te Peshkopise	36,432,136
94	Nderhyrje ne stacionet e Pompave e kabinave elektrike(Peshkopi e siperme dhe e poshtme)	480,000
95	Furnizimi me uje nga pus shpimet I ujesjellesit rajonal dropulli I poshtem dhe rrjeti shperndares I ujesjellesit te fshatrave Goranxi dhe Dervician,Bashkia dropull	95,923,950
96	Rikonstruksioni I rrjeteve te brendshme te Ujesjellesit te fshatraveZervat, Vanister,Haskove,Dhuvjan,Gorice,Frashtan ,Lugar dheGrapsh.Bashkia Dropull	81,488,874
97	Rikonstruksion I rrjetit te brendshem te Ujesjellesit te Dervicianit,Sofratike dhe Terjehat t,Bashkia Dropull	49,379,900
	Shuma	1,108,312,353

Burimi: Bashkia Dropull.

Aneksin nr.3

-Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune"

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
1	Kosha plehrash 2014	757,918
2	Sistem fotovoltai	1,218,532
3	Sistem kamera ,syurvejimi	886,683
4	sistem ndricimi	754,468
5	paisje laborator	450,200
6	Dere hekuri	27,724
7	makine prerese gardhesh(2021)	58,560
8	makone prerese bari traktor(2022)	83,531
9	Deck tavolina(prog)	47,048
10	Chair (karrige)	87,300

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
11	Desk chair(tavoline)	23,280
12	PC(softëare&hardëare)kompjuter	392,882
13	Note book(table)	160,063
14	Screen(ekran)	72,756
15	Projektor&surface	203,717
16	Studio	291,024
17	Monitors	436,536
18	Consola	480,190
19	Softëare	218,268
20	Cabling& speakers	247,370
21	Microphones	378,331
22	Infokiosk(pike infomimi elektronik)	756,662
23	Projekt.trilling broshure	272,835
24	Repertetori i Kakavise	534,400
25	Repertetori Sotire	502,131
26	Motoshare 2017	92,760
27	Depozite plastike 500 lit	12,000
28	kompresor ajri 100l+tub ajri+mates	33,000
29	Feneline ndricuese	29,000
30	aparat MZZH	248,400
31	fikse Zjarri	24,000
32	motpompe thithese	108,000
33	Makine Korrese bari profesionale (2021)	194,040
34	motoshare per dru profesionale(2021)	92,880
35	makina prerese gardhesh(2021)	117,120
36	helmete te kompletuara(2021)	64,800
37	Allen Tuf celesash me 6c seti(2021)	7,200
38	celsa fiso poligoni 26 cop(2021)	22,800
39	pomp lavazi+pistol+llastik 10m(2021)	79,200
40	kondicioner 24BTU	153,400
41	kondicioner 12BTU	58,800
42	kondicioner 18BTU	113,400
43	kondicioner 18BTU	113,400
44	kondicioner 18BTU	113,400
45	kondicioner 12BTU	93,400
46	kondicioner 18BTU	113,400
47	kondicioner 12BTU	93,400
48	kondicioner 12BTU	93,400
49	kondicioner 12BTU	93,400
50	kondicioner 9BTU	93,400
51	kondicioner 9BTU	58,800
52	Makine Korrese bari profesionale(2021)	64,680
53	Karrige trajnimi	378,432
54	Karrige zyre	105,120
55	Tavolina zyre	294,336
56	UPS per kompjuter	142,963
57	Printer bardh e zi	112,128
58	Printer me ngjyra	84,096
59	Kompjuter deskop	588,672
60	Videoprojektor	140,160
61	Siperfaqe projektimi	49,056
62	Frigorifere profesionale	700,800
63	Mobilje dru xham	560,640
64	Kondicjone 18000 BTU	238,272
65	Kondicjone 24000 BTU	91,104
66	Kondicjone 12000 BTU	378,432
67	Rafte	213,043
68	Karrige	145,766
69	Tavolina zyre	332,179
70	Tabela sinjalizimi	100,915
71	Tapet	60,269
72	Instal. Elektrike	472,339
73	Kompjuter zyre	1,093,248
74	Projektor	672,768
75	Televizor + DVD	322,368
76	Televizor	433,094
77	Ruter EIFI	84,096
78	Printer Lazer scan	140,160
79	USB+ PREZANTIM	84,096
80	Makina korese bari profesionale	129,360
81	Makina prerese gardhesh	58,560

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
82	Helmete te kompletuara	86,400
83	Allen tuf celesash me 6 cope seti	7,200
84	Celsa fiso poligoni 26 cop	22,800
85	Freze mekanike	120,384
86	Korrese bari	59,584
87	Pompe elektrike per ujitje	24,198
88	Pompe uji	800,000
89	Motor	600,000
	Shuma	21,650,930

Burimi: *Bashkia Dropull*

Aneks nr.4

-Llogaria 218 "Inventar ekonomik"

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
1	Set sallon 3 cope (2018)	120,000
2	Karrigee rrotulluese lekure(2018)	24,000
3	tavoline L (2018)	54,000
4	Varrese rrobash(2018)	3,960
5	Karrige personeli(2021)	108,000
6	shtese tavoline(2021)	24,000
7	dollap komodine(2021)	18,000
8	KonpjuterA1027 Lenova11710700T16GBPCHP2901318 Gb(2021)	186,000
9	Biblioteke me 5 pjese +tavoline e rumbullakte	60,000
10	Karrike salle(me hekur bazamenti)(2018)	518,400
11	shtese tavoline (tek e rumbullakta)(2018)	12,000
12	Proxhektor(2018)	48,000
13	Tavoline kompjuteri	35,000
14	Aerongrohese	6,000
15	Varrese rrobash(2018)	3,960
16	tavoline zyre (2018)	65,280
17	Komodine me celes(2018)	34,800
18	Karrike rrotulluese dhermatini(2018)	65,280
19	Dollape zyre (2pjese)(2018)	38,160
20	Kuti me vrime per hartat(2018)	4,800
21	Mbeshtetese printeri(2018)	3,600
22	Dollap rafte (7 cope)(2018)	21,000
23	SKANER	30,800
24	monitor(2020)	17,790
25	monitor(2020)	17,790
26	Konpjuter hp290G3mti1391004GB PCHP4214q monitor(2021)	69,000
27	Kompjuter inxhinjerik komplet-2017	78,000
28	konpjuter hp(2020)	102,150
29	konpjuter hp(2020)	102,150
30	prinder MFCJ 4620 (2018)	28,200
31	Karrike levizese(2015)	15,000
32	Tavolina Zyre	16,320
33	Mbeshtetese printeri	3,600
34	Karrige	5,700
35	Konpjuter dell	66,623
36	Fotokopje MFPC6525	63,394
37	Skaner Canon lide 120	17,400
38	Varrese rrobash(2018)	3,960
39	Tavolina zyre(2018)	38,400
40	Tavoline zyre(2018)	16,320
41	Komodina me celes(2018)	26,100
42	Karrike rrotulluese me dhermatini(2018)	48,960
43	Dollap zyre(2018)	57,240
44	Rafte dollapi (me 2 pjese)(2018)	6,000
45	Tavoline(2021)	16,320
46	karrige(2021)	16,320
47	printer multifunksional Brother(2021)	40,800
48	Printer	16,200
49	konpjuter	69,600
50	Kompjuter Dell (dhurate)	66,623
51	Printer Lemaks(2019)	19,200
52	konpjuter Zyre240Gb+1tb+monhp24290131863(2021)	88,800

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
53	Varrese rrobash(2018)	3,960
54	Tavolina zyre(2018)	19,200
55	Komodina me celes(2018)	8,700
56	Karrike rrotulluese me dhermatini(2018)	16,320
57	Dollap zyre(2018)	76,320
58	Rafte dollapi (me 2 pjese)(2018)	6,000
59	Tavoline zyre(2018)	16,320
60	komodine me celles(2018)	8,700
61	Karrike rrotulluese dhermatini(2018)	16,320
62	tavoline zyre	16320
63	komodine me celes	8700
64	Tavoline zyre(2018)	16,320
65	komodine me celles(2018)	8,700
66	Karrike rrotulluese lekure(2018)	16,320
67	Komjuter Dell (dhurate)	66,623
68	Konpjuter Zyre(2020)	75600
69	Konpjuter Zyre	75184
70	Printer(2020)	19200
71	Varrese rrobash(2018)	3,960
72	Tavoline zyre(2018)	19,200
73	komodine me celles(2018)	8,700
74	Dollap zyre(2018)	38,160
75	Skaner Kanon	17,400
76	Konpjuter zyre(2019)	72,000
77	Llap top komjuter s-7200,8gb,15,6"	71,009
78	Printer hp-laser	23,000
79	Varrese rrobash(2018)	3,960
80	Tavoline zyre(2018)	32,640
81	komodine me celles(2018)	8,700
82	Karrike rrotulluese lekure(2018)	17,400
83	Dollap zyre(2018)	32,640
84	Mbeshtetese printeri	3,600
85	Fotokopje MFPC6525	63,393
86	Koke konpjuteri Accer Veriton dhe ekran AceV226HQL(2018)	58,100
87	Konpjuter Zyre(2019)	72,000
88	Karrike rotulluese dhermatini	16,320
89	Paisje internet (2020)	34,000
90	Koke kompjuteri 3290+ekranLCR21+maus+tastjereHP Z210	75,600
91	Sobe gazi	19,500
92	Sallon(dysh,tresh,pufke+tavoline vogel)+mbesht.muri+tavoline e madhe+bibliotek	80,400
93	Condicioner	88,500
94	Gjenerator	381,600
95	Condicioner	65,000
96	Stabilizator	22,000
97	Stabilizator	26,000
98	Dollap	65,000
99	Sobe gazi	17,500
100	Kondisioner	65,000
101	tavoline lustro	19,200
102	Karrike blu	8,599
103	Kondicioner	118,600
104	fotokopje MFP kyosera fs 6525	35,438
105	kompjuter (koke,ekrani,maus,tastjere)(2018)	58,100
106	Dollap lluster	27,600
107	dollap	42,000
108	karrike blu(2015)	8,599
109	Tavoline pune	12,400
110	Varrese robotin(2018)	3,960
111	Karrike rrotulluese(2018)	16,320
112	Dollap biblioteke	32,400
113	Tavolina pune	17,280
114	Komodina	4,200
115	Karrike(2014)	2,400
116	tavoline lluster	20,080
117	Komodina	4,200
118	Tavolina pune	17,280
119	fotokopje MFP KYOSERA	35,438
120	ACERRMMTOAEE001415037B34201(konpjuter)	71,500
121	printer(2020)	22,200
122	konpjuter Pc deskop(2022)	88,920

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
123	konpjuter	75600
124	Karrike rotulluese dhermatini	16,320
125	Rafte dollapi	6,000
126	Varrese rrobash	3,960
127	Frigorifer(2019)	19,200
128	Aparat Fotografik(2020)	126,000
129	Dron(2020)	101,880
130	Piktura 2 pjese	8,400
131	fotokopje MFP kyosera fs 6525	63,394
132	Biblioteke KR 090409(2018)	26,400
133	Llap top	71,008
134	konpjuter zyre(2020)	75,600
135	printer	19,200
136	Tavoline	23,640
137	karrike rrotulluese	10,800
138	Aparat fotokopje xerox /5021	42,000
139	Aerongrohese	6,000
140	dollap	81,600
141	tavoline	12,400
142	dollap lluster(2015)	16,560
143	Kompjuter DELL komplet	147,293
144	Kompjuter Lenovo PS	135,695
145	Varrese rrobash(2018)	3,960
146	Tavoline zyre(2018)	16,320
147	komodine me celles(2018)	8,700
148	Karrike rrotulluese dhermatini(2018)	16,320
149	Dollap zyre(2018)	38,160
150	komodine	4,200
151	Tavoline zyre(2018)	16,320
152	printer	48,867
153	Kompjuter Zyre(2020)	83,723
154	Varrese rrobash(2018)	3,960
155	Tavoline zyre	16,320
156	komodine me celles	8,700
157	Karrike rrotulluese dhermatini	16,320
158	Dollap zyre	57,240
159	Mbeshtetese printeri(2018)	3,600
160	Rafte metalike(2018)	189,000
161	karrike drejtuesi(2021)	16,320
162	tavoline pune	16,320
163	fotokopje MFP kyosera fs 6525(2018)	63,394
164	Kompjuter dell optilex (2018)	66,623
165	Kompjuter dell optilex (2018)	66,623
166	Motoshare 2013	57,800
167	Korse bari	19,500
168	Korse bari CG-411- 2016	42,720
169	fikse zjarri	12,000
170	Tavoline lluster	12,400
171	Dollap	36,600
172	Tavoline	22,048
173	Dollap fotokopje	26,600
174	Set treshe karrike per koridorin(2018)	32,400
175	Vitrine per kostumet popullore(2018)	30,000
176	Dollap Zyre	19080
177	Tavoline e madhe lluster	182,400
178	Tavoline lluster	20,080
179	karrike rrotulluese dhermatini(2018)	16,320
180	Komodine me celes(2018)	8,700
181	Dollap	75,860
182	karrige	3,500
183	karrige	2,400
184	Dollap	74,880
185	Karrige blu	17,198
186	printer me ngjyra(2020)	301,695
187	Kompjuter (2020)	244,943
188	Aerongrohese	6,000
189	Dollap llustro	70,000
190	dollap bibliotek	132,000
191	komodine	4200
192	Tavolina	30,426
193	Tavoline pune	18,000

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
194	Tavoline kompjuteri	6,000
195	tavoline	24,000
196	tavoline	19,200
197	Barele trasport per te plagosurit(2020)	12,194
198	Shkalle alumini treshe(2020)	28,046
199	Gjenerator 2.5 KË(2020)	29,266
200	troho preze "bosh"(2020)	9,146
201	Motoshare me benzine(2020)	42,679
202	kompjuter zyre komplet(2018)	68,400
203	Printer Samsung ml 1665	22,000
204	konpjuter	87,800
205	konpjuter Pc destop(2022)	88,920
206	printer	20,400
207	Karrike blu(2015)	8,599
208	Karrike	2,400
209	Tavoline kompjuteri	25,000
210	Konpjuter Zyre	58,100
211	printer(2020)	22,200
212	Konpjuter Zyre	69,000
213	Kopjuter(dell optiplex3080toner+ekran)	76,714
214	konpjuter	75,600
215	Dollap biblioteke	32,400
216	Tavoline pune	17,280
217	Varrese rrobash	3,960
218	komodine me celles	8,700
219	Karrike blu(2015)	8,599
220	karrige rorulluese lekure	16,320
221	Tavolin zyre(2021)	16,320
222	Konpjuter zyre(2019)	69,600
223	Printer(2019)	18,240
224	Konpjuter zyre	75,600
225	printer Hp148 DË	21,480
226	Kopjuter(dell optiplex3080toner+ekran)	76,714
227	Printer(brodherMfC22752DV)	63,600
228	Dollap Zyre	19,080
229	Tavoline pune	17,280
230	karrike blu	8,599
231	karrige	2,400
232	Dollap Zyre(2021)	22,080
233	karrike personeli(2021)	16,320
234	karrige drejtuesi(2021)	16,320
235	komodin(2021)	8,700
236	tavolin(2021)	16,320
237	karrige drejtuesi(2021)	16,320
238	tavolin(2021)	16,320
239	komodine(2021)	8,700
240	Tavoline zyre (2021)	16,320
241	DVR8chenel+IP4k(kamera) (2019)	19,200
242	Konpjuter zyre(2019)	83,600
243	printerADVACED Lexmark 2442(2021)	19,800
244	tavoline lluster(2021)	20,040
245	konpjuter Zyre+ekran	50,500
246	Kondicioner	83,000
247	Tavolina harkore	18,000
248	Etazher	8,400
249	Komodina	8,400
250	Dollap biblioteke	84,600
251	Kolltuqe meshini	84,600
252	Tavoline salloni	8,400
253	Karrike rrotulluse	20,000
254	Karrike me sfungjer	28,800
255	Printer Toshiba e Studio 383	16,200
256	Dollap Biblioteke	37980
257	Komodina	4200
258	Karrike	3900
259	Varrese rrobash	3960
260	Kopjuter(dell optiplex3080toner+ekran)	76714
261	Printer(brodherMfC22752DV)	63600
262	koke kompjuter AGF+ekranLRC21+Tastjere universale+ maus	75,600
263	Printer lex mark MS 312 DN	28,560
264	Kompjuter zyre (2018)	68,400

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
265	Printer (2018)	20,400
266	Komjuter Dell(2018)	66,623
267	Tavoline	34,560
268	Dollap bibliotek	37,980
269	Komdina	8,400
270	Karrike	7,200
271	Tavoline	34560
272	Komodina	8400
273	Karrike	3300
274	Karrike	2400
275	dollap etazhjer	36600
276	Piktur kompozimi	40,000
277	Karrike	4,800
278	Biblioteke me rafte	4,680
279	dollap	12,000
280	Konpjuter zyre)(2019)	69,600
281	Tavoline pune	17280
282	Komodina	4200
283	Tavoline pune kendor	78500
284	Tavoline pune	23600
285	Dollap	27600
286	Dollap	32400
287	Komodine	4200
288	Karrike	4800
289	F.V.Sistem alarmlokal	30000
290	Karrike rrotulluse	10800
291	Karrike pune rrotulluse	13000
292	Kasaforte	47760
293	Kasaforte metalike	30000
294	Tavoline pune	17280
295	Printer HP laserjet3005d	60000
296	Printer Lexmark t/652.....T654/36768	36768
297	Kompjuter Aser	75184
298	Tavoline pune	78500
299	Tavoline pune	17280
300	Karrike rotulluse	10800
301	Karrike Druri	7000
302	Priter HP lazer	60000
303	komodine	4200
304	bateri	3360
305	transformator	35417
306	Kompjuter	75,182
307	Karrike hekuri	36,800
308	Karrike druri	42,000
309	Karrike levizese	16,000
310	Tavolina te medhaja	97,000
311	Tavolina pune	34,560
312	Kasaforte hekuri	15,500
313	Dollape druri	113,200
314	Mbajtese rrobash	8,200
315	Komodine	6,200
316	Sobe me gaz	19,500
317	Tavolina pune	81,612
318	Karrike hekuri	8,800
319	Karrike druri	9,200
320	Komodina	12,400
321	Kompjuter	96,876
322	Fotokopje	65,000
323	Dollap hekuri madh	88,788
324	Dollap druri	56,600
325	Sobe me gaz	19,500
326	Sobe me gaz	19,500
327	Karrike levizese	16,000
328	Karrike druri	7,000
329	Tavolina pune	34,560
330	Komodina	16,400
331	Kompjuter komplet	97,800
332	Dollap druri	36,600
333	Dollap hekuri madh	88,788
334	Dollape druri	36,600
335	Tavoline pune	23,600

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
336	Kasaforte hekuri	47,760
337	Tavoline pune	78,500
338	Tavoline pune	17,280
339	Karrike rotulluese	10,800
340	Karrike Druri	7,000
341	Priter HP lazer	60,000
342	komodine	4,200
343	bateri	3,360
344	transformator	35,417
345	Kompjuter	216,557
346	Njesi qendrore konpjuter+inverter	75,182
347	Tavoline pune	23,600
348	Kasaforte hekuri	47,760
349	Rrjeta volejboli	6,000
350	Tavolina te reja set	364,800
351	Fikse zjarri	12,000
352	Kasaforta	30,000
353	Tavolina zyre	160,320
354	Tavolina zyre	52,800
355	Soba druri	86,400
356	Soba druri	27,000
357	Soba druri(2019)	100,080
358	Printer H-P148DE(2022)	21,480
359	U.p.s	48,308
360	Rack	4,567
361	mjete didaktike	120,080
362	mjete didaktike	367,800
363	Dollap per informatik	23,341
364	Tavoline mesuesi	10,240
365	Tavoline nxenesi	67,319
366	Karrike rrotulluese	12,318
367	Llap top	40,000
368	Projektor	10,000
369	Tavolina nxenesi cil.e larte(2020)	184,500
370	Karrike nxenesi cil.e larte (2020)	132,000
371	Tavolina nxenesi .(2020)	23,400
372	karrike nxenesi (2020)	10,800
373	dollap klase (2020)	41,760
374	derasa te zeza(2020)	48,240
375	tavoline drejtuese ne forme L(2020)	33,600
376	tavoline mbledhje salle(2020)	33,840
377	karrike per sallën e mesuesve(2020)	13,200
378	rafte librash(2020)	22,800
379	dollap arkivi(2020)	37,200
380	Kompjuter mesuesi	49,371
381	Kompjuter nxenesi	354,680
382	Lazer prinder	29,204
383	Tavoline e rumbullaket f140k	24960
384	Magnetofon	38400
385	Moket	9600
386	karrike e thjeshte mesuesi	2400
387	Cisterno Uji	11,500
388	Soba Druri(2019)	33,360
389	Kompjuter nxenesi	49,371
390	Sëitëh 16 port	266,034
391	Laser printer	4,617
392	Scanner	14,601
393	U.P.S.	4,724
394	Rack 74	26,838
395	Instalim laboratorit	5,367
396	Dollap informatike	44,835
397	Tavoline mesuesi	23,341
398	Tavoline nxenesi	10,240
399	Mjete didaktike	61,590
400	Mjete didaktike	120,080
401	Stabilizator informatike	367,800
402	Tavoline lab.shkencore(2012)	24,360
403	Rafte laboratorit(2012)	73,440
404	Prozhektor BENA(2012)	10,000
405	Tav.nxen.cikli I ulet(2012)	108,000
406	Kar.nxen.cikli I ulet(2012)	108,000

Nr	EMERTIMI	Vlera ne leke
407	Tav.nxen.cikli I lart(2012)	136,500
408	Tav.nxen.cikli I lart(2012)	96,480
409	Kar.nxen.cikli I larte(2012)	36,480
410	Tav.nxen.ars.i mesem(2012)	136,500
411	Kar.nxen.ars.i mesem(2012)	86,400
412	Tav.nxen.ars.i mesem(2012)	84,000
413	Tav.per edukatore(2012)	16,080
414	Karrike personeli(2012)	22,800
415	Dollap garderober person.(2012)	24,000
416	Karrige rrotulluese(2012)	14,400
417	Tavol.zyre(2012)	39,600
418	Etazher (2012)	25,200
419	paisje Eëfi	23,555
420	Tavoline e rumbullaket f140k	15,600
421	soba zjarri	5,200
422	fikse zjarri	12,000
423	tavolina set	182,400
424	globe	5,000
425	soba druri	14,400
426	Biblioteke	90,000
427	Tavoline druri e re	19,200
428	kompjuter nxenesish	44,873
429	printer nxenesish	16,514
430	dollap gard.rrobash - femra	32,040
431	dollap gard.rrobash - meshkuj	14,640
432	rafte e ulet qe paloset	30,600
433	Moket 3x3	10,200
434	Tavolina zyra	20,040
435	Tavolina zyra	14,400
436	Tavolina zyra	20,040
437	Tavoline	21,120
438	Cisterno uji	9,990
439	Tavoline	21,120
440	Tavoline	14,440
441	Tavolina	7,544
442	Dollap	22,800
443	Tavolina	16,400
444	Printer(brodherMFCL2752DË)	63,600
	Shuma	19,475,855

Burimi: Bashkia Dropull

Aneks nr.5

Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”

Nr	Emertimi i objektit	Gjendje 2021	Hyrje 2022	Gjithsej	Pakësimet 2022	Gjendja 2022
	Burimi klishar	94,926		94,926	94,926	
2	Deoo uji Pepel	260,444		260,444	260,444	
3	Ujesjelles Llovine-Likomil	73,797		73,797	73,797	
4	Linje e brendshem -ujesjells Bodrisht	82,380		82,380	82,380	
5	Ujesjelles Jorgucat	2,000		2,000		2,000
6	Ujesjelles Dervician	665,971		665,971	665,971	
7	Ujesjelles Selcke	50,712		50,712	50,712	
8	Ujesjelles Manxife 2387951	1,060,536		1,060,536	1,060,536	
10	Transformator pompa	105,186		105,186		105,186
11	Depo uji Koshovice	145,782		145,782	145,782	
12	Depo uji Skore	119,895		119,895	119,895	
13	Ujesjells i Manxifes dhe rikonstrukcion i fshatrave Selo Lovine Krioner	8,688,581	3,000,000	11,688,581		11,688,581
14	Furnizim nga pus shpimi Goranxi Dervician	3,482,979	1,156,201	4,639,180		4,639,180
15	Rikonstrukcion ne rrjetin e ujesjellsave	308,918		308,918	308,918	
16	Gjelberimi	99,942		99,942	99,942	
17	Vatra e kultures Ai-Nikolla	14,748		14,748	14,748	
18	Shkolla Catiste	45,450		45,450	45,450	
19	Rruga Kerre	528,018		528,018	528,018	
20	Rruga Sopik	60,546		60,546	60,546	
21	Rruga Polican	19,176		19,176	19,176	
22	Murri i varezave Grapsh	92,583		92,583		92,583
23	Ura Likomil	130,886		130,886	130,886	
24	Rruge te brendshme Pogon	179,010		179,010	179,010	
25	Rruge ne njesin administrative Pogon	211,250		211,250	211,250	
	Rrua hyrese Vrisera	349,999	605,326	955,325		955,325

Nr	Emertimi i objektit	Gjendje 2021	Hyrje 2022	Gjithsej	Pakësimet 2022	Gjendja 2022
29	Ura Llongo	817,234		817,234	817,234	
30	Rikonstruksion irrugeve te brendshem	405,333		405,333		405,333
31	Rikonstruksion i rruges Hllomo	94,770		94,770	94770	
32	Pastrim kanali Pepel	145,752		145,752		145,752
33	Blerje automjeti	102,000		102,000	102000	
34	Blerje automjeti	117,000		117,000	117000	
36	Rehabilitimi i digave te ujembledhesve Kakavi Likomil Peshkopi Bodrishte	1,794,658		1,794,658		1,794,658
37	Rikonstruksion shkollat	441,945		441,945	441945	
	Rik.i rrjet.te brendshme Zervat,vaniste...	4,023,208	1,749,999	5,773,207		5,773,207
	Rik.i rrugeve e mbrojtje malore	792,858		792,858	792,858	
	Rik.i rrjet.te brendshme Dervician Terihat	2,443,436	2,721,718	5,165,154		5,165,154
	Rruga Bodrishte		1,115,706	1,115,706		1,115,706
	Rruga Bularat(Extrovert Road)		2,730,224	2,730,224		2,730,224
	Rikonstruksion I pjesshem I rrjetit rrugor Pogon		341,640	341,640		341,640
	Rikonstruksion shkolla Bularat +kopshti		1,251,456	1,251,456		1,251,456
	Mbrojtja e rruges me gabion(2022)		219,996	219,996		219,996
	Shkolla Dervician(Sociale projekt)		79,841	79,841		79,841
38	SHUMA 231	28,051,909	14,972,107	43,024,016	6,518,194	36,505,822
39	Riparim kanali-rezervuar Pepel	16,424		16,424		16,424
40	Pastrim kanale Kulluese	124,413		124,413	124,413	
41	Mirembajtje rruge	69,315		69,315		69,315
42	Restaurim dhe pastrimi kanalit vadites rezervuari i Pepelit	336,648		336,648		336,648
43	Pastrim kanale Kulluese	53,396		53,396	53,396	
45	Pastrim kanalesh ne teritorin e bashkise	93002		93,002	93,002	
	Mirembajtje rruga Pogon	102894	7473	110,367		110,367
46	Mbajtja ne gadishmeri(Mbrojtja sociale)		119820	119,820		119,820
46	SHUMA 602	796,092	127,293	923,385	270,811	652,574
47	SHUMA 231+602	28,848,001	15,099,400	43,947,401	6,789,005	37,158,396
	Gjendja Civile	80,304	197,000	277,304	150,650	126,650
	Gjithsej	28,928,305	15,296,400	44,224,705	6,939,660	37,285,045

Aneksi 7.1

Të dhënat mbi rezultatin e zbatimit të rekomandimeve nisur me shkresën nr. 800/7, datë 19/12/2022

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmblëdhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a. Masa Organizative janë lënë 8, dhe janë pranuar 8 masa. Nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa janë pa zbatuar;

Nga *Rekomandimet e lëna në RPA* e auditimeve të mëparshme dhe rikërkuar nga grupi i auditimit në RPA me nr. 800/7 datë 19.012.2022, janë lënë për t'u zbatuar 2 masa, pranuar 2 masa; nga të cilat 1 masë është zbatuar dhe 1 masë pa zbatuar.

Në total janë lënë 10 masa dhe pranuar 10 masa: nga të cilat 7 masa janë zbatuar dhe 3 masa pa zbatuar.

b. Masa për Uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat e munguara) në bashkinë Dropull: është lënë 1 masë e cila dhe është pranuar në vlerën 10,649,239 lekë, kjo masë rezulton pjesërisht zbatuar;

Nga *Rekomandimet e lëna në RPA* e auditimeve të mëparshme dhe rikërkuar nga grupi i auditimit në RPA me nr. 800/7 datë 19.012.2022, janë lënë për t'u zbatuar 1 masë, pranuar 1 masë në vlerën 11,092,920 lekë;

Në total është 1 masë në vlerën totale 10,649,239 lekë¹³: e cila rezulton e zbatuar pjesërisht me arkëtim në vlerën 5,576,164 dhe deri më 31.12.2022 mbetur për tu arkëtuar nga detyrimi total vlera **8,772,214** lekë për 1114 debitorë¹⁴;

¹³ Meqënëse janë masa të të njëjtës natyrë dhe i përkasin të njëjtës kategori, i përmblodhëm në një masë të vetme në vlerën e detyrimit 10,649,239 lekë.

c. **Masa Shpërblim dëmi** nga auditimi i fundit nuk është lënë;

Nga *Rekomandimet e lëna në RPA* e auditimeve të mëparshme dhe rikërkuar nga grupi i auditimit në RPA me nr. 800/7 datë 19.12.2022, është lënë për t'u zbatuar 1 masë dhe pranuar në vlerë të plotë prej 3,419,505 lekë, e cila vazhdon të jetë pjesërisht zbatuar;

Në total është lënë 1 masë shpërblim dëmi dhe pranuar në vlerën 3,419,505 lekë dhe rezulton pjesërisht zbatuar.

d. Masa disiplinore nuk janë lënë.

Tabela përmbledhëse

Rekomandime	Pranuar	Pjesërisht	Papranuar	Zbatuar	Pa zbatuar	Shpërblim dëmi/Ardhura munguara	Pjesërisht / Proces Zbatimi	Realizimi %
12	12	0	0	7	3	2	2	58.3

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Dropull rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 30 datë 12.01.2023. Ndërsa nga Bashkia Dropull për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk ka kthyer përgjigje, **duke respektuar afatin brenda afatit 20 ditor.**

Nuk është hartuar "Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve".

Statusi: Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit).

Përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Dropull, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 800/7 datë 19.12.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 01.5.2023 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 "Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA). **Nga Bashkia Dropull nuk është bërë raportimi brenda 6 muajve pasi afati është më datë 29.6.2023.**

Statusi: Zbatuar

3. MBI RAPORTIMIN RREGULLISHT NË KËSHILLIN BASHKIAK TË ECURISË TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KLSH, SIÇ PËRCAKTOHET NË NENIN 50 -AUDITIMI I JASHTËM, PIKA 5, TË LIGJIT NR. 68/2017, DATË 27.04.2017 "PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE".

Bashkia Dropull me Urdhër të Kryetarit nr. 7 dhe me nr. 22 prot., datë 06.01.2023 ka ngritur grupin e punës, i cili ka hartuar Planin e veprimeve "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit" dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Dropull.

Nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi

¹⁴ Informacioni i detajuar në tabelën e debitorëve

për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.

Statusi: Pa zbatuar

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASAT ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se:

a-Nuk është hartuar strategji e plotë për menaxhimin e riskut, pasi i mungojnë plan-veprimet konkrete për marrjen e masave për eliminimin e risqeve të përcaktuara në rregjistrin e riskut, duke mos pasqyruar mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.

b. Bashkia Dropull nuk disponon një program trajnimi për punonjësit, në mënyrë që të gjithë punonjësit të kualifikohen më mirë në fushat ku ato operojnë, si dhe të njihen më mirë me mënyrën e funksionimit të komponentëve të MFK. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, nenet 8/b,21/2,22/1, me Manualin e MFK Kap.II,pika 2.2.2/a, me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016. “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 15-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të plotë të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marri masa për hartimin e një programi vjetor të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Nga verifikimi rezultoi se: 1.1

Në Bashkinë Dropull, nga Titullari i saj iu është përcjellë verbalisht menaxherëve kryesorë të njësive të strukturës organizative të bashkisë, për të njohur stafin me Ligjin nr. 10296/2010 “Mbi MFK” dhe Manualin e MFK-së, por deri tani nuk është hartuar dhe miratuar asnjë akt administrativ për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Pa zbatuar.

1.2 Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Bashkia Dropull i përcjell çdo vit stafit të bashkisë temat e trajnimeve që ASPA dërgon në rrugë elektronike NJVQV-ve për personelin e tyre. Për vitin 2023 ka hartuar dhe miratuar “Planin vjetor të trajnimeve” me nr. 695 prot., datë 28.04.2023.

Statusi: Zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e krijuara dhe të regjistruara në vitin 2021 janë nga mos likuidimi i dy faturave të muajit tetor 2021 në vlerë totale 2,998,286 lekë, përkatësisht nga furnizimi me ujë nga pus shpimet e ujësjellësit rajonal Dropull dhe rrjeti shpërndarës i fshatrave Goranxi dhe Dervician dhe supervizion punimesh “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të Dervicianit, Sofratik dhe Terihat. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101 “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 27-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Bashkia Dropull të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja si dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për dy faturat e vitit 2021 në vlerë 2,998,286 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se:

Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale na komunikoi se këto dy fatura ishin detyrime për ujësjellësat, fondet e të cilëve janë nga ministritë e linjës. U morrën masat dhe me USH nr. 279 dhe nr. 280 datë 21.07.2022 u paguan 2,845,135 lekë (është zbritur 136,292 lekë e cila është vlera e 5% të garancisë) si dhe USH nr.101 datë 21.03.2023 në vlerën 400,000 lekë. Në total janë paguar 3,245,135 lekë.

Statusi: Zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit për detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, ku për vitin ushtrimor 2021 mosrakordimi është në vlerën prej 2,998,286 lekë. Kjo vlerë nuk është evidentuar as në gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42.

3.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Dropull në mbyllje të vitit 2022 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve të lindura të konstatuara (të prapambetura) ndaj të tretëve në llogarinë 467 “kreditorë të ndryshëm” dhe shpenzimeve të kryera për këto detyrime në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke i rakorduar ato. Për pasaktësitë e rezultuara në këto llogari në mbyllje të vitit 2021 të kryhen sistemimet e nevojshme kontabël, duke i reflektuar ato në bilanc.

Nga verifikimi rezultoi se:

Me pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022, janë bërë dhe sistemimet në llogarinë 467 “kreditorë të ndryshëm” si kundërparti e llogarisë 486 “shpenzime të periudhave të ardhshme”. Kështu llogaria 486 në aktiv të bilancit është në vlerën 192,149,454 lekë, nga të cilat 189,151,168 lekë janë detyrime të prapambetura të vitit 2022 dhe 2,998,286 lekë janë të vitit 2021, që nuk ishin pasqyruar në bilancin e vitit 2021.

Statusi: Zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 4,518,999 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 9 projekt-studime për investime të pa kryera nuk është llogaritur amortizim në masën 15% me metodën lineare. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 36 (Më hollësisht trajtuar në faqet 38-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe e Mbrojtjes Sociale në Bashkinë Dropull të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet, duke bërë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 9 projekt-studime, të cilat janë jo koherente, pasi i përkasin investimeve të programuara në vite por të pa realizuara.

Nga verifikimi rezultoi se:

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2022, janë kryer veprimet e sistemimit në kontabilitet, duke bërë llogaritjen e amortizimit të aktiveve afatgjata jo materiale në vlerën 2,235,157 lekë, e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” te pasqyra Format 7/b, për 9 projekt-studime, të cilat janë jo koherente, pasi i përkasin investimeve të programuara në vite, por të pa realizuara.

Statusi: Zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” e cila si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur në bazë të zotërimit të aksioneve në masën 100% nga Bashkia Dropull të Fondacionit (jo fitimprurës) “Akademia Sportive Lefter Milo”, të themeluar me datë 26.05.2021 për mbështetjen financiare nga Bashkia dhe njohjen nga federata sportive të aktiviteteve sportive të fëmijëve dhe të rinjve dropullitë. Sipas VKB nr.24 datë 17.05.2021 rezulton se Bashkia Dropull ka derdhur si kapital fillestar vlerën prej 1,000,000 lekë në momentin e themelimit dhe njohjes si person juridik nga Gjykata. Për vlerën e kapitalit prej 1,000,000 lekë të derdhur nga Bashkia Dropull, duhet të ishin kryer veprimet e kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe në kredi të llogarisë 1011, “Shtesa të fondit bazë”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr.8 datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 31.

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale në Bashkinë Dropull të marrë masa, që të kryejë veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në kredi të llogarisë 1011, “Shtesa të fondit bazë” për pasqyrimin në PF të investimeve kapitale në vlerën 1,000,000 lekë të kryera në vitin 2021, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e e Fondacionit (jo fitimprurës) “Akademia Sportive Lefter Milo”.

Nga verifikimi rezultoi se:

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2022, janë bërë këto sistemime: u debitua llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” për vlerën 2,950,000 lekë nga të cilat 1,000,000 lekë janë të vitit 2021 dhe 1,950,000 lekë janë të vitit 2022; u kreditua llogaria 1011 “Shtesa të fondit bazë” për 2,950,000 lekë; këto sistemime janë pasqyruar edhe në pasqyrën Format 6 në tabelën e investimeve dhe burimet e financimit.

Statusi: Zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likuidimi përtej vitit ushtrimor rezulton se llogaria 231 “Shpenzime për investime në proces” nuk është debituar dhe kredituar për vlera e tyre pjesore të paguara, duke i kaluar pagesat në mënyrë të gabuar në llogarinë e aktivitetit, pa u kapitalizuar aktiviteti deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, kështu në fund të vitit 2021 konstatohet se 2 kontrata projektsh kanë mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 2,998,286 lekë dhe vlera pjesore e paguar prej 119,554,178 lekë, e cila duhet ti përkiste gjendjes debitore llog. 231 “Shpenzime për investime në proces” me datë 31.12.2021 dhe jo gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2 si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 (Më hollësisht trajtuar në faqet 38-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale në Bashkinë Dropull në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pagesat pjesore të vlerave të AQT duhet ti evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë. Pas realizimit të plotë të investimit dhe marrjes në dorëzim të tij, si dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Nga verifikimi rezultoi se:

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2022, janë kryer sistemimet për investimet e papërfunduara në llogarinë 231 në aktiv të bilancit në vlerën 186,603,290 lekë, që nuk ishte pasqyruar në bilancin e vitit 2021.

Statusi: Zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2021 gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” paraqitet në vlerën prej 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 9,729,801 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2021 është 9,729,801 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, pika 3.3, nën-pika 8 (Më hollësisht trajtuar në faqet 38-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale në Bashkinë Dropull të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit.

Nga verifikimi rezultoi se:

Nga Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022 vlera e llogarisë 4342 e cila duhet të korrenspondojë me vlerën e llogarisë 7206 të pasqyrës së Performancës Format 2, gabimisht është vendosur vlera e llogarisë 4341.

Statusi: Pa zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dropull nuk ka marrë masa të plota për zbatimin e rekomandimeve të dhënë nga KLSH në auditimin e mëparshëm. (nga auditimi i mëparshëm dhe rikërkuar në RPA me nr. 800/7 prot., datë 19.12.2022)

Nga 11 masa organizative të rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar 7 prej tyre, zbatuar pjesërisht 1, në proces zbatimi 2 dhe pa zbatuar 1 masë (Më hollësisht trajtuar në faqet 58-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim (përmbledhës): Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e 4 rekomandimeve organizative përkatësisht: 1.1; 11.1 dhe 5.1, të cilat janë konsideruar në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, si dhe 4.1 i pa zbatuar.

Brenda datës 31.12.2022

1.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrin që ka nxjerrë për bllokimin e llogarive bankare për subjektet debitore, si dhe të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit prej **11,092,920 lekë** nga subjektet dhe familjet debitore si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave.

(Nga verifikimi rezultoi se, nga drejtoria e Financës dhe Buxhetit, janë paguar 5.584.870 lekë, kundrejt subjekteve debitore, duke e zvogëluar borxhin deri në vlerën 5.508.050 lekë. Mos shlyerja e të gjithë vlerës së borxhit ka ardhur si rezultat i mos paraqitjes subjekteve respektive në bashki. Në proces).

Ky Rekomandim është përfshirë në Rekomandimin 1.1 të Kategorisë ”Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara.)

4.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe menaxhimin të Aseteve të marrë masa menjëherë për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat “Toka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë

pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Dropull më 31.12.2020. (Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Dropull nuk e ka zbatuar rekomandimin. Pazbatuar).

Nga verifikimi rezultoi se: Rekomandimi nuk është zbatuar nga Bashkia Dropull me justifikimin e mungesës së fondeve.

Statusi: Pa zbatuar.

5.1 Rekomandim: Nga Bashkia Dropull, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” për vlerën 3,489,643 lekë, duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës. (Nga verifikimi rezultoi se, me shkresat nr. 21,21/1-21/9 prot., në datë 07/01/2022 u dërguan njoftimet subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e pagesave. Nga drejtoria e financës janë kryer e pagesat dhe është bërë dhe sistemimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”. Pjesërisht e zbatuar).

Nga verifikimi rezultoi se:

Nga Drejtoria e financës dhe buxhetit/Bashkia Dropull, janë kryer pagesat dhe me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022, është bërë dhe sistemimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

Statusi: Zbatuar.

11.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Dropull të vazhdojë ndjekjen e të gjitha shkallëve të proceseve gjyqësore për arkëtimin e dëmit në vlerën 3,419,505 lekë. (Nga verifikimi rezultoi se, rekomandimi është në proces nga Bashkia Dropull, Zyra juridike e ka çuar çështjen në Gjykatën e Apelit që të vazhdojë ndjekjen e të gjitha shkallëve të proceseve gjyqësore. Rekomandimi është në proces zbatimi).

Nga verifikimi rezultoi se:

Drejtoria Juridike/Bashkia Dropull Na bëri me dije se Gjykata nuk e ka marrë ende për shqyrtim çështjen.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Detyrimet nga taksat dhe tarifet familjare në Bashkinë Dropull janë në shumën **9,343,612** lekë për 1,406 familje dhe nga taksat dhe tarifet e bizneseve në shumën **1,305,627** lekë për 19 biznese. Në fund të vitit 2021 gjendja e debitorëve (jo progresive, pasi para 2021 vlera është 0 lekë) për subjektet fizik/juridik dhe familjet është **10,649,239 lekë, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë Dropull. Këto të ardhura të munguara kanë ardhur si rezultat i mos marrjes së masave të plota shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve nga familjet dhe bizneset debitorë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93 (Më hollësisht trajtuar në faqet 32-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për të ndjekë të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **10,649,239 lekë** nga taksapaguesit privat dhe familjarë.

Nga verifikimi rezultoi se:

Bashkia Dropull nëpërmjet Urdhrave të Kryetarit, ka ngritur katër grupe pune për zbatimin e këtij rekomandimi:

* Urdhri nr.1 datë 24.01.2022 “Për vënie në dijeni për bllokimi llogarie bankare subjekteve fizik/juridik debitorë” dhe bashkëngjitur listat emërore të debitorëve; Urdhri nr.2 datë 15.02.2022 “Për shpërndarjen e njoftim detyrimeve subjekteve fizik/juridik debitorë”; Urdhri nr.3 datë 13.05.2022 “Për rishpërndarjen e njoftim detyrimeve subjekteve fizik/juridik debitorë”;

* Urdhri nr.4 datë 16.05.2022 “Për rishpërndarjen e njoftim detyrimeve debitorëve familjarë”;

* Urdhri bllokimi dhjetë Bankave të nivelit të dytë me nr. 167/1 datë 31.01.2022, nr. 1338 datë 10.08.2022, nga të cilat ka patur edhe përgjigje zyrtare me nr.334 datë 20.02.2022, nr.382 datë 28.02.2022, nr.551 datë 29.03.2022;

* Shkresa për kujtesë subjekteve debitorë me nr. 827 dhe nr. 828 datë 16.05.2022, nr. 1190 datë 12.07.2022, nr. 1686 datë 06.10.2022.

Situata e arkëtimit nga detyrimet e prapambetura dhe vlera e mbetur e detyrimeve pasqyrohet si më poshtë:

Emertimi i Debitorëve	Nr debitor	vlera e debisë fillim viti 2021	Nr debitor paguar	vlera e arkëtuar	gjendje 31.12.2021	debi viti 2022	vlera e debisë totale 31.12.2022	nr debitor 2022	nr. debitor paguar	vlera e arkëtuar deri 31.05.2023	Debi e mbetur
Deb.Familjare	1,406	9,343,612	766	4,560,283	4,783,329	3,087,815	7,871,144	1,104	245	1,386,256	6,484,888
Deb.Biznes Madh	8	1,141,316	4	612,467	528,849	327,038	855,887	7	1	21,600	834,287
Deb .Biznes Vogel	11	164,311	10	157,631	6,680	38,503	45,183	3	1	11,315	33,868
SHUMA	1,425	10,649,239	780	5,330,381	5,318,858	3,453,356	8,772,214	1,114	247	1,419,171	7,353,043

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave/Bashkia Dropull

Aneksi 2.4.1

Regjistri i procedurave me vlerë të lartë

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Vleresuar auditim
VITI 2021				
1	Materiale per mirembajtje te ndricimit publik rrugor te Bashkise Dropull per vitin 2021	1,731,650	1,280,000	
2	Mirembajtje e automjeteve te Bashkise per vitin 2021	1,768,333	1,745,100	
3	Mirembajtje e rrugeve ne Pogon 2021	2,499,162	1,839,450	
4	Nderyrje emergjente per mirembajtjen e rruges se Krionerit si dhe sistemimit te perrenjve dhe urrave Likomil,Selo,Llongo ,Koshovice	1,620,750	1,571,217	
5	Prerje,prodhimi,transporti te materialit drusor ne magazinën e Bashkise Dropull	3,934,624	3,899,974	
6	Rikonstruksion i rrjetit te brendshem te ujesjellesit te Dervician,Sofratik dhe Terihat ,Bashkia Dropull	120,286,360	119,025,533	PO
7	Rikonstruksion rruge te brendshme, Hyrja Vrisera	16,966,272	15,922,051	PO
8	Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujesjellesit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan,Lugar dhe Grapsh,Bashkia Dropull	210,633,067	206,313,149	PO
9	Rikonstruksioni i rrugeve te brendshme ne fshatrat e Bashkise e mbrojtje malore	13,352,072	13,214,300	PO
10	Supervizion punimesh per objektin :Rikonstruksion i rrjetit te brendshem te ujesjellesit te Dervician,Sofratik dhe Terihat ,Bashkia Dropull	2,129,890	1,908,597	
11	Supervizion punimesh per objektin:"Rikonstruksioni i rrjeteve			

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Vleresuar auditim
	te brendshme te ujesjellesit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan,Lugar dhe Grapsh,Bashkia Dropull	3,019,592	2,655,454	
12	Karburant	6,012,692	6,012,692	
Shuma viti 2021		377,941,772	375,387,517	
VITI 2022				
1	Blerje Karburant	7,500,000	7,280,718	
2	Blerje mjet vetshkarkues	2,500,000	2,000,000	
3	Materiale per ndricim	1,500,000	1,466,865	
4	Mbajtja ne gadishmeri e infrastruktures rrugore dhe mbrojtja nga permbytja e Perroit te Selose ,Peroit te Sotiresdhe lumit Kseria	2,416,720	2,145,000	
5	Mbrojtja e rruges me gabion ne perroin e Selose dhe muri mbajtes ne Koshovice	6,757,500	4,910,500	
6	Prerje dhe magazinimi i lendes drusore	8,333,333	4,211,360	
7	Rikonstruksion i pjesshem i rrjetit te vjeter rrugor tek Njesia Administrative Pogon,me shtrese betoni	9,764,977	8,119,039	
8	Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "Bularat"+kopesht Bularat,Dropull i Siper	58,648,181	53,945,123	P
9	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	2,196,800	2,139,650	
Shuma viti 2022		99,617,511	86,218,255	
TOTALI		477,559,283	461,605,772	

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT